Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 4 (188) PRILL 2022. ÇMIMI: 50 LEKË. 0,5 €

BIG market
PESHKOPI MAQELLARË
Plot oferta dhe surpriza...

KONFERENCË
108 vite shkolla shqipe në Dibër
— Faqe 10

TRADITË
Veçanti në ndarjet kanunore
"Pajtim - o dilni fare"
Nga **HAKI PËRNEZHA**
— Faqe 11

PROPOZIM
"Të ngremë kullën muze të Dom Nikollë Kaçorrit"
— Faqe 12

TURIZËM
Kulla Hupi, një nga kullat më unike në Shqipëri
— Faqe 13

Rruga e Arbrit, kontrata e ndërtimit mbaroi në prill, por rruga është akoma larg përfundimit

Edhe Rruga e Arbrit nuk ia doli të jetë një premtim i mbajtur nga politikanët shqiptarë. Si të gjitha investimet e tjera publike, edhe kjo është futur në qerthullin e shtyrjes së afateve, që më shumë se sa një problem real, duket një problem "teknik" për të nxjerrë më shumë fonde nga buxheti i shtetit, ose thënë më drejtpërdrejtë, nga taksat e qytetarëve shqiptarë.

QEVERIA KORREKTE ME PAGESAT

Në lidhje me financimin e saj, një nga debatet e hapura, Gjoka theksoi në takimin e Klosit se ka siguruar një mbështetje financiare nga Banka Kombëtare Tregtare një shumë prej 70 milionë eurosh, mbështetur edhe nga projekti i qeverisë shqiptare "1 miliardë për rindërtimin".

Gjatë periudhës së pandemisë, opozita e pati futur Rrugën e Arbrit në listën e projekteve që duhej t'i ndërpritej financimi, megjithatë qeveria shqiptare, përveç ndonjë vonese me pak ditë, ka qenë korrekte me kompaninë.


Më 22 janar 2019 kompania ka marrë këstin e parë nga qeveria si pagesë për Rrugën e Arbrit në shumën rreth 20 milionë Euro (2,520,000,000 lekë). Këstin e fundit prej 420 milionë lekësh (rreth 3.5 milionë euro) e ka marrë më 18 mars 2022. Deri më tani shteti ka paguar 9.9 miliardë lekë (9,900,000,000.00) ose rreth 82.5 milionë euro ndarë në 14 këste.

Në pagesat për Rrugën e Arbrit qeveria ka vendosur edhe një shtesë buxheti prej 20 milionë euro për punime të paparashikuara në tunelin e Murrizit.

Reportazh: NË RRUGËN E ARBRIT, DITËN QË DUHEJ TË ISHTE PËRFUNDUAR

Rrugë e mbetur rrugëve

Nga **KAMBER FARUKU** — Faqe 2



NË BRENDËSI:

■ Ndërtimi i **HEC Skavica** është asgjesim i Dibrës. ■ **Diga që ndan** dhe shkatërron ■ Tiranë, **protestë** kundra ndërtimit të Skavicës ■ **Pavarësia** energjetike e kujt? ■ **Hallva** për mbytjen e Dibrës në natën e Kadrit ■ **Monument** i madh i popullit dibran ■ **Ura e Lezedres** në Rrugën e Arbrit. ■ Për librin e **Halil Ramës** "Magjia e fjalës" ■ **Ilmi Dervishi**, letrari modest ■ Kur **Hysni Bruçi** botonte në "Zëri i Rinisë"… ■ **Mirëkuptimi** për guximin klinik të justifikuar ■ "**Fshati** në këmbët e Temlës" ■ "Gjergj Elez Alia i Dardhës" ■ **Ramiz Daci**, dëshmor i luftës për liri e pavarësi - "Qytetar Nderi" ■ **Mentor Muça**, një shembull frymëzimi për brezat ■ Homazh për mësuesin **Hajri Ilmi Baruti**



Pranverë në Dibër

Nga **OSMAN XHILI** - FAQE 9

Fermerët mbjellin tokën, pavarësisht vështirësive që përballen me rritjen e çmimeve

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur. Nr. 4 (188). Prill 2022
Gazeta doli nga shtypi, 5 maj 2022.
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit maj 2022.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Abdurahim ASHIKU
Kamber FARUKU
Kadri DAUTI
Preç ZOGAJ
Ramadan TOPUZI
Haki PËRNEZHA
Nazmi KOÇI
Bashkim LAMI
Zabit LLESHI
Esmeralda BICA
Ahmet KAMBERI
Halil RAMA
Mezin SHEHI
Dali NOKA

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit / NIPT: K82019002S
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Reportazh: NË RRUGËN E ARBRIT, DITËN QË DUHEJ TË ISHTE PËRFUNDUAR



Rrugë e mbetur rrugëve

Nga **KAMBER FARUKU**

Edhe Rruga e Arbrit nuk ia doli të jetë një premtim i mbajtur nga politikanët shqiptare. Si të gjitha investimet e tjera publike, edhe kjo është futur në qerthullin e shtyrjes së afateve, që më shumë se sa një problem real, duket një problem “teknik” për të nxjerrë më shumë fonde nga buxheti i shtetit, ose thënë më drejtpërdrejtë, nga taksat e qytetarëve shqiptarë.

Nga **BUJAR KAROSHI**

Më 20 prill 2019, kur një grup nga shoqata e Lidhja e Intelektualeve Dibranë vizituan kantierin e punimeve në Rrugën e Arbrit në Klos, punohej me ngritjen e këmbëve të Urës së Vashës. Ndërkohë ishte hapur tuneli T5, që të çonte të kjo urë dhe po punohej për hapjen e tunelit T4 në drejtim të urës së Lezedres mbi katundin Fshat. Gjithashtu, ishte e hapur traseja e rrugës në Gjoricë si dhe ura mbi lumin Drin.

Deri atëherë gjithçka dukej në rregull me punimet. Jo vetëm deklaratat e drejtuesve të kompanisë për punime para afatit, por edhe deklarata që dilnin nga zyrtarët e qeverisë, që më në fund një vepër publike do të mbyllej në afat, me cilësinë dhe standarde që do të shiheshin për herë të parë në Shqipëri.

Deklaratat optimiste nuk munguan as në hapjen provizore më 28 nëntor 2021, ku Belinda Balluku, ministre e Energjisë dhe Infrastrukturës, tha se “në Prill 2022 rruga do të jetë e hapur në të gjithë gjatësinë e saj, përjashtuar tunelin e Murrizit”.

Edhe Rruga e Arbrit nuk ia doli të jetë një premtim i mbajtur nga politikanët shqiptare. Si të gjitha investimet e tjera publike, edhe kjo është futur në qerthullin e shtyrjes së afateve, që më shumë se sa një problem real, duket një problem “teknik” për të nxjerrë më shumë fonde nga buxheti i shtetit, ose thënë më drejtpërdrejtë, nga taksat e qytetarëve shqiptarë.

17 VJET PUNIME “NIS E NDALO”

Punimet e para në Rrugën e Arbrit kanë filluar 17 vite më parë, më 3 korrik 2005, kur një ekskavator gërmoi pak dhè në Fushë Bulqizë, te vendi i quajtur Gurët e Skënderbeut, sa për të prerë kryeministri i atëhershëm një shirit inaugurimi.

Tenderi i parë për një segment të rrugës nga Bulqiza te Ura e Çerenecit u zhvillua në tetor 2007 për të filluar punimet në fund të atij



Në foto: Një grup nga shoqata Lidhja e Intelektualëve Dibranë gjatë vizitës në katinerin e rrugës së Arbrit në Klos, prill 2019. Në tabelën pas shkruhet se afati i ndërtimit është 44 muaj. Nga botimi i kontratës koncensionare në fletoren zyrtare në prill 2018 deri më tani, kanë kaluar 48 muaj. Ndërsa nga ceremona zyrtare e zhvilluar në Klos më 17 qershor 2018, deri më tani janë 46 muaj.

Një tunel i Murrizit me një heshtje të frikshme, një asfalt me vijë të verdhë në mes, që po del, shembje e shtrembërime trasesh, shpate të zhveshura e përçudnuara. Ku është nusja me emrin historik “Rruga e Arbrit”, që nis nga sheshi Skënderbej në qendër të Tiranës? Ku është kjo nuse në imagjinatën tonë: e hijshme, panoramike, e veshur me guida turistike, jetëdhënëse? Ku është kjo nuse aq e propaganduar si një lule në një shall mëndafshi?

Enisa këtë shkrim për Rrugën e Arbrit me një titull të marrë nga një shprehje e Edi Ramës për rrugët e nisura copa-copa dhe të pabitisura e ta papaguara, që gjeti kur mori pushtetin me 2013-ten, nëntë vjet më parë.

Para tre vjetësh e më tepër, bashkë me një grup dibranësh, u nisëm dhe bëmë një vizitë në kantierin e ndërtimit të Rrugës së Arbrit. Bëra dhe një reportazh optimist për punën atje.

Te hyrja e tunelit të Murrizit, në atë ditë me shi, në një shesh gjithë llucë, mbaj mend, që na priti një inxhinier i moshuar nga Mirdita, i skuqur nga rakia, që, me sa duket, kishte pirë nga i ftohti që po mbante. Na tha me një ton spartani se rruga do të përfundonte para afatit.

-Ta dimë për nder ta përfundosh në kohë dhe nuk e duam para afatit, - i tha dikush nga ne, duke mërmëritur nëpër dhëmbë.

Dhe, ja ku jemi sot. Në fund të prillit të vitit 2022. Pas shtyrje pas shtyrjesh, ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku, pat thënë se “Rruga e Arbrit do të përfundoje në fund të prillit 2022”.

Pat thënë.

Por, çfarë thotë sot?

Vërtet, çfarë thotë kur Rruga e Arbrit ka mbetur rrugëve, siç thoshte qëmoti Kryeministri.

Por, kush e pyeti se çfarë thotë?

E pyeti ndonjë deputet i Dibrës aty në Kuvend, siç thuhet, interpelancë?

Askush.

Unë, miqtë e mi, një optimist dhe besues i pandreqshëm, pata vendosur ta vizitoj në ditën e dasmës Rrugën e Arbrit. Në fund të prillit 2022. U pata premtuar edhe disa miqve të mi t’i çoja në Dibër nga rruga e re, një ëndërr e jona.

Dhe e bëra vizitën sot, me 24 prill 2022. I vetëm. Kalova “Kafen e Rremës” dhe shkollën e qenve të policisë dhe, aty ku ndahet rruga për varrezat e Shishtufinës, ndoqa drejt një tabele të vockël, ku shkruhej “Rruga e Arbrit”. Sapo u futa në Shkallën e Tujanit, me del përpara një asfalt i përgjysmuar disakilometërsh, si një rrobë e grisur. Për fatin tim, ana ime e djathtë ishte disi e shtruar, kurse në krahun tjetër kërcente makina gurëve e shfrynte si kali kur fut turinjtë në pluhur. Ishte një rrugë e nisur para njëmbëdhjetë vjetësh dhe e lënë për muze.

Pasi kalova kilometra të tjerë, me vijën e verdhë në mes, fillova ngjitjen e një rruge alpinistike të shpartalluar, por, që mban emrin kirurgjik *Bajpas*. Po qe se bajpaset në spital do të ishin si kjo rrugë dhie, gjithë gropa, e shtruar me zhavorr bituminoz, pra, në lartësinë e këtij bajpasi rrugor, asnjë pacient nuk do të dilte i gjallë nga operacioni.

Por, na takon ta rropasin kryet dhe... të ecim më tej. Gjithmonë me vijën e verdhë në mes. Në Klos dal te e famshmja rrugë e vjetër, e ndërtuar në vitin 1943 nga italianët. Sapo ngjit maloren, të del një si kaçak, siç u dilnin dikur udhëtarëve dibranë kur ecnin natën e ditën rrugës më këmbë për Tiranë e kthim.

Është një shembje rruge e pakalueshme, krejt gropa dhe makina mendohet tre herë të kalojë apo të kthehet mbrapsht. Deri në Qafë Buall ecet kështu. Poshtë, në fshatin Plan i Bardhë, fle gjumë një trase e rrugës e hapur prej dymbëdhjetë vjetësh. Disa makina kalojnë atje si në Rellin e Dakar-it në shkretëtirën e Saharasë, me re pluhuri prapa.

Pastaj rruga e vjetër. Me një fjale, copë e grime.

Një tunel i Murrizit me një heshtje të frikshme, një asfalt me vijë të verdhë në mes, që po del, shembje e shtrembërime trasesh, shpate të zhveshura e përçudnuara. Ku është nusja me emrin historik “Rruga e Arbrit”, që nis nga sheshi Skënderbej në qendër të Tiranës? Ku është kjo nuse në imagjinatën tonë: e hijshme, panoramike, e veshur me guida turistike, jetëdhënëse? Ku është kjo nuse aq e propaganduar si një lule në një shall mëndafshi?

Kompania që drejton Rrok Gjoka nuk po e mbaron Rrugën e Arbrit. Ndoshta do e përfundojë kompania e Noc Rrokut!

kryesore

Rruga e Arbrit, kontrata e ndërtimit mbaroi në Prill, por rruga është akoma larg përfundimit

Deri më tani janë ivestuar në rrugë mbi 150 milionë euro, nga të cilat 70 milionë janë marrë kredi nga kompania te BKT dhe mbi 82 milionë janë paguar nga buxheti i shtetit.



Pamje nga galeritë e braktisura të tunelit të Murrizit. "Tuneli ka ecur mbi 300 metra", u tha një inxhinier në kantier anëtarëve të shoqatës Lidhja e Intelektualëve Dibranë. Por vetëm një muaj më vonë u bë e ditur se tuneli ishte shembur. Arsyet nuk u bënë kurrë të ditura. Kompania i mbylli galeritë, ndërsa filloi punë për hapjen e tunelit në një kantier tjetër.

viti. Disa segmente të tjera, nga Bulqiza drejt Urës së Vashës dhe nga Tirana për në Qafë të Tujanit janë tenderuar ne pranverë 2011, për të përfunduar sipas kontratave në mesin e vitit 2013. Që prej atëherë, në këto segmente nuk është ndërhyrë fare (luginës së Planit të Bardhë), ose fare pak në qafë të Tujanit. Këto dy segmente janë përfshirë në kontratën koncesionare me kompaninë "Gjoka Konstruksion", si dhe dy akset lidhëse Maqellarë-Bllatë dhe rruga lidhëse me qytetin e Klosit.

PROJEKTI KOMBËTAR - NDRYSHE NË FJALIME, NDRYSHE NË REALITET

"Ky (Rruga e Arbrit) është një projekt kombëtar, është një projekt shumë i rëndësishëm jo vetëm për ju, por është shumë i rëndësishëm për Shqipërinë. Është një projekt që nuk garanton thjeshtë lëvizjen, nuk shkurton lëvizjen thjeshtë, po garanton një zhvillim për një territor të tërë që tani është jashtë hapësirës së zhvillimit dhe është një projekt që për ne hyn tek projektet strategjike që ne do ta çojmë përpara me shumë vullnet", - ka thënë Edi Rama, atëherë si kryetar i Partisë Socialiste gjatë fushatës elektorale në Klos më 12 qershor 2013.

Të njëjtën gjë Kryeministri e tha edhe në prezantimin e programit të qeverisë në parlament më 11 shtator 2013. Duke folur për pikat e rëndësishme të programit të qeverisë së tij, ai përmendi "Projektin e zhvillimit në infrastrukturë duke nisur nga Rruga e Arbrit si prioritet...".

KINEZËT, SIÇ ERDHËN IKËN

Nisur nga këto premtime - dhe shumë të tjera, më 16 dhjetor 2014, kryeministri njoftoi përmes faqes së tij në Facebook se "U nënshkrua mbrëmë memorandumi i bashkëpunimit me Chinese Exim Bank për hapjen e një kantieri projektesh në Shqipëri me financime kineze. Projekti i parë që do të çelë siparin e një epoke të re bashkëpunimi mes Shqipërise e Kinës do të jetë Rruga e Arbërit, e cila do të nise vitin e ardhshëm" (2015-shën. ynë)

Katër muaj më vonë, më 16 prill 2015, Kuvendi i Shqipërisë, me 89 vota "Pro", asnjë kundër dhe asnjë abstenim, i hapi rrugën fillimit të një procedure të veçantë për negocimin e kontratës koncensionare me shoqërinë kineze "China State Construction Company".

Kryeministri dhe anëtarët e qeverisë vazhdonin të këmbëngulnin se negociatat vazhdonin deri në arritjen e një marrëveshje të kënaqshme, ndërkohë që jo zyrtarisht kompanitë kineze ishte tërhequr. Lajmi u bë i ditur për publikun vetëm në tetor 2016, kur media njoftoi tërheqjen e kompanisë kineze.

Pavarësisht kësaj, Kryeministri Edi Rama, tha atëherë në Peshkopi, gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet e parakohshme lokale në gusht 2016, se "Unë nuk do të largohem nga zyra e Kryeministrit, pa bërë Rrugën e Arbrit."

PROPOZIMI I PA KËRKUAR: NIS ME 27 KILOMETRA, PËRFUNDON ME 69

Në shtator 2016, kompania "Gjoka Konstruksion" i propozoi qeverisë shqiptare të përfundojë të gjithë Rrugën e Arbërit, jo vetëm 27 kilometra e mbetura, për një vlerë prej 190 milion dollarësh.

"Dëshira jonë ka qenë dhe vazhdon të jetë, që pavarësisht se kush do jetë kompania që do e marrë përsipër, ajo rrugë të përfundojë dhe të vihet në operim. Si rrjedhojë e kësaj dëshire të madhe, ne i kemi bërë një propozim qeverisë Shqiptare para disa muajsh, për ndërtimin e plotë të të gjithë pjesës së mbetur të Rrugës së Arbrit. Koha e realizimit të punimeve 3 vjet dhe me një kosto shumë më të ulet se ajo e kompanisë kineze dhe standard më të lartë teknik". - pati thënë në atë kohë në një përgjigje me email për gazetën, Erind Gjoka, përfaqësues i kompanisë.

Më 12 prill 2017, me vendimin nr. 321, qeveria shqiptare i dha kompanisë "Gjoka Konstruksion" 10% bonues për tenderin për dhënien me koncension të Rrugës së Arbrit. Sipas propozimit të shoqërisë "Gjoka Konstruksion", rruga do të jetë në total 69 km, me standard C2 dhe me një tunel, i cili plotëson të gjitha kushtet e sigurisë sipas direktivave të BE-së, pasi do ketë edhe tubin e dytë (të emergjencës). Oferta e shoqërisë "Gjoka Konstruksion", për ndërtimin e rrugës brenda 46 muajsh është 33 600 000 000 lekë, rreth 249 milione Euro, pa TVSH.

Në gusht 2017 u hap tenderi dhe më 2 tetor 2017 hapet dokumentacioni i tenderit në mjediset e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Kompania e vetme që rezultoi se ka plotësuar dokumentacionin dhe ka dhënë një ofertë financiare është "Gjoka Konstruksion". Oferta: 33,6 miliardë lekë. Dy operatorët e tjerë, "Adem Pojani" dhe "Alb-Star" shpk rezultuan me probleme në dokumentacion

Qeveria shqiptare e shiti këtë tender si një sukses të saj në nëntor 2017, gjatë një takimi në zhvilluar në Peshkopi, në kuadrin e një mbledhje të qeverisë atje.

"Rruga e Arbrit është shfaqur si premtim, sa herë janë shfaqur këtu politikanët, kur u janë dashur votat dhe është harruar si premtim, sa herë kanë mbaruar zgjedhjet, deri kur ne e morëm seriozisht përsipër këtë zotim, me vetëdijen se Rruga e Arbrit nuk është thjeshtë një rrugë që do lidhë një zonë me një zonë, por është një zhvillim strategjik për ekonominë, për punësimin dhe padyshim për turizmin, që do të sjellë shumë zhvillim dhe shumë punësim në të gjithë këtë zonë." - tha kryeministri në atë takim.

PUNIMET NISIN PARA NËNSHKRIMIT TË KONTRATËS

Pavarësisht se firma mbi kontratë nuk ishte hedhur akoma, në dhjetor 2017, fillojnë punimet në Rrugën e Arbrit te vendi i quajtur Ura e Çerenecit, nga kompania "Selami" shpk, si palë nënkontraktore. Po në këtë periudhë punimet filluan edhe në Zall Dajt, përgjatë lumit të Tiranës.

Tre muaj më vonë, më 29 mars 2018, qeveria shqiptarë miratoi kontratën e koncesionit/PPP, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe shoqërisë "Gjoka Konstruksion", sh.a., për përmirësimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit, duke i dhënë autoritet të plotë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Më 11 prill 2018, kontrata koncensionare me kompaninë "Gjoka Konstruksion" u botua në fletoren zyrtare.

Më 17 qershor 2018 në Klos u zhvillua ceremonia zyrtare e hapjes së punimeve. Presidenti i kompanisë "Gjoka Konstruksion", Rrok Gjoka pati thënë në ceremoninë e nisjes së punimeve, se pavarësisht se në kontratë punimet janë parashikuar të zgjasin 44 muaj (rreth 4 vite), ai theksoi se ato do të mbaronin për dy vite, duke e shkurtuar shumë kështu kohën e ndërtimit.

Një muaj më vonë, më 18 korrik 2018, kryeministri Edi Rama, përmes një video prej 3 minutash publikuar në faqen e tij zyrtare në FB, informoi për vazhdimin e punimeve në Rrugën e Arbrit përgjatë lumit në Zall Bastar, si dhe nisjen e punimeve në Tunelin e Murrizit, më i madhi dhe më i rëndësishmi në këtë aks rrugor.

Tuneli i Murrizt, sipas titrave të shfaqura në video, ka avancuar 20 metra, ndërsa dy tunelet e tjerë në Klos kanë avancuar përkatësisht 90 dhe 281 metra, duke informuar kështu se punimet e kompanisë po ecin me shpejtësi.

Nëntë muaj më vonë, më 27 prill 2019, gjatë një vizite në kantierin në hyrje të tunelit të Murrizit, një nga inxhinierët e punimeve në tunel, u tha vizitorëve se punimet po ecnin normalisht.

"Tuneli ka ecur mbi 300 metra", u tha ai anëtarëve të shoqatës së Intelektualëve Dibranë. Por vetëm një muaj më vonë u bë e ditur se tuneli ishte shembur. Arsyet nuk u bënë kurrë të ditura. Kompania i mbylli galeritë, ndërsa filloi punë për hapjen e tunelit në një kantier tjetër.

Deri në nëntor 2021 dukej se punimet ecnin normalisht. Premtimi për hapjen 6 muaj përpara afatit nuk u realizua, por shpresohej që punimet në segmentin Ura e Vashës - Plani i Bardhë të përfundonin në prill të këtij viti. Por kjo nuk ndodhi dhe nuk dihet kur do të ndodhë. Sepse të vetmet makineri që punojnë në terren, janë ato që punojnë në një kantier të kthyer në gurore pranë Urës së Vashës.

Ndërkohë, edhe segmentet e hapura për qarkullim, pas një dimri të vështirë me reshje, kanë filluar të shfaqin probleme për qarkullimin. Fundosje të trasesë së rrugës, hapje gropash mbi asfalt apo mungesa e sinjalistikës së sigurisë, mund të shoqërohet me probleme gjatë muajve që vijnë. Rritja e qarkullimit në këtë aks, sidomos gjatë verës përmes by-passit, mund të jetë i rrezikshëm për qytetarët.



Premtimi për hapjen 6 muaj përpara afatit nuk u realizua, por shpresohej që punimet në segmentin Ura e Vashës - Plani i Bardhë të përfundonin në prill të këtij viti. Por kjo nuk ndodhi dhe nuk dihet kur do të ndodhë. Sepse të vetmet makineri që punojnë në terren, janë ato që punojnë në një kantier të kthyer në gurore pranë Urës së Vashës.

QEVERIA KORREKTE ME PAGESAT

Në lidhje me financimin e saj, një nga debatet e hapura, Gjoka theksoi në takimin e Klosit se ka siguruar një mbështetje financiare nga Banka Kombëtare Tregtare një shumë prej 70 milionë eurosh, mbështetur edhe nga projekti i qeverisë shqiptare "1 miliardë për rindërtimin".

Gjatë periudhës së pandemisë, opozita e pati futur Rrugën e Arbrit në listën e projekteve që duhej t'i ndërpritej financimi, megjithatë qeveria shqiptare, përveç ndonjë vonese me pak ditë, ka qenë korrekte me kompaninë.

Më 22 janar 2019 kompania ka marrë këstin e parë nga qeveria si pagesë për Rrugën e Arbrit në shumën rreth 20 milionë Euro (2,520,000,000 lekë). Këstin e fundit prej 420 milionë lekësh (rreth 3.5 milionë euro) e ka marrë më 18 mars 2022. Deri më tani shteti ka paguar 9.9 miliardë lekë (9,900,000,000.00) ose rreth 82.5 milionë euro ndarë në 14 këste.

Në pagesat për Rrugën e Arbrit qeveria ka vendosur edhe një shtesë buxheti prej 20 milionë euro për punime të paparashikuara në tunelin e Murrizit.

Rruga e Arbërit nr. 188

Mardhenjet e Dibres me Shkodren i ka çelikos historia dhe nuk ka përse ti ndajë diga dhe uji. Prandaj të dashur qeveritarë, duke dashur të na vllazëroni me Ukrainën, mos na e prishni vllallëkun me Shkodrën.

opinion

Diga që ndan dhe shkatërron

Nga NAZMI KOÇI

(Vijim nga numri i kaluar)



TË SHPËTOJMË SHKODRËN:

Duket se aktorët dhe regjizori që duan domosdo të ngrenë një digë dhe të përmbysin Dibrën e kanë të qartë se ajo nuk është një vepër rentabël nga ana ekonomike dhe se ka disa mënyra të tjera më pak shkatërruese se ajo. Por në këtë pikë ata i kanë hequr dorezat dhe deklarojnë qartë se diga duhet ndërtuar që "Të shpëtojmë Shkodrën" nga përmbytjet që përsëriten shpesh atje. Këtë e thotë me plot gojën Kryeministri, Ministresha e linjës, deputetët në parlament, bile dhe ca deputetë dibranë. Athere na duhet të sqarohemi pak në këtë pikë.

Së pari, Shkodra aty ka qenë në shekuj dhe Drini andej ka rrjedhur në shekuj dhe shira po ashtu kanë rënë gjithmonë. Njerëzit janë perpjekur të mbrohen nga fenomenet e natyrës, kanë ndërtuar kanale e ngritur prita e pengesa dhe më vonë kanë kryer vepra bonifikuese e vënë hidrovore dhe nuk janë përmbytur. Në se disa të pa ditur a të pa ndergjegjshëm, bllokojnë kanalet e prishin argjinaturat, ndërtojnë ku atyre ju pëlqen dhe i kundërvihen natyrës, ajo dihet se është e pa mëshirshme. Po perse kemi qeveri, e çdo kohe e lloji qoftë ajo. E para që të mos lejojë veprime të tilla që të kryhen kur pasojat u dihen atyre per sot e në të ardhmen. Së dyti, në se kanë ndodhur, që të marrë masa e ti korigjojë ato. Ti verë në punë veprat bonifikuese dhe ta dërgoje ujin në rrugë të vet. Në se puna e kërkon le të prishen dhe ca ndërtime pa leje, sigurisht duke i kompensuar ato. Precedntë të tillë kemi. Kur ka interesa "strategjike " si te unaza e re apo te rruga 5 maji në Tiranë, me një herë, pa zbardhur drita, shkojnë fadromat dhe i prishin. Po për interes shoqëror mund të bëhet ndonjë prishje, të ndëshkohet ndonjë fajtor, por jo një rreth i tërë dhe një zonë e pafajshme si Dibra dhe pellgu i Drinit. Në se qeveria dhe grupet e interesit vërtetë kërkojnë zgjidhje, të tilla ka dhe pa bërë ndonjë dëm, thjeshtë duke menaxhuar më mirë problemin.

Do të ju isha lutur shumë atyre që do të përpiqen ti trajtojnë këto mendime si mungesë dashurie e respekti për Shkodrën e shkodranët, të mos e bëjnë. Jo nuk është kështu dhe për të mos patur spekullime po sjellë disa fakte.

Në Dibër dhe më gjërë, dihet se Dibra e Shkodra janë një vëlla, dikur ishim një vilajet (më 1869). Kanë qenë ndër shekuj në një raport njerëzor të mire të jashtzakonshëm, kanë jetuar e punuar bashkë, kanë luftuar e vdekur bashkë. Që në kohë të Ilirëve është i vërtetuar ky fakt. Sa herë i ka dhembur koka Shkodrës kanë shkuar me nxitim dibranët. Kanë luftuar e janë vrarë me qindra atje. Ka varre të dibranëve gjthandej, te kisha e Berdicës, në Han të Hotit e nga mos. Dibranët kanë ndërtuar në Shkodër, ka një shesh me emrin "sheshi i dibranëve" dhe një rrugë të banuar nga dibranë që quhet "Rruga e gogëve", disa janë vendosur përfundimisht aty e kanë marrë mbiemrin Dibra. Mbiemri Dibra në Shkoder zë vendin e tretë në listat e votuesve shkodranë. Historitë e trimërive të dibranëve në Shkodër, në luftërat me turqit, serbët e malazezët, janë pa fund. Në kohë të perandorisë turke shkodranët këndonin : "Deri sa, të kemi Dibrën vlla,/ buk' e kryp' sa ujë ka deti,/ S'ka ç'na ban Sulltan Mehmeti " (9). Atë Gjergj Fishta u thur vargje dy udheheqësve të malsorëve dibranë që luftuan e ranë në Shkoder, Zyber Smajli nga Reçi dhe Mican Leka nga Dardha: "Zyber Smajli e Mican Leka / kurrë një herë si trembi deka/ Njeri Reç, tjetri darnjan /që çelik brejshin me dhamë" (10). Poeti Ymer Elezi në poezinë e vet " Mziu i Reçit në histori" shkruan : "katër trimat e fisit Mzes/ luftë po bëjnë me malazes" (11).

Ndërsa historiani Bajram Xhafa shkruan në librin e tij: " Po i çon Shkodra, Dibrës fjalë / a ma fal për luftë një djale" (14). Po djemtë e fisit Mzes, që luftuan e u vranë të gjithë, ishin jo një djalë, por katër djem nga një familje.

Shkrimtari dibran Agron Tufa thotë: "Varret e dibranëve i gjen të shpërndara nëpër të gjitha tokat shqiptare. E anasjellta-jo! (12). Lagje dibranësh ka në Tiranë, Shkup, në Stamboll dhe rrugë gjithandej. Bile ka një thënje të njohur: "Dibra ka ndërtuar Stambollin", ndërsa një gazetar dibran pyeste: Po Stambolli përse nuk e ndërtoi Dibrën? Çështja është po të tjerët çfarë kanë bërë për Dibrën. Më mbetet të pajtohem me Agron Tufën kur thotë se "Historia e Dibrës është një histori e gjatë mosmirnjohjeje (13). Kjo Digë është mosmirënjohja e radhës për Dibrën dhe dibranët e për atë konribut që ka dhënë e për të cilin është folur e shkruar aq pak. Uroj te jete e fundit.

Mardhenjet e Dibres me Shkodren i ka çelikos historia dhe nuk ka përse ti ndajë diga dhe uji. Prandaj të dashur qeveritarë, duke dashur të na vllazëroni me Ukrainën, mos na e prishni vllallëkun me Shkodrën.

MORAL I POLITIKËS APO POLITIKA PA MORAL

Shpesh dëgjojmë politikanë të çdo formati se duhet ta mbrojmë Shkodrën dhe popullin e saj nga përmbytjet e shpeshta dhe në këtë pikë unë bashkohem me ta. Por si duhet ta mbrojmë , duke mbytur Dibrën njëherë e mirë. Çfarë morali ka ajo politikë që përligj mbytjen përgjithmonë të një pjese të popullit të vet për të shpëtuar një pjesë tjetër nga mbytja rastësore apo disa javë në vit. Kjo është politikë pa moral. Një qeveri i ka njësoj shtetasit e saj në jugë e në veri, në perëndim e në lindje. Ligji dhe kushtetuta shprehin dhe mbrojnë parimin e barazisë së shtetasve, por ky veprim diskriminon një pjesë për ti sherbyer një pjese tjetër. Gjithashtu nuk më duket politikë me moral të lartë ajo që ndërhohë që " merakoset " për popujt e tjerë si a i Ukrainës, fyen dhe përçmon popullin e vet, bile dhe kur ai demostron pa thyer qoftë edhe një xham. Në se i heq edhe ketë të drejtë dhe je gati të mbysësh një trevë të tërë, atherë çfarë i ka mbetur demokracisë, përveç emërit fasadë.

Është bërë një luftë e madhe për të mbrojtur lumin e Vjosës nga një fat i zi si ai i Drinit. Jam plotësisht me ata që kërkojnë të mbrojnë Vjosën dhe ja kanë arritur. Por cili standart i politikës sonë, Vjosën e mbron dhe Drinin e mbyt. Kjo është politikë me dy standarte, pra poltikë pa moral. Për të njejtat arsye që duhet mbrojtur Vjosa, bile për ca me tepër, duhet të mbrohet edhe Drini.

Në se në Dibër janë mërzitur duke na dëgjuar ne intelektualët vendas dhe mendojnë se djali i komshiut është më i zgjuar se djali i shtëpisë, atëhere dëgjojeni thirrjen e një intelektuali nga Vlora, Z. Esheref Ymeri: "Populli dibran, në qoftë se do të jetë i bashkuar, nuk do ta lejojë Skavicën.

Unë shpresoj shumë te dibranët se ata janë pasardhës të trimit legjendar Elez Isufi, të gjeneralit me shajak, siç e pati quajtur ai anglezi. Sepse Elez Isufi ishte ai, i cili, si askush tjetër në trojet e pushtuara nga ushtria kriminale serbe, Drinin e Zi e pati mbushur me kufoma ushtarësh të vrarë serb, çka Beogradi e kujton me tmerr edhe sot e kësaj dite. (Eshref Ymeri, Kaliforni, 14 mars 2022. Cituar nga A. Ashiku më 18 mars 2022).

E për ta vërteuar atë që thotë një vëlla i mirë shqiptar nga Kalifornia, unë po ju jell edhe dëshminë e **Millan Nediq** (Ministri serb i luftës gjatë luftës së II të botërore dhe bashkëpunëtor i Hitlerit) i cili thotë: "Ne u larguam nga ty, o shqiptar, që të mos jeshë varr i përgjithshëm i yni. Djemtë tanë më të mirë i lanë eshtrat nëpër shkëmbinjt tuaj" (15). Esherefi Ymeri nuk bën politikë me dy standarte, i mbron njësoj si Vlorën dhe Dibrën, si Vjosën edhe Drinin. Shembulli i Esherefit nuk shkon paralel me atë të politikanëve tanë dhe as me atë të ndonjë dibrani që "ka ra në fushe " dhe pa u menduar gjatë thotë : "E ç'më duhet mua, unë një shtëpi e kam në Tiranë". Kështu besoj se mendon lepuri që thotë : "le të digjet pylli, unë e kam ferrën time".

E mbaj midis relikeve të mija një shkrim të historianit shkodran Gazmend Shpuza, me titull: "Viti 1913, si u sakrifikua Gjakova dhe Dibra për të shpëtuar Shkodrën" të botuar në gazetën Metropol të datës 24 shtator 2013. Në të ka një kapitull të emërtuar "Dibra, qendra e kuvendeve dhe kongresesve historike te Rilindjes kombëtare". Ai e paraqet ndarjen e Dibrës dhe lënjen jashtë kufirit shtetëror shqiptar të Shehrit si një pjesë e rëndësishme e teritorit dibran, si frut të diplomacisë ruso sërbe dhe rrjedhojë te veprës tradhëtare të Esat Pashë Toptanit që dorëzoi Shkodrën te malazezët kur Konferenca e Londrës kishte përfunduar. Ai thotë: "Esat Pasha duke ia shitur Shkodrën Malit të Zi, në të vërtetë shiti Gjakovën dhe Dibrën"(16). Sepse Esat Pasha e dorëzoi Shkodrën kur Konferenca e Londrës kishte vendosur që ajo ti mbetej Shqipërisë. Pushtuesve iu shtua oreksi e kërkuan copë tjetër . Më poshtë, historiani shton se :"Dibra e kuvendeve dhe e kongreseve historike të Rilindjes..., nuk e meritonte fatin historik që i caktuan përfaqësuesit e fuqive të mëdha në konferencën e tyre të Londrës më 1913"(17). E unë jam duke thënë se Dibra e ka paguar taksën e historisë dhe detyrimet ndaj kombit e ndaj Shkodrës veçanërisht, e nuk i ka ma borxh askujt.

KOMPANIA AMERIKANE

Shumë bashkëbisedues, sidomos banorë të atyre trevave, shprehen skeptikë në mundësinë e pezullimit të Digës si një vepër që shkatërron Dibrën, pellgun e Drinit dhe një pjesë të mirë të teritorit shqiptar të zonës veri lindore. Meraku i tyre është se tani është futur në lojë Amerika dhe ky është një emër i madh për çdo shqiptar. Por të sqarohemi me qetësi në këtë çështje. Së pari, në këtë vepër nuk është përfshirë qeveria amerikane, por një kompani private me qendër në Amerikë. Ajo kompani amerikane njihet tek ne sepse ka ndërtuar rrugën e Kombit, ashtu si e ndërtoi dhe kur e ndërtoi, pasi tamam ajo rrugë nuk është ndërtuar as sot. Në atë kohë një kryeministër pa thinja në kokë dhe në mendim , pat thënë se "Do ta ndërtojmë atë rrugë me bizhuteritë e grave tona". Dhe rruga u ndërtua me paratë e buxhetit të shtetit e ne përsëri vazhdojmë të paguajmë lloj lloj taksash për të, deri te trau në Kalimash që merr taksë çdo ditë e çdo orë për "mirembajtje". Por ajo rrugë për hirë të së vërtetës është e pa mirëmbajtur. Kjo nuk është përgjegjësi e kompanisë ndërtuese. Kompania kërkon front pune ku të gjej dhe në këtë rast i është ofruar qeveria shqiptare për ndërtimin e një dige dhe krijimin e një liqeni të ri me dhjetra mijë hektarë sipërfaqe. Në vendin e vet ajo zmonton diga të larta, tek ne i është kërkuar të ndërtojë një të tillë. Pra dibranët nuk kanë punë me ndërtuesin, por me investitorin.

Në se për angazhim të qeverisë amerikane merrni në konsideratë një vizitë të ambasadores amerikane Kim në Skavicë ju lutem mos u impresiononi prej saj. Unë e kam parë ambasadoren majë një shkëmbi në Skavicë ku kam qenë para saj dhe ju besoj fjalëve të sajë se ajo shkon shpesh në objekte të tilla, pasi "I pëlqen shumë natyra e viseve shqiptare". Në se është e vërtetë dhe asaj i ka pëlqyer ajo pamje që është e mahnitëshme, unë prisnja të thoshte "Mos e prishni këtë bukuri të rralle ", por ajo këtë nuk e tha. Mesazhet e Zonjës Kim nuk janë për herë të qarta. Nuk arrita ta kuptoj as kur vajti në Tropojë dhe u pa në televizor duke therur një gjel, se cili ishte mesazhi për shqiptarët therja e një pule. Ndoshta i parapriu gjëmës që ka ndodhur këto kohët e fundit me gripin e shpendëve në Durrës, por për këtë duhet të pyetet vetë Znj. Kim. Sidoqoftë mesazhet e saj janë disi të ndërlikuara për ne shqiptarët, pasi në to ndërthuren origjina e saj aziatike, e kombinuar me diplomacinë amerikane e që implementohet në një vend të Europës . Sa për qeverinë amerikane marrëdhënjet janë të mira dhe interesat e saj, poli-

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë. Komentet ose opinionet tuaja botohen bazuar mbi lirinë e gjithësecilit, pa qëllim fyerje apo denigrim të individëve apo grupeve të ndryshme shoqërore dhe politike. Për të botuar opinionin/komentin tuaj mund të na shkruani në <rrugaearberit@gmail.com>

tika jonë në unison i ka mbështetur, siç është rasti i Kuçovës apo i ndonjë kampi refugjatësh në Shqipëri. Nuk ka interesa amerikane te Diga e Skavicës. Kompania private amerikane, në mos aty do të ndërtojë në një vend tjetër dhe është në të drejtën e vet. Investitor është qeveria shqiptare dhe ne atë kemi votuar për hallet tona. Problemi i Digës është shqiptar, jo amerikan.

SIGURIA

Digat e larta sot në botë po zmontohen për arsye ekologjike dhe për arsye sigurie. Ndërtimi i një dige kaq të lartë dhe krijimi i një ujëmbledhësi aq gjigand nuk duhet bërë as për arsye sigurie. Drini ka qenë historikisht "vijë strategjike " për fqinjët tanë lakmiqarë e për të është derdhur gjak e kanë dhënë jetën qindra dëshmorë dibranë . Historiani ynë i famshëm Kristo Frasheri, e ka përmendur me dhjetra herë termin " vijë strategjike e Serbise" në librin e tij "Historia e Dibres " të vitit 2012 (18). Ndërsa "Kufiri strategjik" për fqinjët tanë lindor ishte Shkumbini dhe dalja në detë, në Durrës. Këtë e thoshte shumë qartë Pashiqi në atë kohë që i shkruante Londrës e kërkonte dalje në detin Adriatik, por nuk donte Leshin, po Durrësin. "E vetmja skelë për ne është Durrësi, e cila ka qenë dikur tokë serbe..." (19). (Kur???). Ju lutem mos më thoni se kohët kanë ndryshuar, pasi do të ju lexoj Gëten kur thoshte se "Historia është e përjetëshme, jeta njerëzore është shkurter". Ndërtimi i nje Dige të tillë ndarëse, përveç qellimeve strategjike mbart edhe rreziqe reale në çdo kohë.

Me që në këto kohë ka shumë zëra që meren me luftën e padrejtë që zhvillohet në Ukrainë e unë bashkohem me ta, duhet të ju ketë rënë në vesh, se udhëheqësi rus Vladimir Putin, gjithnjë e më shpesh përmend Shqipërinë dhe Kosovën. Nuk është për tu trembur, por për të qenë vigjilentë.E përkthyer në terma realë kjo don të thotë se mund të jemi objektiv i radhës për një luftë të mundëshme. E kam të qartë se do të nxitoni të më thoni se " jemi vend antarë i Natos". Së pari, në një sulm të mundshëm mund të jetë vetë Nato që të hedhë ndonjë bombë gabimisht mbi Digë. A nuk ndodhi në luftën e Kosovës në vitin 2000 një precedent i tillë kur avionët e Natos goditën gabimisht një autokolonë me civilë që marshonte në drejtim të Shqipërisë dhe çështja u mbyll duke kërkuar falje për një gabim njerëzor. Se dyti, trupat offensive ruse në Ukrainë kanë vënë në rrezik edhe reaktorët bërthamor në centralet e Ukrainës, ndonëse e dinë se kjo ka pasoja globale, bile edhe mbi ta vetë. Kush do ta kursente një bombë mbi digë në një konflikt të mundshëm, a thua ju dhimbsen shqiptarët më shumë se ukrainasit.

Edhe shkaqet natyrore si ç' jane tërmetet në një zonë me aktivitet sizmik të lartë, janë një mundësi potenciale e shkatërrimit të saj. E në se një gjë tillë ndodh, ndodh kataklizma e vërtetë për Shqipërinë. E gjithë zona poshtë diges, përfshi Shkodrën e Durrësin do të zhdukeshin jo për disa javë a muaj, por përgjithmonë. Hëna dhe dielli mos e dëgjoftë fjalën time, por kjo mund të ndodhë dhe sot duhet të mendohemi mirë për egzistencën e kombit në të ardhmen. Prandaj mendoj se kjo është një Digë që mbyt e përmbyt, ndan e përçanë, ndan e shkatërron, shkatërron e tjetërson dhe si e tillë nuk duhet ndërtuar kurrë. Dikur i pata shkruar një miku: "Nuk duhet të flasim vetëm për një zonë e cila dhe ajo ka qenë dikur një rreth më vehte, por duhet të vleresojmë se Dibra është unike me fushë e malësi, kur dëmtohet një pjesë, dëmtohet e gjitha., kur vdes një pjesë ka vdekur e gjithë Dibra. Ne e dimë si kanë jetuar bashkë në luftë e në paqë, asnjera nuk jeton dot pa tjetrën. Prandaj dhe argumenti se mbytet kaq ha tokë e preken nja 20000 banorë që duhet të dalin muhaxhirë, nuk më duket i drejtë, pasi për mua preket e gjithë Dibra, arkeologjia, historia, kultura, ekonomia, popullsia dhe tërësia e Dibrës ".



Prandaj unë jam kategorikisht kundër ndërtimit të asaj dige dhe ju ftoj të mbështesni zërat para meje e mua bashkë me ta.

Në të shkuarën kemi patur mjeshtër të medhenj të ndërtimit të Digave, por ata ishin në koherencë me të dhënat shkencore dhe botën, prandaj nuk u nxituan ta ndërtojnë atë digë. Prandaj bota nuk ndërton më diga të tilla dhe bën investime marramendëse e vendos panele për energjinë e erës, të gjatë me qindra metra edhe në thellësi të detit, për tu mbrojtuar nga katastrofat njerëzore a natyrore. Bota e qytetëruarprandaj gradualisht po i zmonton ato diga që ka ndërtuar më parë.

NJË EKSOD NË HORIZONT

Është krejt e natyrshme, bile kjo është e para, të mendojmë se çfarë do të bëhet me banorët e këtyre zonave, nga më të populluarat në Dibër e më gjërë, pasi të jetë mbytur ai vend ku kanë troje e varre dhe kanë jetuar ndër shekuj. Ndonjë merak nga strukturat shtetërore nuk duket se është shfaqur deri sot dhe jo masa të jenë marrë, por as ndonjë projekt i qartë nuk është paraqitur. Ndoshta me mendje lehtësi mendohet se mund tu jepet në dorë ndonjë lek dhe tu thuhet : "zgjidheni vetë individualisht ". Asnjë banorë të atyre anëve të mos e rrejë mendja se do të marrë ndonjë shpërblim të arsyeshëm, që i referohet pasurisë që ka në atë vend, apo nevojës që duhet të përballojë në një vendbanim të ri. Ka mbi 30 vjet që flitet për pronarët e ligjshëm e pronat e tyre të shpërdoruara për çdo arsye qoftë dhe qeveritë më parë e qeveria flasin çdo ditë per kompensim të tyre. Edhe kur janë bërë studime e vendosur tarifa, qeveritë nuk njohin as tarifat e tyre, por ju kërkojnë pronarëve të pranojnë të kompensohen me një koeficient të reduktuar që është rreth 10% e vlerës së pronës së tyre. A mund të pranohet kjo. Është lehtë të bësh llogaritë e tjetrit dhe të bësh sikur e paguan. Në se në Tiranë e rrethe flasim për pronarë që kanë plotësisht të drejtë, por janë të sistemuar, çfarë mund të thuhet për ata që nuk dinë se ku do ta venë kokën.

Do të jenë të detyruar të ndërmarin një eksod tjetër biblik. A nuk u ngopën njerëzia duke parë dibranët si muhaxhirë. Po e citoj edhe një herë Haki Stërmillin për ngjarjet e vitit 1913 në Dibër : " Në qytet, tabakhanja që ishte thertore bagëtishë, u bë thertore njerëzish. Qytetit i vinte era gjak njerëzish... kudo mbretëronte pasiguria dhe një heshtje tmerri" (20). E më poshtë për eksodin do të thoshte: " Dy kortezhe të gjata, Dibër –Elbasan dhe Dibër-Tiranë (100000 vetë sipas H. Stërmillit dhe 200000 sipas zëv. konsullit austriak Pollanz) e përcuellën lirinë në robni...., Ky ishte marshi funeral i Dibrës së vorrueme..." (21) . Kanë ikur shumë herë dibranët "nga sytë këmbët" dhe u shpërndanë si zogjtë e korbit e u vendosën në Elbasan, Durrës, Shkodër, në Shkup, në Stamboll, ne Athine, në Amerikë, nëpër të gjitha shtetet e Europës, ndërtuan Stambollin, ndërtuan Shqiperinë, ndritën vendin kudo që shkuan,... dhe mbijetuan. Bënë sakrifica mbi njerëzore dhe ndërtuan jetën me nder siç thotë Këngëtari dibran Haxhi Maqellara: "tuj punu e jo tuj lypë". A ju kujtohet një natë janari e vitit–--, kur 30 djem dibranë përfunduan në thellësi të detit duke ikur për një jetë më të mirë dhe politka heshti. Përsëri dibranët muhaxhirë? Atherë ka të drejte shkrimtari kur thotë kjo është mosmirënjohja e radhës. Uroj kësaj here të mos ndodhë.

Sikur ti mblidhnim të gjithe eksodet e Dibranëve, megjithëse nuk e kam bërë një studim të tillë, besoj se do të rezultonte e larguar një popullsi aq sa është sot popullsia banuese në Shqipëri. Është një hemoragji sociale që nuk po ndalon kurrë dhe me veprime të tilla veçse e nxisim më tepër. Ndaleni zotërinj këtë hemoragji. Sa ma shpejt më mirë. Shoqëria është si një organizëm i gjallë që kur humbet shumë gjak, vdes. E kjut i ntereson kjo, shqiptarëve jo. Ndoshta të huajve ju intereson të ndodhë kështu. Atëhere a nuk e kam të drejtën të pyes : "Për kë punoni Ju"? Ju lutem mos u fyeni por reagoni.

PËRFUNDIMI

Do të kisha dashur tu jap fund këtyre përsijatjeve të mija, por më frymëzoi qëndrimi i Esheref Ymerit që shkruan nga Kalifonia dhe vlerëson dibranët dhe heroin e tyre Elez Isufin. Ai është një inteletual nga Smoktina e Vlorës, ish Profesor i Universitetit të Tiranës, në pension, në Kalifoni të SHBA, shumë aktiv në botën e letrave dhe në jetën shqiptare. Ky është qëndrimi i një intelektuali e patrioti që don vendin dhe popullin e vet.

Dibranët sot kanë mundësinë të dëgjojnë shumë zëra këshillues. Dëgjojeni me vëmëndje Abdurahim Ashikun që jeton në Athine, por dhe gjumin e ëndrat i bën me Shqipërinë, me Dibrën dhe hallet e saj. Dëgjojeni Ali Hoxhën, Murat Koltrakën (i ndjerë), Mustafa Tolën, Adem Bungurin, Bujar Karoshin, Munir Hoxhën, Marjana Bulkun (Zeneli), Fazilete Gjikën, Selman Mëziun, Dali Oreshkën, Nazmi Drizin, Xhemal Matën, Bashkim Mashkullin, Ahmet Shehun, Adriatik Ballën, Margarita Markën, Cezar Ndreun e shumë të tjerë. Dëgjojeni Ramiz Dacin kur fliste në Kuvendin e Arrasit më 13 gusht të vitit 1920 "Kanë luftue të parët tanë e na i kanë lanë ti gëzojme këto troje. Sot .... do të luftojmë ne që ti gëzojnë fëmijet tonë, do të luftojmë or burra se na ka ardhë radha" (22). E në mos nuk mjaftojnë këta zëra, dëgjoni Suf Xhelilin me thirrjen e tij "a basa besë".

Sot nuk ka nevojë të luftojmë me pushkë, por të luftojmë deri në fund, me çdo mjet demokratik, papërgjegjshmërinë e mëndjelehtësinë e atyre që na thonë merrni plaçkat e ikni, "se ne do shpëtojmë Shkodren". Të luftojmë se "na ka ardhë radha", për të ardhmen e fëmijëve tonë.

Në këto shënime kam paraqitur disa copëza me fakte historike për të treguar se është derdhur shumë gjak për këte tokë që kërkojnë ta mbysin me një firmë mbi një letër. Të sqarohemi përfundimisht se ne kemi luftuar për trojet dhe familjet tona sepse na e kanë imponuar të luftojmë, ata që na kanë shti në luftë. Por ne nuk urrejmë kombe të tjerë, e as flirtojmë me ta. Historia kështu na ka mësuar. Dibranët dhe gjithë shqiptarët nuk urrejnë pasi kanë një kod, kodin e besës që ndonjë kombi tjetër i mungon. Kodi i besës, ka qenë për shqiptarët kodi i kushtrimit, kodi i vlerave dhe i mbijetesës së tyre. Kur mbi popullin e Dibrës kryheshin ato masakra antinjerezore për të cilat dëshmon Haki Stermilli dhe ka shkruar historia, Elez Isufi me luftëtarët e vet shoqeronte një kolonë prej 700-800 robërish të marshonte e sigurtë, të pushonte e të ushqehej dhe i përcolli robërit deri në kufirin shtetëror e i la të lirë të shkojnë në shtëpitë e tyre. Kjo habiti gjithë Europën e qytetëruar. Ishte kodi i vlerave e i besës së shqipetarëve. Mjerisht shumë figura të rëndësishme historike të Dibrës dhe të Shqipërisë, janë vrarë në pabesi.

Kësaj here nuk kam arritë me ju kuptue mirë, bashkëqytetarët e mi dibranë. Heshtja juaj me habit e më befason. Me pëlqen të mendoj se ashtu të zgjuar siç jeni prej natyre, po mendoni të flisni kur të jetë rasti, siç bën i mençuri në kuvend. Por rasti është tani, pasi nesër mund të jetë tepër vonë. Një mëndje më thotë se po luani fabulën e gomarit që kur po e hante ujku thoshte: "Ishalla jam në ëndërr", prandaj zgjohuni e dilini zot vetes, se bariu ka dalë për gjah. Nuk ju kuptova as në zgjedhjet e 6 marsit. Nuk ju kuptova sepse, pasi votuat siç ju e menduat dhe votuat kur ishte dita, të djelën, pastaj të hënën dolët në protestë, për çfarë? Vota i rregullon gjërat më mirë se protesta. Me që ra fjala se edhe unë votues si ju jam, nuk kam asnjë vrejtje për njeriun që u zgjodh dhe as për familjen e tij. Por ai është perfaqësues i qeverisë dhe u soll nga Tirana aty për të çuar përpara projektet e qeverisë. Në se vërtetë nuk e doni atë digë dhe jam plotësisht i bindur se jo, atëhere për tej çdo preference politike duhej të kishit bërë një zgjidhje që mbështet jetën tuaj, në trojet e të parëve. Me gjithatë kam dëshirë të besoj se një djalë Dibre e ka formimin dhe tabanin familjar të mendoj si patriot e më pas si partiak.

Me çka shkrova më lart, e disa të tjera që i kam ende në mëndje, fare mirë mund të isha ulur e të shkruja një libër për këtë problem, ku këto çështje të ishin kapituj të atij libri. Por dhe një herë po marr si shembull një shkodran të shquar, Dr. Frederik Shirokën kur thoshte: "Në pamundësi kohe dhe shëndeti historinë e mjeksisë shqiptare po e shkruej me majën e bisturisë, të tjerët ta shkruajnë me majën e pendës" (23).

Shpresoj se do ta bëni një resort në Dri, aty ku mbytet Seta dhe po jap fjalën se do të vi të festojmë bashkë.

Mars 2022

Literatura:

1. Adem Bunguri: Prehistoria e Dibrës, Tiranë 2010
2. Kristo Frashëri; Historia e Dibrës, Tiranë 2012, f.94-124
3. Moisi Murra: Dibra nga antikiteti në Monarki, Tiranë, f.132
4. Moisi Murra, po aty, f. 1
5. Abdurahim Ashiku: Po Dibrës, jo Skavicës, Tirane, 2010
6. Haki Stërmilli: Dibra në prag të shpalljes së pavarësisë, Dorshkrim, Tiranë 1940, f. 115:
7. Abdurahim Ashiku : vepër e cituar f.5
8. Abdurahim Ashiku, vepër e cituarF.6
9. Munir Shehu : Dibra në shekujt e sundimit osman, Tiranë 2016, f.14
10. Zenepe Dibra: Dibranët e Shkodrës, Shkodër 2019, f.234
11. Zenepe Dibra: vepër e cituar, f.80
12. Agron Tufa: Gazeta "Rruga e Arberit", datë 12.062014
13. Agron Tufa : Gazeta : po aty, f.2.
14. Bajram Xhafa: Lufta e Dibrës 1920, Shkodër 2001 (cituar Z. Dibra f.94) :
15. Moisi Murra: Dibra nga antikiteti në Monarki, Tiranë, f.551 (marrë nga libri Milan Nediç "Tërheqja e ushtrisë sërbe nëpër Shqipëri, 26nëntor -17 dhjetor 1915, Beograd 1937).
16. Gazmend Shpuza : Vitit 1913, si u sakrifikua Gjakova dhe Dibra për të shpëtuar Shkodrën, Gazeta Metropol 24.09.2013, f.1
17; Gazmend Shpuza: Po aty, f.9
18. Kristo Frashëri; Vepër e cituar, f.356,358,359,360,362,368.
19. Moisi Murra : Vepër e cituar, f.339
20. Haki Stermili : Vepër e cituar f.115
21. Haki Stermili : Vepër e cituar f.95
22. Moisis Murra: Vepër e cituar, f. 494
23. Musa Bizaku: Monografi "Breznia Kaduku", Shkodër 2006, f.7

Rruga e Arbërit nr. 188

opinione



Ndërtimi i HEC Skavica është asgjesim i Dibrës.

Nga **DALI NOKA**

A duhet sakrifikuar Dibra? Si banor i kësaj treve dhe që i përkas moshës së tretë, me plot bindje dhe me plot argument Dibra nuk ka asnjë arsye për t'u sakrifikuar qofshin këto Rajonale apo Kombëtare. Dibra jo njëherë, por shumë herë është sakrifikuar për interesat e mëdha të Dibrës e mbarë vendit.

Prandaj Dibra njihet për historinë e saj, jo vetëm brenda vendit por në gjithë botën.

Ja si shprehet shkrimtari nga Britania e Madhe Rikard Hibert në librin e tij me titull "Fitorja e Hidhur": "Kam mbaruar Universitetin e Oksfordit, njëri nga më të mirët në Europë, por një universitet të dytë e mbarova në Dibër". Ai shfaq cilësitë më të mira që ka Dibra jonë siç janë: trimëria, mençuria, besa e bujaria. Pra këto cilësi është koha që dibranët t'i shfaqin tani për t'i thënë: Jo Skavicës, jo të keqes që i bëhet, jo perdes së zezë qe t'i vihet Dibrës.

Kanë shkruar shumë dibranë për Skavicën dhe i falënderojmë të gjithë, veçanërisht shkrimtarin Abdurahim Ashiku që i del zot edhe në emigrim Dibrës. Janë krijuar dy shoqata: Njëra që në vitin 2000 "Shoqata për mbrojtjen e luginës së Drinit të Zi" dhe tjetra në vitin 2021 "Aleanca për Mbrojtjen e Dibrës" me siglën: "Po Dibrës, Jo Skavicës" me kryetar z. Zenel Hoxha, bir i Dibrës. Këto shoqata duhen mbështetur për të ndihmuar në parandalimin e kësaj masakre të madhe. Ka ardhur edhe një shoqatë nga Europa dhe Amerika me dy drejtuese të kësaj shoqate, njëra nga Gjermania dhe tjetra nga USA, bijë e Dibrës nga Fushë-Çidhna znj. Ferzileta Xhika. Kjo shoqatë ishte për mbrojtjen e ekosistemit. Në një takim ata sensibilizuan dibranët për të mbrojtur ekosistemin: Jo Skavicës.

Dy zonjat thanë se në Europë dhe në Amerikë nuk bëhen këto lloj hidrocentralesh. Ata na vunë në dijeni se në shumë vende të Europës i kemi ndaluar por edhe në Shqipëri përmenden Vjosën, Banjën, Kalivaçin, Valbonën e të tjerë. Ata na thanë se ka një ligj të veçantë, që mbi 15 metra lartësi nuk bëhen diga. Ndërsa Skavica është 147 m. Thënë shqip mbytet gjithë lugina e Drinit të Zi, që është hambari i Dibrës e jo vetëm kaq, por edhe Luma e Mati këtu janë furnizuar me bukë. Mbi lumenj si Drini i Zi nuk janë bërë në asnjë vend të Europës na thanë ata. Sakavica e madhe, aq sa dhe dëmi që bëhet. E çfarë fitoi vendi nga kjo vepër përveç dëmit. Në luginën e Drinit të Zi janë ndërtuar 8 Hec-e, në Mallën e Lurës 2 Hec-e, në Veleshicë 2 Hec-e, në Setën e Çidhnës 4 Hec-e e Lazhkizë 1, e shumë të tjerë do ndërtohen. Në Murr të Muhurrit, në Gram 3 Hec-e, e ka plot ujëra që duhen shfrytëzuar. Ndërtohet dhe një Hidrocentral i fuqishëm nga uji i Drinit pa e mbytur Dibrën. Pra energjia sigurohet pa e mbytur Dibrën. Diga e planifikuar i përmbyt gjithë këto Hec-e pra i kthen në inekzistuese në humbje. Këtu nuk bëhet një liqen ku të lulëzojë turizmi, siç e trumbetojnë, por kemi të bëjmë me një rezervuar të madh në sipërfaqe që mbyt tokën më prodhuese të Dibrës. Këtë tokë e kthen në moçalishte. Rezervuari mbushet dimrit po pati reshje e thahet në verë. Gjithë insektet e mbeturinat e tjera që ngelen e sipërfaqe konservohen e kthehen në burim infeksionesh, mushkonjat, era e keqe do të pushtojnë dhe Korabin.

Ajo fushë e begatë, kthehet në vatër infeksionesh. Ajri i pastër që vjen nga malet e pyjet që na rrethojnë do të na mungojnë. Ka edhe një tejtër mashtrim që na bëhet. Duhet të sakrifikojmë për të mos përmbytur ultësirat e Shkodrën ka sakrifikuar jetë njerëzish në momente të vështira, i janë ndodhur afër Shkodrës. Janë qindra dibranë që mbeten në luftën e Shkodrës në vitin 1913 kundër Karadakut (Malit të Zi) i nxitur nga Serbia pasi kërkonte të merrte Shkodrën. Edhe sot janë varret e dibranëve në Shkodër. Fushën e vet shkodranët e mbrojnë me taksat e veta. Dibra me Shkodrën ka pasur lidhje të forta që janë edhe sot. Besoj se po të pyeten edhe ata nuk janë dakord që të përmbytet Dibra, se i thahen krahët nga tkurrja e Dibrës.

SI MUND TA SHUAJMË HISTORINË E DIBRËS?

Historia e Dibrës është e lashtë, aq sa dhe vet Dibra. Synimet e hasmit kanë qenë tepër agresive për të na pushtuar këtë tokë për të cilën çdo pëllëmbë është e larë me gjak nga të parët tanë, që herët e deri tani vonë Dibra ka nderin e krenarinë që heroin tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu është biri i kësaj treve. Si mund t'i harrojmë betejat e mëdha të Dibrës me në krye heroin tonë. Si mund të harrojmë gjakun lum të derdhur për atë tokë, që tentohet të përmbytet. Si të fundosim eshtrat e të rënëve. Vetëm nga serbët Dibra është djegur me çfarë ka mbi tokë, siç i thonë me "mace e me minj". Në majë të bajonetave të gjakatarit kanë rënë jo vetëm burrat, por edhe gratë e fëmijët e Dibrës, në beteja të mëdha për këtë tokë.

Të dashur dibranë:

Sot është dita që ta ndajmë të mirën nga e keqja, që brezat e ardhshëm të mos na mallkojnë. Punët e mira e të mëdha bëhen vetëm të bashkuar, ashtu siç kanë qenë të parët tanë. Partia e jonë është vetëm Dibra jonë. Dibranët nuk kanë lakmuar paranë, ajo iken shpejt. interesat e Dibrës nuk janë shitur. Si të sakrifikojmë Dibrën, si të sakrifikojmë shëndetin tonë, ekonominë tonë, ajrin tonë, historinë tonë të lavdishme e gjithçka mbi tokë. Të mos mbulojmë eshtrat e atyre që ranë për këtë tokë.

I bëjmë thirrje firmës ndërtuese të ndalojë punimet: Mendoni si për vendin tuaj! Dijeni se dibranët e kanë desht shumë Amerikën që kur komunizmi nuk e donte atë, tani që truri i Dibrës është atje me ju. Duan të na e vjedhin Dibrën! Nuk ndodh në asnjë vend demokratik të botës që të marrësh gjithçka mbi tokë, pa pyetur të zotin. T'i lësh këto njerëz pa tokë, pa shpi, pa dinjitet, u ke marrë jetën! Asnjë lëshim në dëm të Dibrës, haramin e dënon edhe Zoti, asnjë lëmoshë në dëm të Dibrës. Pleqtë thonin se "zija një vjet, e marrja (turpi) për vjet". Dibra nuk e pranon turpin. Të mos ia humbim krenarinë e dinjitetin e Dibrës, mos ta tkurrim Dibrën, ta lëmë siç na e lanë të parët tanë. Dibra nuk është mbrojtur vetëm me pushkë, por edhe me penë. Dibrës nuk i mungojnë kapacitetet intelektuale, ka specialistë të zotë në të gjitha fushat: ekonomistë, agronomë, ambientalistë, inxhinierë, historianë. Bëni studimet tuaja me argumente të plota që t'i thoni: Jo Skavicës.

Kush firmos Jo Skavicës ka thënë: Po Dibrës, ndryshe jemi të dënuar përjetësisht nga ana morale. Morali e mban të gjallë e të devotshëm njeriun e mirë, pa moral ke vdekur. Mos ta prishim folenë e shqiponjave.

FEJTON

Hallva për mbytjen e Dibrës në natën e Kadrit

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Sonte është Nata e Kadrit, një kujtesë e veçantë në kalendarin mysliman gjatë kremtimit të muajit të madhnueshëm të Ramazanit.

Në vogli i gëzoheshim kësaj dite sepse ndër të tjera në menynë e iftarit gatuhej hallvë, ëmbëlsira karakteristike dibrane për ngjarje fetare e popullore-pagane.

Për dasmë...por edhe për mort...

Sot, në me biznesmenë nga bota, u zhvillua një tubim solemn ku ministrja e energjetikes Balluku foli shqip, kryeministri Rama foli anglisht, ambasadorja e SHBA Juri Kim foli në gjuhën e supervendit të vet.

Të tre pasi lëçitën një nga një të gjitha burimet e rinovueshme të prodhimit të energjisë elektrike; - të erës, diellit, gazit, valëve të detit, atomit, hidrogjenot etj. u ndalën në Skavicë, hurdhën me mbi 60 kilometra katrore pasqyrë ujore, hurdhën që do të zhysë dhe mbysë luginën e vetme të Drinit të Zi, rreth gjysmën e gjatësisë së lumit më të madh të Shqipërisë, lum që tash nuk e dimë se çfarë emri do ti venë gjeografët.

Nuk u tha asnjë fjalë nga fjalori human njerëzor për njerëzit, për ata që u përfundon nën uji gjithçka; toka, varret, vlerat materiale, kujtesa shoqërore.

Nuk kishte hapësirë për ta thënë. Biznesmenëve të pranishëm nuk u interesonte as toka e luginës më pjellore të Shqipërisë që ka mbajtur me bukë e gjizë breza njerëzorë e breza luftëtarësh, tokë e lakmuar nga pushtimi serb ku dibranët kanë derdh gjak me kova për ta pas atë trashëgim ndër breza, as historia, veçanërisht ajo e betejës së parë të Gjergjit të Gjon Dibranit që ndali vërshimin otomon në Evropë në Fushë Çidhën, Beteja e Torviollit, as luftërat e njëpasnjëshme me serbin e serbosllavinë që e donte për vete luginën e Drinit të Zi si shkallë për të zbritur në bregdet e për ta këputur Shqipërinë për brezi.

Nuk ua thanë...

Dhe nuk kishin si tua thoshin...

Transparenca kishte vdekur...

Sot, Natën e Kadrit, familjet besimtare myslimane dibrane do të gatuajnë hallvë.

Hallvë për festë...

Hallvë për mort...

Në qoftë se dibranët do ta shijojnë...

Megjithatë, sa e njoh unë Dibrën dhe dibranët, vonojnë, por nuk harrojnë.

Unë kam besim tek djemtë e vajzat e reja dibrane, besim se ata, me dijet dhe kulturën e kohës që kanë, do ta çojnë "Skavicën" në Gjykatën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe nuk do të lejojnë që në sofrën e tyre tu serviret "hallva" e mortit për Dibrën.

Si thua ti Farzileta, Adem, Munir, Marjana, Miranda, Margarita, Bujar, Agron, Selami, Selman, Zini, Arif...?

Ju e keni në dorë...

Po e latë të mbytet, do të endeni si çifuti në shkretëtirë e Dibrën, sado ta kërkoni, nuk keni për ta gjet.

27 prill 2022



Bashkoju peticionit të krijuar nga shqiptarët në SHBA. Kliko në lidhjen më poshtë dhe firmos peticionin online në **www.change.org**
tinyurl.com/mrykme42

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë. Komentet ose opinionet tuaja botohen bazuar mbi lirinë e gjithësecilit, pa qëllim fyerje apo denigrim të individëve apo grupeve të ndryshme shoqërore dhe politike. Për të botuar opinionin/komentin tuaj mund të na shkruani në <rrugaearberit@gmail.com>

aktualitet

Tiranë, protestë kundra ndërtimit të Skavicës

Dhjetëra qytetarë u mblodhën të shtunën (16.04.2022) në qendër të Tiranës dhe marshuan në drejtim të kryeministrisë për të shprehur revoltën e tyre kundër planeve të qeverisë shqiptarë për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës.

Protestës së thirrur nga një përfaqësi e dibranëve me banim në SHBA iu bashkuan ambientalistë, qytetarë të Tiranës dhe banorë të Dibrës, pronat dhe shtëpitë e të cilëve mbyten nga ujëmbledhësi.

Protestuesit marshuan në drejtim të kryeministrisë, duke mbajtur parulla në duar, me anë të të cilave kundërshtojnë ndërtimit të hidrocentralit. Shumica prej tyre janë në gjuhën angleze, duke kërkuar kështu edhe një mbështetje ndërkombëtare, por edhe duke iu drejtuar drejtpërdrejtë kompanisë Bechtel. "Bechtel - Go home", ishte një nga pankartat e protestuesve, duke i kërkuar kompanisë amerikanë të ndalojë zhvillimin e këtij projekti, të konsideruar si të dëmshëm për rajonin e Dibrës.

Disa parulla të tjera të protestës e krahasonin ndërtim e Skavicës si një gjenocid. "Skavica = Genocid", "Save Drin River - Save Dibra", "Jo Skavica, Po Dibra", "Për Dibrën, o Sot o Kurrë!" ishin disa nga pankartat që mbanin protestuesit.

Ata bënë një ndalesë para zyrave të kryeministrisë dhe protestuesit që morën fjalën evidentuan arsyet se pse ky projekt duhet të ndalohet. Sipas tyre, jo vetëm që prish ekosistemin dhe mbyt luginën e Drinit, zhvendos banorët, zhduk historinë e rajonit, ndan Dibrën në dysh, por edhe



mënyra e dyshimtë e dhënies së ndërtimit të këtij hidrocentrali një kompania amerikane, ngjall dyshime për korrupsion dhe abuzim. Ata evidentuan se kostot e ndërtimit do të jenë shumë më të larta nga se është deklaruar, duke rënduar kështu buxhetin e shtetit dhe mbi qytetarët shqiptarë.

Qeveria shqiptare ka kontaktuar kompaninë Bechtel - e njohur më parë në vendin tonë për ndërtimin e Rrugës së Kombit, e cila ka marrë pa tender projektin për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës. Kompania aktualisht është duke zhvilluar studimin gjeologjik të terrenit dhe, gjithashtu, ka kontaktuar kompani të tjera që po merrem me studimet mjedisore dhe sociale.

Deri më tani nuk është zhvilluar asnjë konsultim publik me banorët që do të shpërngulen dhe efektet negative që ky hidrocentral do të shkaktojë në zonën e Dibrës.

Sipas të dhënave të publikuara deri më tani, parashikohet një ndërtim i Hidrocentralit në lartësinë 443 metra mbi nivelin e detit. Ky hidrocentral parashikohet të mbytë mbi 33 fshatra gjatë luginës së Dibrës dhe të shpërngulë mbi 10 mijë banorë, ndërsa 40 mijë të tjerave u mbyten tokat bujqësore.

Kjo ishte e para protestë e zhvilluar në Tiranë kundër Skavicës dhe pritet që në ditët në vijim protesta të tjera ta shoqërojnë në Tiranë dhe Dibër.

Korresp. Rr.A

HYNI NË PROTESTA, NGRIJENI ZËRIN NË QIELL, FORCONI RADHËT, MOS DILNI NGA BETEJA DERI NË FITOREN E PLOTË.

Mesazh, drejtuar dibranëve për tu bashkuar në PROTESTA për mbrojtjen e Dibrës

Kur dymbëdhjetë të shkuara ngritëm zërin për ti thënë "JO" ndërtimit të hurdhës së Skavicës, "JO" mbytjes së Dibrës, ishim pak zëra, pak pena; numëroheshim me gishtat e dy duarve: Murati, Aliu, Bujari, Argëtimi, Shaqiri, Halimi, Linda, Xhemali, Hakiu...

Protestën tonë e përcollëm në shtypin e kohës, në gazetën "Rruga e Arbërit", në përmbledhjen "PO DIBRËS! JO SKAVICËS" botuar në vitin 2010...

Tash jemi shumë, jo dhjetëra, as qindra, por mijëra e dhjetëra mijëra...

Të motivuar si asnjëherë për ta mbrojtur Dibrën nga hurdha e korrupsionit, nga zhdukja e gjithçkaje që lidhet me të kaluarën heroike, ekonominë dhe kulturën, emrin e madh të saj.

Zë më të fortë se sa sot, zë për mbrojtjen e saj, zë të bashkuar pa dallime partiake, NUK KA.

Sot Edi Rama, shpatull-mbështetur pas një firme amerikane që nuk guxon do të ndërtojë vepra të tilla në vendin e vet (veçse në vende koloniale si Shqipëria), me bekimin e Juri Kim, ka shpallur mbytjen e Dibrës, shuarjen përgjithmonë të emrin e të zërit të saj.

Siç mësoj nga larg, në pamundësi për të qenë në rresht të parë me ta, dibranët po shtrëngojnë radhët për ti thënë publikisht "PO DIBRËS! JO SKAVICËS" në një tubim mbarë dibran më 16 prill 2022 në Tiranë.

Këshilla ime është:

HYNI NË PROTESTA!

NGRIJENI ZËRIN NË QIELL,

FORCONI RADHËT,

MOS DILNI NGA BETEJA DERI NË FITOREN E PLOTË...

Është beteja finale për Dibrën, betejë që duhet fituar.

Është thirrje e të parëve që derdhën gjak që Lugina e Drinit të jetë e bukur dhe e begatë siç e ka krijuar natyra, Dibër e pastër shqiptare...

Po nuk e ndalëm serbo-sllavin e ri, mallkimi i brezave do bjerë mbi ne.

Këtë turp nuk e mbajmë dot.

Ndaj: O SOT O KURRË...

PO DIBRËS ! JO SKAVICËS !

Abdurahim Ashiku

Athinë, 14 prill 2022

ANALIZË

Pavarësia energjetike e kujt?

Nga **Gjergj Erebara** / **BIRN**

Vendet në zhvillim në të gjithë botën kanë dy tregues për të patur parasysh: sigurimin e energjisë sa më ekonomike për të financuar zhvillimin e vet nga ekonomi të prapambetura në ekonomi të zhvilluara dhe; eficienca energjetike e ekonomisë së tyre të re.

Përkundrejt kësaj, kryeministri Edi Rama, ka plane të ndryshme. Në një konferencë për energjinë, të mërkurën, ai tha:

"Me shumë kënaqësi dëshmoj progresin për shndërrimin e impiantit të Vlorës në një impiant për prodhimin e energjisë. Shtoj këtu energjinë diellore, të erës. Ëndrra e gjatë e Skavicës që do rrisë me 20% prodhimin e energjisë dhe do na japë një shtysë drejt pavarësisë energjetike. Këto tregojnë një potencial për ta shndërruar Shqipërinë brenda këtij viti në prodhues neto të energjisë dhe kjo është gjë e madhe."

Koncepti i pavarësisë energjetike dhe ai i "prodhuesit neto të energjisë" janë paksa të çuditshëm në shekullin e njëzet e një. Pyetja e parë është se nga kush Rama dëshiron që Shqipëria të jetë në pavarësi energjetike. Dhe pastaj, pyetja tjetër është, çfarë do të thotë për ekonominë kombëtare të qenit "prodhues neto" i energjisë. E për më shumë, prodhues neto për sa kohë.

Si rregull, ekonomitë e varfra dhe të prapambetura, si kjo e Shqipërisë, kanë konsum të ulët energjetik, pikërisht për shkak se janë të varfra. Për shembull, shqiptarët konsumuan 800 kg naftë ekuivalente për frymë në vitin 2014, (të dhënat e fundit të disponueshme), ndërsa amerikanët konsumuan 6800 kg.

> Kryeministri flet për ndërtimin e Skavicës nga amerikanët dhe gazin e Azerbajxhanit në brigjet e Shqipërisë, duke premtuar Shqipërinë "vend eksportues" dhe "pavarësi energjetike". Problemet e Shqipërisë me burimet energjetike duket se janë krejt tjetër nga këto.

Pra nëse duan të zhvillohen, atëherë kjo do të thotë se ekonomitë e varfra do të duhet të konsumojnë më shumë energji. Dhe pyetja e parë në këtë diskurs duhet të jetë: a ka Shqipëria burime energjetike të vetat për të mbuluar nevojat e një ekonomie të zhvilluar? Përgjigjja është e thjeshtë: Jo! Nafta e nxjerrë nga nëntoka shqiptare, aktualisht në rendin e 900 mijë tonëve në vit, si dhe hidroenergjia, ajo aktualisht e shfrytëzueshme dhe ajo ende e pashfrytëzuar, si Skavica, nuk mjaftojnë për të mbuluar konsumin e një ekonomie të varfër si kjo ekzistuesja që kemi, me PBB për frymë prej 6200 dollarësh, një nga vendet më të varfra në Evropë. Dhe nëse ekonomia do të duhet të rritet, jo vitin e ardhshëm, por dekadën e ardhshme, në fjala vjen, 12 mijë dollarë për frymë, atëhere logjika ta do se konsumi i burimeve energjetike do të rritet. Teorikisht shqiptarët nuk kanë arsye se pse të mos synojnë ndërtimin e një ekonomie moderne, me PBB për frymë prej 65 mijë dollarësh, si ajo e Shteteve të Bashkuara, apo prej 34 mijë dollarësh, që është mesatarja e BE-së. Por për momentin po diskutojmë thjeshtë se çfarë mund të ndodhë kur ekonomia jonë të jetë 12 mijë dollarë për frymë. Kjo do të thotë që të konsumosh më shumë energji dhe, përveçse nëse qëllon që këtu te ne të zbulohet ndonjë burim i stërmadh nafte apo gazi, (me shumë gjasa që nuk do të ndodhë), atëhere shumica dërrmuese e energjisë së nevojshme për një ekonomi të zhvilluar do të duhet të importohet.

Rrjedhimisht, nëse duam një vend me ekonomi të zhvilluar, nuk mund të flasim për "pavarësi energjetike" dhe as për Shqipërinë si "eksportues neto" dhe nuk ka kurrfarë tragjedie në këtë. Në fund të fundit, vetëm një bari është krejtësisht i pavarur nga pikëpamja energjetike. Ai nuk përdor elektricitet në majë të malit dhe përdor këmbët për të shëtitur delet nëpër kullota. Por nëse duam të kemi ndonjë ekonomi pak më të zhvilluar se sa delet, fjala vjen, duam të prodhojmë djathë me qumësht deleje, atëhere na duhet energji elektrike për të nxehur e ftohur qumështin, na duhet naftë për të transportuar mallin, ndërsa sasia e energjisë së konsumuar varet nga sasia e djathit të prodhuar dhe eficienca energjetike e pajisjeve të përdorura për prodhim apo për transport.

Nëse ekonomia shqiptare rritet me 6% në vit, sa është normalja në kushtet e një ekonomie të prapambetur dhe qeverisjes pa korrupsion, atëhere ne do të kemi 12 mijë dollarë PBB për frymë në vitin 2033, pra pas 11 vitesh. Nëse ekonomia rritet me 3% në vit, atëhere ekonomia shqiptare do të dyfishohet nga niveli aktual në vitin 2045, pra 24 vjet nga sot. Përgjatë kësaj kohe, konsumi total i

(Vijon në faqen 8)

Na ndiqni:

RRUGA E ARBËRIT
https://www.facebook.com/gazeteerajonitteDibres

www.rrugaearberit.com

Shënime nga "Fletë të zverdhura '80"

Dhe një pyetje për dibranë:
A DO TA LINI QË GJITHË KËTË DJERSË TË NJË BREZI TË TËRË TA ZHYSIN E TA MBYSIN NË HURDHËN E SKAVICËS?

Monument i madh i popullit dibran

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Dibra ka një monument të madh. Përmasat e tij kanë përmasat e rrethit, shtrihen nga mali i Korabit në malin e Dejës, nga liqenet e Valikardhës në liqenet e Lurës. Monumenti është vepër e krijimtarisë dhe e djersës së popullit dibran. Një bisedë, qoftë kjo e ilustruar më së mirë flet pak për madhështinë e vërtetë të këtij monumenti, Veprave Ujore të Dibrës.

Duhet të kesh qenë në Setë, të kesh kaluar nëpër Gjalicat e Lurës, në atë kanion ku bukuria e natyrës është e rrallë, e papërsëritshme, në atë sokak malesh ku vështirësitë e kalimit gjithashtu të rralla janë, nuk i gjen gjëkundi. Duhet të kesh qenë tek liqenet e Shtrungës në Selishtë, tek liqenet e Valikardhës e të Lurës, duhet të kesh pirë ujë në burimet në prehër të Korabit e të kesh ndjekë rrjedhën shkumë borë të Veleshicës, duhet të njohësh në kohë e hapësirë që të ndjesh bukurinë dhe madhështie e kësaj vepre, heroizmin masiv popullor në ngritjen e saj.


Sikur ti bashkoje në një të gjithë kanalet kryesore ujitës të Dibrës dhe të udhëtoje trasesë së tyre me një makinë me shpejtësi 40 kilometra në orë, një ditë e një natë udhëtim pa pushuar nuk do të mjaftonte. Kanalet kryesorë ujitës në Dibër sot maten me gjatësinë e kufirit shtetëror të Shqipërisë.

Mundësitë për të udhëtuar e për ta parë këtë vepër madhështore, vepër arti me autor popullin e Dibrës, nuk janë. Një bisedë e ilustruar me fotografi dhe pas saj një film i pjesshëm mendoj se do të na e japë paksa afër bukurinë dhe madhështinë e saj.

Por përpara se të shkruajmë për kanalet, ujëmbledhësit, liqenet, stacionet e pompimit, etj., etj., ka vend të hedhim një vështrim mbi Dibrën, trevën ku hodhi themele dhe u rrit kjo vepër e bukur e saj.

Dibra ka një sipërfaqe prej 1569 kilometra katrorë. Në lindje kufizohet me Jugosllavinë në një vijë kufiri shtetëror 90 kilometra. Në veri kufizohet me Kukësin në një vijë kufiri të brendshëm 70 kilometra, në veri-perëndim me Mirditën në 13 kilometra, në perëndim me Matin 60 kilometra dhe në jug me Librazhdin 33 kilometra.

Dibra është një ndër rrethet më të mëdhenj në sipërfaqe, i katërti në shkallë Republike. Është një rreth me përmasa të mëdha, 271 kilometra në perimetër dhe 140 kilometra në diametër (nga Llanga në kufi me Librazhdin në Draj - Reç në kufi me Kukësin). Për numrin e fshatrave të veçantë, 192, zë vendin e parë në Republikë. Sipërfaqja nën kulturë duke përfshirë edhe bimët drufrutore zë 19 për qind të sipërfaqes së përgjithshme të rrethit. Tokat nën kulturë shtrihen nga 350 në 1800 metra mbi nivelin e detit. Madhësia e ngastrës është nga disa hektarë në luginën e Drinit në disa metra katrore në fshatrat malorë. Dominojnë tokat me pjerrësi 15 deri 25 për qind, 11.750 hektarë, tokat me pjerrësi 5 për qind zënë 9.500 hektarë, kurse ato me pjerrësi 50 -100 për qind 3.800 hektarë.



Kanali i Setës

Dibra ka një rrjet hidrografik të gjerë. Ka Drinin e Zi me degët e tij të shumta, ka liqenet me origjinë tektonike akullnajore që shtrihen në lartësi 1600-1700 metra mbi nivelin e detit, ka burime natyrore të shumta.

Drini i Zi me degëzimet e tij përbën bazën e rrjetit ujitës në rrethin e Dibrës. Drini, brenda Dibrës ka një pellg ujëmbledhës prej 5817 kilometra katrore dhe një gjatësi prej 57 kilometër. Drini, për shkak se ndodhet në fund të luginës, nën nivelin e tokave të kultivuara, nuk shfrytëzohet për ujitje me rrjedhje të lirë. Pas viti 1975, me ngritjen e disa stacioneve të pompimit në Maranica të Maqellarës, në Luzni, Pasmarë të NB-së etj., ujitja e tokave me ujërat e Drinit zë rreth 3-4 për qind të tokave nën ujë.

Me interes për ujitjen e tokave në Dibër janë degët e Drinit të Zi, Zalli i Okshtunit, Zali i Zeqanit, Murra, Seta, Veleshica, Malla e Lurës, përroi i Gramës, Peshkopisë, Maqellarës etj.,etj.

Zalli i Okshtunit: Ka një gjatësi 34 kilometra. Buron në malet e Prodanit, Kryesorë për të janë burimet e Borovës të cilat në verë japin 600 litra ujë në sekondë. Ushqen disa kanale të vegjël që përdoren për ujitjen e tokave të zonave Klenjë, Strikçan, Okshtun, Gjoricë. Prej tij në ujitje shfrytëzohen 1200 litra në sekondë.

Zalli i Bulqizës: Është 23 kilometra i gjatë. Merr ujërat e Liqenit të Zi të Valikardhës si dhe burimet e malit të Duriçit, të Dushajt etj. Është shfrytëzuar mjaft mirë për ujitjen e tokave të Bulqizës, Zerqanit, Strikçanit, Shupenzës etj. Nga Zalli i Bulqizës ujiten mbi 1600 hektarë tokë.

Murra: Ka nj gjatësi prej 19 kilometra. Mbushet me ujë nga rrjedhjet e liqeneve të Kacnisë dhe burimet e Qafë-Murrës. Ujit tokat e Selishtës dhe Muhurrit. Me ndërtimin e sifonit Muhurr-Kodra e Gjarajcës është bërë e mundur të futen nën ujë blloqet frutore të Zdojanit të Ndërmarrjes Bujqësore dhe tokat e kooperativave Qendër e Kastriot.

Seta: Është 13 kilometra e gjatë. Buron nga Kurora e Lurës, nga liqenet e bukur të saj. Rrugës merr me vete burime të shumta midis të cilëve edhe burimin ujëplotë të Setës prej ku nis edhe vepra ujore me të njëjtin emër. Seta ka një prurje në korrik-gusht prej 1.6 metër kub në sekondë. Ujit me rrjedhje të lirë tokat e Çidhnës, Dardhës e Reçit dhe me sifon tokat e Sinës, Fushë-Çidhnës, Kastriotit deri në Vakuf.

Veleshica: Ka një gjatësi 15 kilometra. Ujërat i merr nga burimet e shumta të Korabit. Kur shkrin bora përcjell 10 metra kub ujë në sekondë ndërsa gjatë verë 600 litra ujë në sekondë. Shfrytëzohet plotësisht për ujitjen e tokave të zonës Kala e Dodës, Sllovë dhe Sllatinë në rrethin e Dibrës dhe në disa kooperativa bujqësore në rrethin e Kukësit. Mbi bazën e burimeve të pastra e të ftohta të Korabit është ndërtuar ujësjellësi i Peshkopisë dhe i 18 fshatrave me një prurje prej 121 litra ujë në sekondë.

Për ujiten e tokave në Dibër me interes janë edhe disa përrenj malorë si ai i Ostrenit, Radoveshit, Llixhave, Gramës, Maqellarës etj., përrenj të cilët bartin ujërat e dëborës dhe venë nën ujë qindra hektarë tokë. Me nikoqirllëk janë shfrytëzuar burimet si ato të Vleshës, Kovashicës, Zerqanit, Boroës etj. të cilët llogariten të kenë një prurje prej 200-600 litra në sekondë, si dhe shumë burime të tjerë me një prurje nën 100 litra ujë në sekondë.

Dibra ka shumë liqene malorë me origjinë tektonike akullnajore. Liqenet e Lurës janë të njohur për bukurinë e tyre që të mahnit. Por po kaq të bukur janë edhe liqenet e Kacnisë, liqenet e Tërnovës, të Bulqizës etj. Dora e kujdesshme e dibranit bukurisë së tyre i shtoi edhe begatinë.

Këto burime përbëjnë një pasuri të madhe për bujqësinë në rrethin e Dibrës, përbëjnë një pasuri të madhe edhe për energjetikën. Nga hidrocentralet e vegjël lokalë në Dibër, hidrocentrale të ndërtuar kryesisht mbi kanale ujitës, sot sigurohen mbi 15 milionë kilovatorë energji elektrike në vit dhe është në zbatim studimi për të ndërtuar në kaskadat e kanaleve e kanaleve malorë edhe disa

(Vijon në faqen 20)

ANALIZË

Pavarësia energjetike e kujt?

(Vijon nga faqja 7)

energjisë mund të rritet më shpejt se sa rritja ekononike, njësoj me rritjen ekonomike, ose më ngadalë se sa rritja ekonomike. Kjo varet shumë nga lloji i ekonomisë që do të ndërtohet dhe eficienca energjetike.

Duke pasur parasysh këto dy tregues, pra rritjen ekonomike dhe eficiencën energjetike, mund të hamendësojmë se tre skenarë bazë: i pari është që eficienca energjetike të jetë më e keqe ndërsa prodhimi rritet. Me pak fjalë, kur Shqipëria të ketë GDP për frymë prej 12 mijë dollarësh në vit, atëhere konsumi energjetik do të duhet të jetë rritur me më shumë se sa dy herë. Kjo do të thotë se nëse Shqipëria konsumon sot 8.4 TW/h energji elektrike, atëhere kur ekonomia të dyfishohet, do të na duhen më shumë se 16.8 TW/h. Skavica, e cila, kur të ndërtohet, nëse ndërtohet, do të prodhojë 1.8 TW/h në vit, vështirë se do të mbulojë nevojat e zhvillimit ekonomik për më shumë se pak vite. Veçse në rast se Rama ka ndonjë plan për ta mbajtur vendin të pazhvilluar, atëhere po, Shqipëria mund të bëhet një vend i vetëmjaftueshëm energjetik, njësoj siç është i pavarur bariu në mal.

Diskursi për "pavarësi energjetike" është absurd edhe në një drejtim tjetër. Aktualisht, nga të 8.4 TW/h energji që ne konsumojmë, 64% prodhohen nga KESH ndërsa pjesa tjetër prodhohet privatisht ose importohet. Prodhimi privat në Shqipëri paguhet njësoj si importi. Dhe Skavica, ka gjasa që do të ndërtohet privatisht dhe shqiptarët do të duhet ta paguajnë. Rama nuk ka dhënë ndonjë shpjegim publik se sa do të na kushtojë Skavica, sa do të na kushtojë energjia e prodhuar prej saj dhe se si do të paguhet. Por besoj gjithsesi se ai në fund fare do të duhet në ndonjë farë mënyre, të na shpjegojë se ku qëndron pavarësia energjetike dhe vetëmjaftueshmëria energjetike në rast se shqiptarët paguajnë energji private të prodhuar në Dibër në vend që të paguajnë energji private të importuar. Pasoja ekonomike dukshëm është njësoj. Nëse sot shqiptarët paguajnë energjinë e prodhuar privatisht në Devoll njësoj me energjinë e importuar, në kushtet kur Devolli është një kaskadë në prodhim të huaj, shqiptarëve dukshëm nuk i ndryshon gjë.

EKONOMI E PISTË APO EKONOMI NEUTRALE

Nëse ne biem dakord se Shqipëria është një vend i varfër dhe synimi është që të zhvillohet, atëhere na duhet të mendojmë me të vërtetë për llojin e ekonomisë që duam të zhvillojmë, impaktin mjedisor të kësaj ekonomie, ritmin e rritjes dhe intensitetin energjetik.

Ka një teori, e cila quhet Kurba mjedisore e Kuznets-it, e cila thotë se një vend në zhvillim detyrimisht do të duhet të konsumojë më shumë energji për dollarë vlerë të shtuar se sa një vend i zhvilluar.

Simon Kuznets është ekonomisti amerikan që përkufizoi një mënyrë të matjes së ecurisë së ekonomisë, të cilën sot e njohin si Prodhimi i Brendshëm Bruto. Ai njihet se ka zhvilluar edhe teorinë e Kurbës Kuznets, e cila sugjeron se pabarazia rritet gjatë fazës së parë të industrializimit për t'u pakësuar më vonë. Nga kjo teoria e pabarazisë ka rrjedhur edhe teoria e Kurbës Mjedisore, e cila sugjeron se një ekonomi në zhvillim konsumon sasi të mëdha energjie dhe rrjedhimisht shkakton ndotje të mëdha para se të bëhet një ekonomi moderne, me intensitet energjetik të ulët dhe mallra e shërbime me vlerë të shtuar të lartë, njolla energjetike e të cilave është e vogël.

Gjithsesi, duke e ditur eksperiencën e botës që është zhvilluar para nesh, Shqipëria ka mundësi që të punojë në drejtimin që kurba mjedisore e Kuznetsit të mos bëhet realitet, që vendi të mund të bëhet njëkohësisht edhe i zhvilluar edhe jo shumë i ndotur. Për shembull, përdorimi i energjisë diellore për ujë të ngrohtë, aty ku është e mundur, fjala vjen, shkolla, kopshte, institucione publike, mund të kursejë konsum të energjisë elektrike. Përdorimi i gazit ose i naftës së rëndë për ngrohje, së paku në institucionet publike të mëdha, si fjala vjen, kryeministria, kursen paratë dhe impaktin mjedisor të kondicionimit. Përdorimi i drejtpërdrejtë i naftës ose gazit për ngrohje dhe ftohje është masa më elementare kursyese e energjisë, sepse nëse përdor energji elektrike, atëhere zakonisht të duhet të djegësh naftë ose gaz për të prodhuar energji elektrike para se të përdorësh këtë të fundit për ngrohje apo për ftohje.

Ndërsa përdorimi i paneleve fotovoltaike në zonat bregdetare mund të reduktojë impaktin mjedisor të sektorit të turizmit, i cili ta ha mendja se mund të jetë një faktor pozitiv në rritjen ekonomike. Në rast se punohet mirë dhe me politikat e duhura, vendi mundet që të arrijë të rrisë ekonominë, me fjala vjen, 6% në vit ndërsa rrit konsumin e energjisë me 3% në vit. Në këtë skenar, konsumi i energjisë elektrike në vitin 2033 do të jetë 12 TW, nga e cila, Skavica nuk do të mbulojë dot as gjysmën ndërsa pjesa tjetër do të duhet të importohet, ose të prodhohet në termocentrale me naftë ose gaz të importuar.

Të gjitha këto janë diskutime të vlefshme për politikat publike. Por "pavarësia energjetike" dhe "Shqipëria vend eksportues neto", këto janë diskutime po aq të vlefshme sa edhe "Shqipëria, fanar ndriçues" dhe "Shqipëria, shkëmb i pamposhtur përballë imperializmit dhe revizionizmit".

Marrë nga
https://www.reporter.al/2022/04/27/pavaresia-energjetike-e-kujt/

cyan magenta yelloë black



Pranvera në Dibër

Fermerët mbjellin tokën, pavarësisht vështirësive që përballen me rritjen e çmimeve

Nga **Osman XHILI**

Ka kohë që fermerët e Dibrës e kanë shpallur hapjen e vitit të ri, duke realizuar punimet sipas kalendarit bujqësor. Shërbimet në drufrutore, kujdesi për shërbimet në grurë, mbjellja e misrit, patates, jonxhës e shumë të tjera si këto, janë e do të mbeten pikat orientuese në punën e tyre.

Normalisht, e para në agjendë, për nga koha e realizimit, do të ishin shërbimet në drufrutore. Krasitja mbetet gjithnjë një shërbim i panegociushëm, që kërkon vëmendje dhe specialistë të aftë. Koha këtë vit ka qenë e përshtatshme për të realizuar këtë gjë dhe të gjithë fermerët e mbyllën në kohën e duhur. Duhet të theksojmë se krasitja e qershisë në këto vitet e fundit është bërë modë, pasi ekzistonte koncepti, se ajo nuk ishte e nevojshme në këtë kulturë.

Fill pas saj fermerët janë përqendruar tek plehërimi i drufrutorëve. Një pjesë e kësaj pune ka nisur që në vjeshtë me punime dhe pleh organik, për tu pasuar me plehra komplekse, dapin dhe shumë të tjera, që normalisht bëjnë pastaj diferencën në prodhim.

Por, gjithsesi nuk duhet harruar dhe një element shumë i rëndësishëm në punën sa të vështirë, aq dhe të bukur dhe eksperimentuese me drufrutorët. Po të mos ishte spërkatja e pemëve, shumë sëmundje e dëmtues si kroma, krimbi, kalbëzimi e të tjerë akoma, do ti zeronin hallkat e tjera të punës së bërë. Spërkatjet e para kanë nisur që herët me gurin e kalit dhe pastën bordoleze, si trajtime dimërore. Më pas do të vijnë trajtimi me shampion, vaj mineral, si dhe deçizin si insekticid. Lufta ndaj kromës së mollës, sigurisht që mbetet sfida më e madhe e fermerëve dhe nëse e bëjnë atë me sukses, kanë garantuar mbi gjysmën e punës.

Normalisht, duhen deri në gjashtë spërkatje për të luftuar kromën, të shtrirë në një hark kohor prej gati dy muajsh. E para fillon diku nga data 20 prill, për të vazhduar me një interval dhjetë ditor deri nga 15 qershori.

Shihet një interes i fermerëve për të tërhequr farën e misrit nëpër farmacitë bujqësore, por ata janë të zhgënjyer nga farërat e pakontrolluara, duke marrë rendimente qesharake. U takon institucioneve përgjegjëse të bëjnë përzgjedhjen e farërave në mënyrë profesionale, të bëjnë provën e mbirjes, të certifikohet rezultati dhe vetëm atëherë të kalohet për mbjellje.

Në bashkëpunim me fondacionin "Mada, janë ngritur tre stacione prognoze tek fermat e Veip Salkurtit, Medin Kryemadhit dhe Premtim Agollit. Në bazë të analizimit të temperaturës dhe lagështisë, përcaktohet afati optimal i spërkatjes dhe u dërgohet mesazh fermerëve të kontaktit për të realizuar spërkatjen e radhës.

Shërbimet në grurë janë shumë të rëndësishme në përcaktimin e rendimentit të kësaj kulture. Këtë vit shirat erdhën me pak vonesë, por sërish janë realizuar dy duar nitrifikimi me nga 15 – 20 kilogram nitrat ose ure për dynym .Pritet të bëhet dhe një tjetër në vatra , për ta plotësuar më së miri këtë detyrim ndaj kulturës së grurit. Duhet thënë se numri i bimëve të grurit për njësi sipërfaqe është mjaft i mirë këtë vit, duke garantuar dhe një rezultat të kënaqshëm. Disa fermerë të kujdesshëm po bëjnë dhe luftimin e barishteve të këqija, apo luftimin e disa sëmundjeve specifike të grurit, si fusarioza, septarioza, apo kalbëzimi i qafës.Mbjelljet pranverore janë dhe kryefjala e fermerëve, si në Dibër, ashtu dhe në të gjithë vendin. Vlen të përmendet mbjellja e misrit të shoqëruar me fasule, por ka dhe plot kultura të tjera, që zenë një vend të rëndësishëm. Ka një interes të fermerëve për të tërhequr farën e misrit nëpër farmacitë bujqësore. Farërat më të preferuara mbeten serbe,të Zemun Polje, llojet 555, 606, 434, dhe 344. Të pëlqyera mbeten dhe llojet kroate "Paidash", "Maistor", apo lloji amerikan"Golden".

Duhet përmendur se ndonjëherë, fermerët janë zhgënjyer nga farërat e pakontrolluara, duke marrë rendimente qesharake. I takon ministrisë së bujqësisë nga qendra në bazë, apo anasjelltas, të bëjnë përzgjedhjen e farërave në mënyrë profesionale, të bëjnë provën e mbirjes, të çertifikohet rezultati dhe vetëm atëherë të kalohet për mbjellje. Në raste kur nuk zbatohen këto procedura, kompanitë importuese duhet të vihen para sanksioneve të rënda nga inspektoriati fito sanitar.

Do të donim të përmendnim një traditë të hershme të instituteve të ndryshme, si ai i misrit dhe orizit në Shkodër, ai i patates, apo i foragjereve në Fushë Krujë. Për hir të vërtetës, duhet thënë se ata bënin një punë të lavdërueshme duke i dhënë bujqësisë shqiptare lloje e kultivarë vitalë, rezistentë e me prodhimtari të lartë. Nëse nuk prodhojmë makina dhe nuk kemi gati asnjë lloj industrie, të paktën të prodhojmë farën e misrit, të grurit, të patates, jonxhës e shumë të tjera si këto.

Sot ka dy tendenca nga fermerët, si në Dibër dhe më gjerë akoma, në lidhje me mbjelljet, kryesisht për grurin dhe misrin. E para është tërheqja nga mbjellja e këtyre kulturave, duke i mëshuar idesë se nuk ka fitim, pasi janë ngritur ndjeshëm nafta dhe plehrat. Nëse një kuintal nitrat, vitin e kaluar shitej me 35 mijë lekë, këtë vit ai është më shumë se trefishuar, duke kapur kuotën e 115 mijë lekëve. Po kështu ngritje galopante kanë pësuar ureja, dapi dhe plehra të tjera komplekse. Duke i shtuar kësaj panorame dhe dyfishimin e naftës, ata kanë zgjedhur tërheqjen dhe lënien e tokës djerr.

Por, duhet thënë se ka dhe një kategori tjetër fermerësh, që e shohin më me optimizëm këtë situatë. Sa i përket naftës, ata mendojnë se subvencioni që jep qeveria me dhjetë litra për dynymë e zbut sadopak koston e lartë të punimeve. Ata kanë dhe një argument tjetër për tu ingranuar në mbjellje. Vërtet është ngritur ndjeshëm çmimi i plehrave, por mos harrojmë se është ngritur ndjeshëm dhe vlera e misrit dhe e grurit në treg. Sot, një kuintal misër shitet me 55 mijë lekë, kur vitin e kaluar ishte vetëm 30 mijë. Ndoshta, ashtu si në blegtori, ku fermat më të mëdha po lënë në hije mbajtjen e një, apo dy lopëve, dhe tek mbjellja po vihet re diferencimi i fermerëve.

Sot ka dy tendenca nga fermerët në lidhje me mbjelljet, kryesisht për grurin dhe misrin. E para është tërheqja nga mbjellja e këtyre kulturave, duke i mëshuar idesë se nuk ka fitim, pasi janë ngritur ndjeshëm nafta dhe plehrat. Por ka dhe një kategori tjetër fermerësh, që e shohin më me optimizëm këtë situatë. Është ngritur ndjeshëm dhe vlera e misrit dhe e grurit në treg.

Agronomi në pension, ish shefi i shërbimit të ekstensionit për qarkun e Dibrës, Qatip Doda, na jep disa emra fermerësh, që guxojnë të mbjellin sipërfaqe disa hektarëshe me grurë dhe misër. Së pari, mund të përmendim vetë shembullin e tij, që këtë vit ka mbjellë 25 dynym me grurë. Ai i ka kryer të gjitha shërbimet në këtë kulturë dhe pret rezultate mjaft të kënaqshme. Një tjetër fermer i suksesshëm në zonën e Maqëllarës është Ahmet Sala. Ai zotëron një fermë me dhjetë krerë lopë, si dhe ka mbjellë 15 dynym misër, 15 dynymë grurë dhe një tjetër sipërfaqe të konsiderueshme me foragjere. Këto shembuj po ndiqen dhe nga fermerë si Alltan Sala, Siri Xhika, Pajtim Asllani e të tjerë si këto. Vlen të përmendet rezultati i fermerit Selim Kosiqi, nga fshati Obok, që në katër dynymë të mbjellë me misër, mori dhe tetë kuintalë fasule si bimë shoqëruese.

Të gjithë këto shembuj tregojnë, se ku ka përkushtim, punë dhe vizion, rezultatet janë mjaft të mira, por gjithsesi dhe ndihma e shtetit duhet të jetë më e madhe, që të mos i lëmë tokat djerr dhe të mos boshatisen fshatrat, që i kemi amanet dhe trashëgim nga të parët tanë.

U mbajt në Peshkopi konferenca shkencore kushtuar arsimit në gjuhën shqipe.

108 vite shkolla shqipe në Dibër



Zyra vendore e arsimit parashkollorë (ZVPA) në bashkëpunim me Myftininë dhe Bashkinë e Dibrës, në përkujtim të 108 vjetorit të shkollës së parë shqipe në Dibër, organizuan me datë 23 prillë 2022 një konferencë shkencore. Në këtë konferencë ishin ftuar të kontribuonin me kumtesat e tyre, studiues dhe mësues e drejtues me përvojë të spikatur të arsimit në Dibër dhe Tiranë. Zhvillimin e konferencës e ndoqën Kryetari i Bashkisë, z. Rahim Spahiu, Myftiu i Dibrës, Mois Kurtulla, përgjegjësja e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar në bashkinë Dibër, znj. Brigena Dani, personalitete të fushës së arsimit etj. Kjo konferencë kish si qëllim kryesor të rikthejë traditën e dikurshme të organizimit të këtyre formateve të diskutimit e të përpunimit të mendimit të thelluar e shkencor, në funksion të përmirësimit të të gjithë komponenteve të sistemit të arsimit në Dibër. Në këto konferenca bëheshin objekt diskutimesh problematikat e shqetësimet e gjetura në etapa të ndryshme të zhvillimit të arsimit në rreth, shkëmbeheshin përvojat, sukseset në nivel kombëtare dhe të arriturat më të reja shkencore në procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Rikthimin e kësaj tradite synonte edhe organizimi e mbajtja e konferencës "108 vjet shkolla shqipe në Dibër".

Konferenca e meritoi cilësimin "shkencore", sepse në të sollën kontributet e tyre mbajtës të titujve e gradave shkencore, të cilët sollën punime të përgatitura mbi parimet e punës kërkimore dhe duke sjellë mendim dhe gjetje të reja në trajtimin e tematikave të zgjedhura për studim.

Paraqiten kontributet e tyre në këtë konferencë 12 studiues, të cilët kishin zgjedhur të trajtojnë kryesisht tematikë nga historia e zhvillimit të arsimit në Dibër, që evokonin hapjen e shkollës së parë në Peshkopi dhe rolin e Mësuesit të Popullit Haki Sharofi, trajtesë të cilën e paraqiti ish – myftiu Ahmet Çaushi - njëkohësisht dhe një ish nxënës i Sharofit; Rolin e klerit dhe të fesë islame në hapjen e shkollës shqipe, trajtesë të cilën e paraqiti Myftiu i Dibrës Musa Kurtulla.

Me shumë interes u pritën kumtesa e paraqitura nga prof. dr. Adem Bunguri: "Internati i Kastriotit", si dhe kumtesa e prof.as.dr. Moisi Kamberi, "Përpjekjet për përhapjen e arsimit në Dibër deri në shpalljen e pavarësisë".

Mësuese Teuta Qosja paraqiti kumtesën "Gjuha shqipe - simbol i identitetit kombëtar" dhe mësuesja Miranda Zuna kumtesën "Kushtet që çuan në hapjen e shkollës së parë shqipe në Dibër".

Kumtesën "Zhvillimet i arsimit në Dibër në vitet 1944-1990 - vështrim kritik në funksion të proceseve reformuese e integruese në BE" e mbajti studiuesi Hysen Uka.

Mësuesi veteran Faris Cibaku, kishte bërë objekt të trajtesës së tij "Personalitete të spikatura të arsimit në Dibër". Mësuesi dhe menaxheri me përvojë, Blerim Lazimi, trajtoi temën: "Kleri islam dhe roli i tij në përhapjen dhe zhvillimin e arsimit".

Trajtesë interesante paraqiti edhe mësuesi me përvojë dhe specialist në ZVAP, nismëtari dhe kontributori kryesor në organizimin dhe zhvillimin e konferencës, z. Mezin Shehu, i cili në trajtesën "Arsimi dibran, ç'ka qenë, ç'është dhe çdo të bëhet", vuri theksin në arritjet dhe në mangësitë që shfaq sistemi arsimor aktualisht në Dibër, por jo vetëm, dhe listoi disa gjetje e rekomandime kuruese për tejkalimin e problemeve dhe përmirësimin e ngritjen e standardit të arsimit në Dibër.

Konferencën e përshëndetën edhe Kryetari i Bashkisë, Rahim Spahiu, i cili vlerësoi lart punën e bërë nga studiuesit dhe e konsideroi produktin e kësaj konference si një referencë në punën e tij drejtuese për të ndryshuar gjendjen në sistemin arsimor në Bashkinë Dibër. Kryetari i bashkisë premtoi se çështjet e arsimit do të jenë në krye të listës së përgjegjësive dhe përpjekjeve të tij për të kthyer arsimin në Dibër, në krenarinë e famën e mirë të dikurshme.

Materialet e konferencës, pas vlerësimit të një redaksie të specializuar, të ngritur posaçërisht, do të rishikojnë materialet e paraqitura sipas kritereve të botimeve shkencore dhe do gjejnë mundësinë financiare që të botohen të plota, nën logon e konferencës.

Korresp.Rr.A.

Arsimi dibran "ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet"



Nga Mezin SHEHI

Në këndvështrimin tim duke e nisur me atë se ***"Ç'far ka qenë arsimi në Dibër"*** apo ecuria e zhvillimit të arsimit në Dibër mendoj që kjo kalon në për disa faza ose periudha, për të qen më i saktë në katër të tilla. Shkurtimisht po ndalem tek këto.

Periudha apo Faza e pare është ajo e rilindjes dhe e lëvizjes kombëtare, faza e Ilegalitetit të arsimit shqip në Dibër

Në këtë periudhë si në të gjitha trevat e tjera shqipëtare, lëvizja arsimore edhe në Dibër mori përmasa të mëdha, për më tepër që Dibra ishte krahinë determinuese në gjith Shqipërin verilindore, kjo si nga pikpamja gjeografike por ashtu edhe nga pikpamja historike dhe kulturore.

Shkendijat e para apo përpjekjet e para për hapjen e shkollave shqipe si kudo në trevat shqiptare u dhanë në kohën e rilindjes kombëtare, ku gjurmëve të vëllezërve Frasheri, Koto Hoxha, Veqilharxhit, Pashko Vasës, Ndre Mjeda, Petronini Luarasi dhe të tjerë rilindas kombëtar ishin pa asnje dyshm edhe pishtarët si Said Najdeni, Vehbi Dibra, Sheh Zerçani, etj të cilet me besim dhe vetëdije patriotike nisën atë rrugëtim të vështirë për gjuhen amtare.

Lufta për shkollen shqipe në Dibër fillon që në vitet 30 te shekullit XIX.. Ne vitin 1835 Sheh Fejz Bulqiza hapi nje shkollë në fshatin Vajkal në kullën e tij, mësimet zhvilloheshin me shkronja arabe. Po në vitin 1847 ai do e rihapte perseri këtë shkolle në fshatin Koçë të Bulqizës.

Në programin e Lidhjes se Prizrenit dega e Dibrës më 14 tetor 1878 u hartua një rezolutë që u miratua në kuvendin e Dibrës më 1 nëntor 1878 ku theksohej mësimi në shkollë i gjuhës shqipe. Me hapjen e mësonjëtores së parë shqipe në Korçë më 7 mars 1887 nën shembullin e saj në vitin 1888 Seid Najdeni(Hoxhë Voka) hapi nje shkollë shqipe ne shtëpine e tij ne Dibër të Madhe, kjo shkollë nuk qëndroi gjatë, por ai do ta rihapte atë ne vitin 1893. Po ashtu Shaqir Daci në vitin 1894 do hapte një shkollë shqipe në fshatin Homesh dhe Hamdi Ohri në vitin 1895 në Dibër të Madhe shkollë që vazhdoi deri më 1899. Shembullin e tyre ndoqi dhe Hoxhë Hasan Moglica në fshatin Okshtun ku fshehurazi do u mësonte njerëzve shqip. Ne vitin 1900 Said Najdeni botoi në Sofje abetaren e gjuhës shqipe, një abetare e shkruajtur me alfabetin e Stambollit që u shpernda në te gjitha zonat e Dibrës. Një rol te veçantë në kulturën dibrane dhe shqiptare luajti dhe rilindasi shqiptar nga Reka Josif Bageri atdhetar, poet dhe publicist.

Një vatër edukimi per Dibrën ishte dhe Klubi Bashkimi me qendër ne Dibër të Madhe që u hap në Dhjetor 1908, kryetar i saj ishte Hafuz Sherif Langu. Në Kongresin e Dibrës në Korrik 1909 me kryetar Vehbi Agollin u vendos që të hapeshin shkolla fillore e te mesme në gjuhën shqipe. Në maj 1910 në Zerqan u hap shkolla shqipe nën kujdesin e Sheh Sulës me mësues Mustafa Sulën. Shkolla shqipe ashtu si në gjitha viset e tjera shqiptare do përndiqej rreptësisht nga autoritetet osmane, mësimet zhvilloheshin fshehurazi.

Në 1912 kemi për herë të parë lejimin e hapjes se shkolles shqipe në Dibër nga Valiu i Manastirit në Rrekë të Dibrës së madhe. Gjatë qeveris së Vlorës kemi disa përpjekje për arsimin në shqip, Gjuha shqipe u shpall gjuhë zyrtare e shtetit shqipëtar. Në prill 1914, konkretisht më 14 prill kemi të parën shkollë shqipe në Peshkopi nga mësuesi Haki Sharofi i cili pasi kishte mbaruar normalen e Elbasanit, një kurs 6-mujor që u jepte titullin "Mësues" mori lejen në atë kohë nga qeveria e Vidit për të hapur shkollën shqipe dhe ishte emëruar mësues në Peshkopi. Pas tij shkollat shqipe do hapen në Trebisht, Ostren, Dohoshisht, Trojak, Sllovë e me radhë Sohodoll, Brezhdan, Kala e dodës etj.

Veprimtarët dibran të cilët kanë lënë gjurmë si Said Najdeni, Hoxh Muglica, Vehbi Dibra, Haki Sharofi, Haki Stermilli, u bën shembuj kuptimplot dhe motive të padiskutueshëm frymëzimi për brezat e mëvonshëm si Selim Alliu, Tefta Cami, Edip dhe Irfan Tërshana, Nuri Abdiu, Shaban Arra, Myslym Shehu, Nazmie Pasholi, Selim Qyshka, Kumrie Shehu e Fasli Cami, Ramadan Gjorllaku e Fadil Perhati, Islam Kosova e Taxhedin Shehu, Lutfi Manjani e Nevruz Manjani, Bashkim e Merita Lala e shum e shumë të tjerë të cilët pa dashje mund ti kem harruar por që shënjuan një epok në arsim. Ajo rrugë e nisur prej tyre duke filluar nga shkolla e parë, te Internati i Kastriotit në 1923 , te shkolla femërore në 1925, shkolla profesionale në 1945, shkolla pedagogjike 1946, gjimnazi në 1962-1963, dhe shumë e shumë të tjera pa dashur tu heq rëndësinë, bën që Dibra të nxjer personalitete të gjithanshëm në çdo fushë të jetës.

Sigurisht që të flasësh për ngjarje që e kan zanafillen në këtë periudh fund shekulli XIX nuk është e lehtë, aq më tepër për ngjarje që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe përhapjen e gjuhës amtare, e cila gjatë rilindjes kombëtare u vendos në qendër të vëmendjes së rilindasve tanë. Pas shumë shekujsh pushtim problemi shtrohej "A do behej shtet Shqipëria apo do ngelej thjesht një pik Gjeografike siç thoshte Bismarku. Por një komb asesi nuk mund të bëhet në se nuk ka historinë, gjuhën, kulturën, shkollën e tijë. Dhe në këtë kuptim është gjuha dhe shkolla shqipe ato që u bënë shpresa që i bashkonte gjith shqipëtarët.

Në këtë periudhë nëpër trevat shqipëtare hapej aty këtu fshehurazi ndonjë shkollë, mejtepe ku mësohej turqisht dhe shqip por ato mbylleshin sapo të zbuloheshin nga autoritetet osmane.

Në fakt nga vitet 1800 e pas janë intensifikuar përpjekjet për identifikimin e shqipes e cila lidhej ngushtësisht me identifikimin e kombësisë. Ishte pikërisht kjo që i bashkoj patriotët tanë pa dallim feje krahine apo ideje dhe u bënë një për çeshtjen më të madhe të kombit *"Për hapjen e shkollave shqipe"*, dhe pikërisht në këtë kuadër kemi krijimni e disa organizatave patriotike si "Atdheu", "lidhja e Mësuesve", "Bashkimi"etj, në të cilat dy ishin çështjet që diskutohen:

1. Formimi i shteti shqipëtar.

2. Hapja e shkollave në gjuhën amtare.

Ishte kjo periudhë kur u botuan një sërë abetaresh si ajo e Veqilharxhit 1844, 1845, Kristoforidhit 1867, 1868, Daut Boriçit 1869, Alfabetarja e Stambollit 1879 etj.

Në Dibër ndërkoh beteja për hapjen e shkollave vazhdonte mes shum peripecive. Kemi disa të tilla në Shehër, Zerqan, Homesh, të cilat u mbyllën shumë shpejt sapo u diktuan, ndaj dhe e qujta këtë faze si "Ilegaiteti" i hapjes së shkollave shqipe. Hapja e shkollës shqipe në Korçë shërbeu për të evidentuar faktin se shkolla shqipe ishte tani më një rrealitet që mund të arrihej, pra mund të rrealizohej.

Eshtë për tu theksuar fakti se bashkë me atë të Korçës në Rekë të Dibrës u hap një shkollë shqipe por u mbyll shum shpejt. Patriotët dibran organizua disa kuvende dhe takime për çështjen e arsimit më i rëndësishmi është ai i nëntorit 1889 që konkludoj me një kërkesë për lejimin e hapjes shkollës shqipe. Krahas kësaj "Ilegaliteti"i shkollave shqipe vazhdonte me shkollat e Said Najdenit 1888, Shaqir Dacit 1893, Hamdi Ohrit 1891, u hapën dhjetë shkolla shqipe nëpër fshatrat e Dibrës, duhet të theksojm këtu karakterin fetar të tyre. Drita në fund të tunelit fillon në 1912 kur u lejua hapja e shkollës shqipe në Dibër të Madhe.

Kjo është edhe faza apo periudha e dytë e zhvillimit të arsimit në Dibër dhe që unë do ta quaja legaliteti i zhvillimit të arsimit në Dibër dhe kjo periudh zgjat deri në 1924.

(vijon numrin e ardhshëm)

Ende në kujtesën popullore dibrane ruhen disa raste, që zor se shekujt që vijnë, do t'i pluhurosin. Kështu, në të folurën e përditshme ende dëgjon të përmenden togfjalëshat si: 1.Kanuni në kal'hipt'; 2.Kanuni i shekës së kosit; 3.Kanuni i ndarë mekëmesëapo edhe 4.Pajtim, o dilni fare!

Veçanti në ndarjet kanunore në Dibër

Nga **Haki PËRNEZHA**, *studiues*

Traditat ndër shqiptarë kanë ngjashmëri njëra me tjetrën, por edhe dallime e veçori, të cilat vërehen nga një krahinë në tjetrën. Krahinat (Malet) e Dibrës, përkundër disa ndryshimeve të vogla, në lëmin e organizimit të vetëqeverisjes sipas së drejtës dokësore, kanë ngjashmëri të plotë, e cila, tregon dhe shkakun pse emërtimi "***9 Malet e Dibrës***" erdhi deri në ditët tona.... Ruajtja e së drejtës për tu vetëqeverisur sipas dokeve vendore, veç tjerash, pati rëndësi se siguroi "*... mbijetesë rendit fisnor, si një formë vetëmbrojtjeje prej ligjeve të një perandorie teokratike dhe ushtarake...*"[1] Kjo e drejtë, është "përkundur" në shtratin e rendit etnojuridik, i cili, sipas etnologëve "*... është shumë më i hershëm se ai i kanuneve*"[2]dhe që ka lulëzuar para pushtimit osman. Këtë pasuri e vlerë shpirtërore, në shekuj "*... nuk e humbën as ilirët nën sundimin romak e as arbrit nën sundimin bizantin. Në bashkësitë e tyre ata gëzonin një farë vetëqeverisjeje dhe zbatonin të drejtën zakonore lokale, sidomos në çështjet gjyqsore.*"[3]Studiues të ndryshëm, realizimin e vetqeverisjes e lidhin edhe me shkallën e madhe të urbanizimit të trevës i cili shihet "*që në periudhën e kalimit prej lashtësisë antike në atë mesjetare.*"[4]

Është e kuptueshme që ky zhvillim e urbanizim mesjetar, nënkupton edhe zhvillimin e rendit etnojuridik, i cili në fund të fundit shprehej me rregulla e parime të cilat rregullonin jetën e malësorëve. Këto rregulla, të quajtura "*kanun*", i cili"*...mësohej përmendësh si një trashëgimi...*"[5] dhe që mbijetoi falë përpjekjeve e luftrave të shumëta "*me armë në dorë kundra sllovenve e kundra turqve...*"[6]u ruajtën dhe u mbajtën gjallë deri në ditët tona. Çdo Mal a Krahinë, përfshi edhe pjesën fushore të Dibrës, kishte kontributin e vet në këtë mori rregullash e parimesh, fillimisht morale e më vonë edhe norma juridike të cilat mbartnin "*të gjitha tiparet e një të drejte që shkon në përputhje relative me besimet dhe me vlerat morale.*"[7]të asaj shoqërie që gjallonte në hapsirën dibrane. Kështu prej kohësh, në etninë dibrane të vendosur si në pjesën malore por edhe në atë fushore, shërbente tradita vendase në zgjidhjen e problemeve të së drejtës dhe kjo si "*dëshmi e lashtësisë dhe mbijetesë kulturore.*"[8]Pas vitit 1839, trysnia e pushtetit osman u bë më e madhe dhe ia arriti të ndërhyjë dhe të imponojë zbatimin e sheriatit në pjesën fushore të Dibrës e për pasojë, u shkatrrua "ngrehina" e Vetqeverisjes. Ndërsa në pjesën malore të Dibrës, "Vetqeverisja" u ruajt përkundër tentativave osmane për të ndërhyrë në sistemin juridik të malsisë. Sipas disa studiuesve, shtrëngimi për zbatimin e sistemit të sheriatit në Male, ishte njëri ndër shkaqet që ngjalli revoltë të madhe dhe që solli edhe Luftën kundër Hajredin Pashës 1844. Malet e Dibrës ia arritën ta ruajnë të paprekur vetqeverisjen sipas së drejtës zakonore, e cila sipas Pulahës, vetëm në këtë mënyrë, njësitë krahinore mundën t'i siguronin individit "*mbrojtjen e gjithë kolektivit, të fshatit e gjithë krahinës.*"[9] Pavarësisht nga lloji i pushtuesit të radhës që ka shkelë këto troje, ligjet zakonore, të cilat kanë rregulluar jetën shoqërore në male, i janë nënshtruar një procesi të gjatë dinamik, duke iu përshtatur rrethanave të krijuara. Zhan Klod Faveirial vëren se "*... malësorët janë të përjashtuar nga taksa e së dhjetës dhe taksa e tokës. Ata udhëhiqen nga disa ligje zakonore që kryetarët e fiseve i zbatojnë në* çështje *civile dhe kriminale, pa asnjë ndërhyrje të gjyqësorve turq.*"[10] Edhe akademik Kristo Frashëri, vëren të njëjtën gjë kur flet për dy nga tre figurat që mbajtën më këmbë Vetqeverisjen në Malet e Dibrës. Ai përmend "*dy figurat e larta të shoqërisë patriarkore Plaku, këqyrsin e së drejtës zakonore dhe Kefalinë, udhëheqësin ushtarak të bashkësisë.*"[11] Duke vlerësuar se "*e drejta është ideali i ligjit dhe jo e kundërta*"[12]në të gjithë njësitë etnokulturore dibrane në përgjithësi janë evidentuar përpjekje serioze në dhënien e drejtësisë. Dhe kjo ka ardhë pasi në Malet e Dibrës ka qenë i madh kapaciteti i fiseve për të nxjerrë pleqë kanuntarë. Prof Nebi Bardhoshi këtë e quan ***hierarki*** e cila "*vlerësohet më së tepërmi për të klasifikuar fiset, fshatrat, krahinat*"[13] Pleq të ndryshëm dibranë, të regjur në punë të kanunit, kanë shkëlqyer në dhënien e zgjidhjeve interesante në situata të ndërlikuara. Shpeshherë ata kanë ***krijuar*** mbi shtratin a mbi kornizën e së drejtës zakonore duke "*prodhuar*" norma të reja juridike. Sipas Pospisil-it "*secila bashkësi apo nivel social ka kapacitetin të krijojë normat e veta juridike.*"[14]Jo rrallë herë këto norma janë shndërruar në zgjidhje duke u bërë ***kazus*** dhe kanë shërbyer si ***motërzime*** për raste të tjera të ngjashme si brenda ashtu edhe jashtë krahinës. Pleqë kanuntarë të dalë nga fise të shquara si Murrja, Pira, Noka, Lusha, Kaja etj-etj, kanë kontribute të prekshme në lëmin e së drejtës zakonore. Pleqë të njohur dibranë të një Krahine, shpesh herë thirreshin edhe nga krahina të tjera për të ndarë kanune dhe kjo ndodhte pasi "*kufiri krahinor nuk konsiderohej si kufi ligjor*"[15] "Heret - heret,- shkruan Shtjefën Gjeçovi, *ndër të gjitha krahinat e malet e Mirditës, të Thkellës, të Malësisë së Lezhës etj,... Lusha e Noka në Qidhën të Dibrës janë pvetë ndër gjyqe e pleqni me kanu...*"[16] Për këtë arsye edhe numri i tregimeve me përmbajtje kanunore, në çdo fshat të Dibrës, është mjaft i madh dhe përbën një pasuri të madhe shpirtërore të etnisë dibrane. Janë bërë përpjkeje të lavdërueshme nga disa dibranë në këtë fushë si Xhafer Martini, Fatos Daci, Petrit Fetahu e disa tjerë, por përsëri mbetet shumë për tu bërë. Secili nga lexuesit mund të tregojë plot raste të këtyre krijimeve etnodokësore. Tregime të tilla me lëndë kanunore janë të shumta në Dibër, ato gëlojnë në gojën dhe mendjen e pleqve të urtë dibranë. Nga ky numër i madh tregimesh me përmbajtje kanunore dibrane unë zgjodha dhe paraqita Konferencë katër të tillë që kanë karakteristika dhe qasje të veçantë në rrafshin e së drejtës zakonore apo kanunin në Dibër dhe kuantropologët dhe studiuesit e së drejtës i konsideruan si ***krijime monumentale*** mbi shtratin etnojuridik e etnodokësor të etnisë dibrane.

Ende në kujtesën popullore dibrane ruhen disa raste, që zor se shekujt që vijnë, do t'i pluhurosin. Kështu, në të folurën e përditshme ende dëgjon të përmenden togfjalëshat si: 1.*Kanuni në kal'hipt'; 2.Kanuni i shekës së kosit; 3.Kanuni i ndarë mekëmesë*apo edhe *4.Pajtim, o dilni fare!*

Tani le të shpjegojmë se pse, nga kjo mori tregimesh me lëndë kanunore u zgjodhën vetëm këto raste?

Rasti i parë ose ***"Kanuni n'kalë hipt'"***është i vetëm, i padëgjuar në zonat tjera ku kanë vepruar kanune të ndryshme. Është një *krijim juridik* mbi shtratin *etnodokësor* i cili lidhet me *vrasjen e një gruaje shtatzënë* për shkak të prishjes së një lidhjeje martesore. Për zgjidhjen e këtij konflikti, pleqtë e përmendur Lusha dhe Noka në Çidhën vendosën të sfidojnë njëritjetrin duke e ndarë këtë kanun në ...*kalë*. Cilat janë kushtet a vështirësitë realizimin e kësaj praktike kanunore. **Së pari** , *pleqtë duhet të qëndrojnë në kuaj*. **Së dyti**, *kuajt ecin në drejtim të njëri-tjetrit;* **së treti***"gjyqi" fillon kur kuajt janë "kokë më kokë" dhe mbaron kur kuajt ndodhen "bisht më bisht"*. Siç mund të kuptohet, koha që pleqtë kanë në dispozicion për të ndarë këtë kanun ishte mjaft e shkurtër, vetëm 5-7 sekonda. Kjo ishte arsyeja që kjo formë nuk përdorej në ndarjet kanunore, duke mbetur "pronë" vetëm e atyre pleqve që ishin të "regjur" në punët e kanunit. Dhe së fundmi shumë dibranëve ju kujtohet një njësi frazeologjike e cila është e njëjtë me shprehjen *Kanun n'kalë* dhe ajo është*"Pse ma derdhe drithin...?-Mos e futje n'thesin tim..."*

- Rasti i dytë, ose "*Kanuni i shekës së kosit"* tregon se si njohuritë praktike a teknike shërbejnë për të dhënë zgjidhje përplasjeve në mes njerëzve.

- Rasti i tretë, "*Kanuni me kmesë"*, na njeh me një mënyrë rënqethëse për ndarjen e së drejtës. Mjeti dhe mënyra e përdorur nga plaku i kanunit për të "ndarë" përgjysmë fëmijën e pretenduar nga dy gra, është kanibalesk por që shërben për të zbardhur të vërtetën dhe dhënien e drejtësisë.

- Rasti i katërt, "*Pajtim, o dilni fare"* na njeh me një formë të veçantë shtrëngimi për pajtim. Kjo formë shtrëngimi përdorej në ato raste kur dështonin të gjithë mënyrat e pajtimit në mes palëve në konflikt.

KANUN NË ...KALË (!)

Çdonjëri prej nesh që ka ndenjur në odën dibrane, besoj, i ka qëlluar të dëgjojë dhe për ..."*kanuni në kalë"*, apo:..."*e ndan në kalë..."*. Këto shprehje, ende sot, në të folurën e zonës përdoren për të treguar një person i cili është i zoti për ti dhënë zgjidhje çdo problemi të koklavitur që lind në komunitet. Jo rrallë herë këto shprehje janë përdorë nga persona të cilët në biseda të ndryshme vetdeklaroheshin, herë me shaka e herë seroizisht, duke u shprehur: ...*këtë problem unë e "**ndaj në kalë"***

Po ç'është në të vërtetë ***Kanuni në kalë?*** Të gjithë lexuesit e dinë se kanunet bëheshin (apo ndaheshin) në odat e fshatarëve, në livadhe a kudo tjetër por jo në kalë...! Ndërsa në Çidhën të Dibrës së Poshtëme, ka ndodhë që kanuni të ndahet edhe në kalë dhe ky ka qenë momenti më pikant ku zgjuarsia dhe mendjemprehtësia e pleqve çidhnakë, është shpalosur në të gjithë dimensionin e saj të mundshëm. Pleqtë çidhnakë, Lusha dhe Noka, duke ndarë kanunin në kalë, vendosën një standard që për shumë të tjerë mbetet i paarritshëm. Askund tjetër, përveçse në Çidhën, nuk është tentuar të përdoret kjo «praktikë» kanunore, ***me nda kanunin në kalë.*** Në fakt as në Kanunin e Lekës dhe as në atë të Arbërit (Skënderbeut) nuk është e përshkruar një «praktikë» e tillë dhe kjo, mendoj, për shkak të vështirësisë dhe kushteve të «rënda» për realizimin e kësaj «norme» kanunore. Ajo që e bën gati të pamundur ndarjen e kanunit ***në kalë***, është ***koha e paktë*** që pleqtë e kanunit kanë në dispozicion për të ndarë të drejtën. Për ndonjë që nuk ka informacionin e mjaftueshëm për sa flitet, po përpiqemi të sqarojmë ***"procedurën"*** e ndarjes së ***kanunit në kalë*** për të nxjerrë në pah cila është vështirësia reale që kjo *praktikë kanunore* të mbetet «pronë» e pak pleqve. Le të përshkruajmë «hapat» që duhen bërë për të realizuar praktikën e ndarjes së një kanuni në kalë. Palët në konflikt zgjedhin pleqtë dhe janë ata pastaj që vendosin të ndajnë kanunin në kalë. Për këtë, ata në fillim caktojnë vendin e pikëpjekjes i cili duhet të jetë një shesh, livadh apo lëndinë ku të ketë mjaftueshëm hapësirë për tu ulur edhe personat që do dëshironin të ishin prezent. Pas kësaj caktohet data e zhvillimit të gjyqit. Në ditën e caktuar, në vendin ku do zhvillohet gjyqi, përveç njerëzve kureshtarë, veç e veç uleshin edhe palët që ishin në konflikt. ***Pleqtë***, nga dy anë të kundërta, qëndronin përballë njëri tjetrit në një largësi rreth 100 ml, hipur në kuajt e tyre dhe në momentin e duhur fillonin lëvizjen në drejtim të njëri tjetrit. (Foto nr 1)




Foto 1. Vendosja e pleqve në 100 ml larg e përballë njëri tjetrit.

Ecja e kuajve duhet të jetë e zakonshme. "Debati" mes pleqve fillonte kur kuajt të jenë përballë njëri-tjetrit dhe shumë afër, d.m.th "kokë më kokë", (shih fig. nr 2) ndërsa përgjigja e plakut tjetër duhej të jepej para se kuajt të ishin "bisht për bisht"(shih fig nr 3). Pleqtë kanuntarë thonë se ***kanuni në kalë fillon "kokë m'kokë dhe mbaron bisht m'bisht".***



Foto 2: Ky është pozicioni "kokë më kokë" ose fillimi i "gjyqit".



Foto 3: Ky është pozicioni "bisht më bisht" ose mbarimi i "gjyqit"

Siç mund të kuptohet, koha që pleqtë kanë në dispozicion është mjaftë e kufizuar 5-10 sekonda. Ja, pikërisht për këtë arsye kjo praktikë kanunore ishte atribut vetëm i pleqve të regjur si Noka e Lusha në Çidhën.

vijon numrin e ardhshëm

REFERENCAT:

1. Sinani Sh. "Tradita si etnotekst" fq 50
2. Sinani Sh. "Etnosi në epos" fq 202
3. "E drejta zakonore shqiptare" fq 8
4. Sinani Sh. "Etnosi në epos" fq 227
5. Sinani SH. "Etnosi në epos" fq 227
6. Palaj B. "Bota e maleve shqiptare" fq 147
7. Bardhoshi N. " Antropologji e kanunit" fq 30
8. Sinani Sh. "Antropologji etnojuridike" pj. II, fq 55
9. Pulaha S. "Konferenca Komb. e stud etnogr." fq 160
10. Frashëri K. "Konf. Komb. e stud etnogr" fq 241
11. Frashëri K. Vepër e cituar fq 240
12. Bardhoshi N. "Antropologjia e kanunit" fq 28
13. Bardhoshi N. "Antropologjia e kanunit" fq 127
14. Cituar nga "Antropologjia e kanunit" fq 131 e Bardhoshi N.
15. Bardhoshi N. "Antropologjia e kanunit" fq 123
16. Faverial Zh.K. "Historia më e vjetër..." fq 333

Thirrjes së këngëtarit të mirënjohur Arif Vladi, për të ngritur kullën muze të Dom Nikollë Kaçorrit, nënshkruesit të Deklaratës së Pavarësisë dhe zëvendëskryeministrit të qeverisë së Islamil Qemalit, i janë përgjigjur pozitivisht djemtë e Lurës dhe qytetarë shqiptarë brenda e jashtë vendit

"Të ngremë kullën muze të Dom Nikollë Kaçorrit"

Këngëtari i mirënjohur Arif Vladi, aktualisht drejtor i Qendrës Kulturore të Peshkopisë, ka marrë nismën për ngritjen e shtëpisë së Dom Nikollë Kaçorrit.

"Djemtë e mirë të Lurës vendosën të më përkrahin që këtu, në trojet e vjetra, të ngremë kullën muze të Dom Nikollë Kaçorrit", shkruan Vladi në një postim në profilin e tij në Facebook më 24 prill 2022, shoqëruar me foton ilustruese.

"Ka pas dhe ka prap djem Lura", mbyll postimin Arif Vladi.

Thirrjes së tij i janë përgjigjur banorë të Lurës, me banim brenda e jashtë vendit.

Mënyra se si do të bëhet mbledhja e fondeve dhe projekti i ndërtimit nuk janë bërë publikë akoma, por puna ka nisur. Një grup djemsh nga Lura, me banim në Londër, kanë njoftuar një takim në kryeqytetin britanik, ku Arif Vladi do të japë një koncert me qëllim mbledhjen e fondeve.

Disa prej tyre janë angazhuar në krijimin e një unioni të emigrantëve në Londër, i cili do të ketë qëllim kryesor harmonizimin e punës për mbledhjen e fondeve për ndërtimin e muzeut të Dom Nikollë Kaçorrit.



KUSH ISHTE DOM NIKOLLË KAÇORRI?

Dom Nikollë Kaçorri u lind në fshatin Krejë të Lurës më 1862, me të atin katolik dhe të ëmën myslimane. Mësimet e para fetare i mori në shkollën e Troshanit dhe më pas u shkollua në Romë, ku dhe u dorëzua prift. Kur u kthye më 1895, nisi shërbimin fillimisht si meshtar në Delbnisht. Me kryengritjen e Kurbinit, në bashkërendim me Gjin Pjetri u mundësoi kryengritësve 500 armë. Më 1907 emërohet kryetar nderi i klubit "Vllaznia" dhe më 1909 u anëtarsua në klubin "Bashkimi". Më 1908 mori pjesë në Kongresin e Manastirit. Në vitin 1909 mori pjesë në Kongresin Kombëtar të Elbasanit. Pasi iu zunë prova që e përfshinin në një kryengritje, u arrestua dhe u dënua disa vjet burg.

Verën e 1912 qe ndërlidhës i kryengritjes që kishte ndërmarrë Maz'har bej Toptani, i cili lidhi besë me malësorët katolikë të Kurbinit, Kthellës e Mirditës dhe së bashku me disa myslimanë doli në mal. Në tetor së bashku me klerikë të tjerë shkoi në mision në Rubik, Mirditë, Kthellë, etj., me synimin që të bashkonte katolikët me forcat osmane kundër Malit të Zi që kish rrethuar Shkodrën. Ishte Imzot Kaçorri ai që priti delegacionin e mërgatës, që arriti nga Trieste me datë 22 nëntor 1912. Durrësi ishte parashikuar nga atdhetarët si qyteti ku do të bëhej Shpallja e PavarësisëNë nëntor të vitit 1912, si delegat i Durrësit, mori pjesë në kuvendin e Vlorës dhe firmosi dokumentin e pavarësisë me siglën "Kaçorri". U zgjodh nënkryetar i qeverisë së dalur nga Kuvendi i Vlorës.

Pas dështimit të Qeverisë së Ismail Qemalit imzot Nikollë Kaçorri së bashku me Mustafa Krujën, Luigj Gurakuqin, Fahri Gjilanin, Themistokli Gërmenjin themeloi lidhjen "Për atdheun e për Thronin" për shpëtimin e atdheut nga trazirat e ndryshme antikombëtare. Me shpërthimin e kryengritjes së Shqipërisë së mesme, nga kryengritësit iu dogj qela ku banonte si dhe biblioteka e tij personale.

U largua drejt Vjenës, ku me dekret të 28 janarit 1916, Perandori Franc Jozef e dekoroi me Kryqin e Konturës (Kommtur Kreuz) të Urdhërit të Franc Jozefit. Në kryeqytetin austro-hungarez qëndroi tri vjet, ku dhe u ekzaminua e mjekua për sëmundjen e mushkërive. Ndërroi jetë në sanatoriumin Ëürth, më 29 maj 1917. Varrimi i tij u bë më 1 qershor 1917 në Zentralfriedhof, në praninë e autoriteteve më të larta të kohës

Në Janar të vitit 2011, kleriku Dom Izak Doda gjeti varrin e Kaçorrit në kryeqytetin austriak. Muajt pasardhës me interesimin e klerikëve të tjerë dhe pjesëtarëve të komunitetit shqiptar në Vjenë, u bë i mundur riatdhesimi i eshtrave të tij si dhe varrosja në kishën e Shën Luçias, Durrës më 13 shkurt 2011.

URA E LEZEDRES NË RRUGËN E ARBRIT.



- Emërtimin Ura e Lezedres e ka përdorur zyrtarisht për herë të parë Hysen Uka, që i njeh rrugës çdo toponim metër pas metri. Deri më tani njihet si ura e fshatit Fshat. Përroi që kalon poshtë quhet përroi i Lezedres. Vendasit i thonë edhe Gryka e Lezedres.
- Ura e Lezedres dhe Ura e re Vashës në të ardhmen mund të shërbejnë si një vend i mirë për sportet ekstreme: hedhja nga ura me litar, alpinizëm etj. Mbi këto dy ura dhe mjedisin përreth mund të organizohet çdo vit një festival lokal, që do të zgjonte interesin e të pasionuarve pas sporteve ekstreme nga e gjithë bota. Ky festival mund të marrë shumë shpejt një njohje ndërkombëtare.

Kjo është Ura e Lezedres! Këtë emërtim zyrtarisht e ka përdorur për herë të parë Hysen Uka, që i njeh rrugës çdo toponim metër pas metri.

Të gjithë të tjerët, përfshirë edhe mua, e njohim deri më tani si ura e fshatit Fshat. Përroi që kalon poshtë quhet përroi i Lezedres. Vendasit i thonë edhe Gryka e Lezedres ose Gryka e Fshatit. Disa banorë thonë se quhet edhe Gryka e Xhebrit. Adi Darsi, një gazetar nga Klosi, saktëson se "Gryka e Xhebrit është sipër tuneleve në rrugën e Arbrit dhe e merr emërtimin prej fshatit Xibër".

Shpesh, kjo urë ngatërrohet nga kalimtarët e zakonshëm me Urën e re të Vashës, mbi të cilën nuk kalojnë akoma makinat lirshëm për qarkullim. Emërtimi si "ura e fshatit Fshat" nuk tingëllon mirë dhe shpesh ngatërrohet fshati si katund dhe Fshati si toponim.

Ndaj emërtimi më i saktë do të ishte "Ura e Lezedres" dhe i ftoj lexuesit që ta mbajnë mend dhe të përpiqen që ta emërtojnë kështu në ditët e ardhshme. Ndoshta një pllakë që emërton emrin e saktë të saj mund të vihet nga autoritetet në ditët në vazhdim.

Pak mbi urën:

Ura e Lezedres është një nga gjashtë urat e Rrugës së Arbrit, e dyta për nga rëndësia, pas Urës së re të Vashës.

Ura e Lezedres ka një gjatësi 174 metra dhe lartësi 157 metra. Në krahasim me Urën e re të Vashës, ajo është 5 metra më e lartë dhe 142 metra më e shkurtër.

Dy harqet e Urës së Lezedres u bashkuan më 25 nëntor 2021, një vit para se të niste zyrtarisht qarkullimi (28 nëntor 2021). Konstruksionet metalike të saj janë realizuar me elemente çeliku me karbon të saldueshëm.

Gjatë ndërtimit të saj, një vinç u rrëzua, duke i marrë jetën drejtuesit të tij.

Ura e Lezedres dhe Ura e re Vashës në të ardhmen mund të shërbejnë si një vend i mirë për sportet ekstreme: hedhja nga ura me litar, alpinizëm etj. Mbi këto dy ura dhe mjedisin përreth mund të organizohet çdo vit një festival lokal, që do të zgjonte interesin e të pasionuarve pas sporteve ekstreme nga e gjithë bota. Ky festival mund të marrë shumë shpejt një njohje ndërkombëtare.

Teksti dhe foto: **BUJAR KAROSHI**

cyan magenta yelloë black

turizëm/kulturë





ADRIATIK BALLA:
"Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore ka të regjistruar Kullën Hupi, e famshmja dhe unikja kulla e Sul Hupit, si një ndërtesë me vlera arkitektonike dhe historike.
Kjo kullë, që siç shihet është pasqyruar edhe në Filatelinë Shqiptare, si pullë postare që në vitin 1982, dëshmon për vlerat arkitektonike dhe historinë e saj."

Kulla Hupi, *një nga kullat më unike në Shqipëri*

Në Ditën Ndërkombëtare të Monumenteve, zyrtarisht me 18 prill, Adriatik Balla, doktor i shkencave gjeografike, kujtoi në faqen e tij në FB kullat e Bulqizës, përfaqësuar prej Kullës Hupi.

"Në vendlindjen time, vend kullash madhështore e mistike, - shkruan Balla, - Instituti i Monumenteve, sot Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, ka të regjistruar edhe këtë objekt me vlera arkitektonike dhe historike, e famshmja dhe unikja, kulla e Sul Hupit".

"Kjo kullë, që siç shihet është pasqyruar edhe në Filatelinë Shqiptare, si pullë postare që në vitin 1982, dëshmon për vlerat arkitektonike dhe historinë e saj.

Nga të dhënat që kam mbledhur e disponohen edhe zyrtarisht, për herë të parë është restauruar në kohën e Mbretërisë me porosi direkte të mbretit Zog, kurse në sistemin monist është restauruar dy herë."

Balla e vlerëson këtë kullë si një nga më uniket në Shqipëri.

"Vallë, pse gjithë ky interesim? Sepse kjo kullë nuk dëshmon vetëm histori, por ajo është njëherësh një prej ndërtimeve më unike të këtyre ndërtesave në Shqipëri - shkruan Adriatik Balla".

"Traditë, histori, nder e lavdi. E denjë dhe autoritare, e që i bën nder listës së objekteve të trashëgimisë tonë kulturore. Simotrën e saj, në të njëjtin vend e me të njëjtat vlera (shihni fotot), e vizitoi në vitin 2019 kryeministri i vendit, Edi Rama", mbyll postimin doktori i shkencave gjeografike Adriatik Balla.



KULLA HUPI - KULLA QË PRET TURISTË NGA E GJITHË BOTA

Kulla Hupi në Lepurakë, në Bulqizë, është kthyer në një destinacion turistik në Bulqizë. Ata që pëlqejnë turizmin malor gjejnë të Kulla Hupi mikpritjen dhe bujarinë e tyre të madhe.

Lulzim Hupi, pronari i kësaj cope të vogël parajse, ka nisur një biznes që ndeshet me pasiguri dhe vështirësi, por i ka dhënë jetë kullës 200 vjecare.

Jo larg Kullës ndodhet monumente kulture të shpallura në këtë zonë, siç janë Kalaja e Grezhdanit, Kalaja e Lashkizës, Kalaja e Dodës, Gradishta e Bellovës, Qyteti i Skënderbeut, Kisha e Shën Sotirit, Kisha e Shpërfytyrimit, Banesa e Tasho Markos, Xhamia e Allajbegisë, banesa e Zef Doçit e shumë monumente të tjera që e bëjnë Rajonin e Dibrës një zonë atraktive për turistët vendas dhe të huaj.

Kohët e fundit në turizmin malor janë shtuar shumë të pasionuarit e udhëtimit me biçikletave, tepër i përshtatshëm për relievin. Me bukuritë natyrore, pyjet me shtigje për ecje, liqenet e vegjël natyrore, kullat e vjetra plot histori nga e kaluara, ushqimi tradicional me bazë mishi dhe prodhime bujqësore të zonës, rajoni i Dibrës ka shumë për t'i ofruar turistëve përgjatë gjithë vitit. Dhe Kulla Hupi është një ndër referencat kryesore të turizmit në këtë rajon.

BUJTINAT MIKPRITËSE



BUJTINA KONAKU I DIBRËS
Vendndodhja: **Tomin** Tel: **0692053492**
E-mail: **aminasalkurti@gmail.com**



BUJTINA E JUFKAVE
Vendndodhja: **Peshkopi** Tel: **069 937 7337**
E-mail: **agro_zerja@yahoo.com**



GUEST HOUSE SABRIU
Vendndodhja: **Rabdisht** Tel: **069 511 4003**
E-mail: **guesthousesabriu@gmail.com**



KULLA HUPI
Vendndodhja: **Dushaj, Bulqize**
Tel: **068 837 3793**
E-mail: **kullahupi5@gmail.com**



BUJTINA ARBRI
Vendndodhja: **Arras, Fushë-Çidhën**
Tel: **068 650 6061**
E-mail: **markuvladimir@yahoo.com**



GUESTHOUSE TERSHANA
Vendndodhja: **Peshkopi** Tel: **0218 20306**
E-mail: **bujtina.tershana@outlook.com**



BUJTINA GOLECI
Vendndodhja: **Rabdisht** Tel: **069 642 9888**
E-mail: **fitimgoleci1@gmail.com**

cyan magenta yelloë black

Halil Rama, i mirënjohur si gazetar dhe esesist, është prej atyre që e kanë librin një ushqim të përditshëm shpirtëror e mendor.

Për librin e Halil Ramës **"Magjia e fjalës"**

Nga **Preç ZOGAJ**

Një libër me shkrime për disa libra është më pak se secili prej tyre veç e veç dhe më shumë se të gjithë bashkë në kuptimin e informacionit përmbledhës që përcjell. Shkrime të tilla, kur shkruhen bukur, të mësojnë, të japin kanaqësi, të shtyjnë t'ia besosh fatin letërsisë së mirë, domethënë të jesh njeri, siç thotë kritiku franko gjerman Alen Finkielkraut. i cili, me që ra fjala, është një nga mjeshtrit më të mëdhenj të kësaj fushe. Në librin me titull *Një zemër inteligjente"*, përshembull, ai ka përbmledhur nëntë "leximе" për nëntë romane, ku çdo "lexim" të jep çelësin e një thellimi gratis në brendinë, domethënien dhe vlerat e veprës. Mund të sillen plot shembuj të tjerë kësisoj.

"Magjia e fjalës", botim i Shtëpisë Botuese Universitare "UET Press" bën pjesë në këtë familje. Autori Halil Rama, i mirënjohur si gazetar dhe esesist, është prej atyre që e kanë librin një ushqim të përditshëm shpirtëror e mendor; një lexues i paepur, siç do thoshte Borhes, i cili, duke folur për veten e tij, e çmonte të qenit lexues si një meritë më të madhe se të qënit krijues**.**

Të lexuarit për Halilin nuk mbetet në kuadrin e nevojave dhe kënaqësive individuale. Duke hedhur në letër e botuar rregullisht vështrimet e tij për librat që pëlqen, ai vihet në rolin e ndërmjetësit special mes Librit dhe lexuesve. Merr kështu rolin e një shërbyesi publik, që ndërsa nuk ekziston në nomenklaturën zyrtare të fuksioneve, i përgjigjet një kredoje më të lartë që përcakton vendin e intelektulit në shoqëri.

Leximet e shumëllojshme - në prozë, poezi, monografi, historiografi, diplomaci, gjeopolitikë, folklor, etnokulturorë e tjerë - dëshmojnë spektrin e gjerë të kërshërisë, interesave, shijeve dhe kërkesave kulturore dhe intelektuale të autorit.

Te "*Magjia e fjalës*" lexuesi do të gjejë dyzetëenjë shkrime. Shumica janë reçenca për libra artistikë apo monografikë. Pjesa tjetër janë kryesisht profile letrare dhe paraqitje botimesh nga etnokultura. Reçensave u prin nga radha dhe cilësia ajo për monografinë *"Kur mbretëron karakteri - Ronald Regan"* të autores Peggy Noonan, për të vijuar me ato për për vëllimin me tregime "*Thikat pa gjak*" të Zija Çelës, romanet "*Dëmtuar gjatë rrugës" të Besnik Mustafajt*, "*Një shaka e vogël me vdekjen"* të Bashkim Hoxhës, "*Saga përtej Atlantikut"* të Shefqet Mekos, *"Änja"* të Ahmet Prençit, "*Martesa e dytë"* e Flamur Buçpapaj, e tjerë.

Te "Magjia e fjalës" lexuesi do të gjejë dyzetëenjë shkrime. Shumica janë reçenca për libra artistikë apo monografikë. Pjesa tjetër janë kryesisht profile letrare dhe paraqitje botimesh nga etnokultura.

Leximet e shumëllojshme - në prozë, poezi, monografi, historiografi, diplomaci, gjeopolitikë, folklor, etnokulturorë e tjerë - dëshmojnë spektrin e gjerë të kërshërisë, interesave, shijeve dhe kërkesave kulturore dhe intelektuale të autorit.



Galeria e profileve letrare vjen si një lloj Wikipedia me informacione pothuajse shterruese për jetën dhe veprën e shkrimtarëve Teodor Laço e Shefki Karadaku, të shkrimtarit e studiuesit, Hajri Mandri, të artistit të mirënjohur dibran, Hazis Ndreu dhe bardit Naim Plaku.

Një kategori tjetër shkrimesh kanë në fokus libra monografikë dhe studimorë për historinë dhe etnokulturën e arealit dibran e më gjerë. Ato kthejnë vëmendjen e meritуar nga një kategori hulumtuesish të përkushtuar, siç janë Fatmir Terziu me "*Toponimia e Gollobordës: Diskursi i dygjuhësisë dhe derivati i origjinës*", Besnik Këbej me "*Origjina dibrane e Skënderbeut*", Naim Berisha me "*Berishët e Muhurrit*", Faik Bruçi me "*Fisi Bruçi i Lukanit të Dibrës*", Haki Përnezha dhe Ruzhdi Bitri me "*Toponimia e Çidhnës*", e tjerë.

Në tërësi, autori ka ndaj librave që merr në shqyrtim një qasje përbashkuese që do ta quaja "protoniste". Ky është një term i përdorur nga shkrimtari dhe doktori i shkencave humane, Gjekë Marinaj. Termi në fjalë, siç kuptohet lehtë, është një metaforë që rrjedh nga fizika me referencë atomin: kritiku protonist kujdeset për protonin e qëndrueshëm me peshë dhe pozitiv. Thënë ndryshe fokusohet te ana e mirë e veprës. Protonizimi është zhvilluar nga Marinaj dhe është pranuar si teori letrare filimisht nga Universiteti i Dallasit në SHBA dhe pastaj më gjerë. Teoria sugjeron që një kritik protonist, kur përballet me një tekst, duhet të kërkojë sëpari atë që ka vlerë estetike, intelektuale dhe morale në vepër. Kritiku që gjen pak vlerë në një vepër, thjesht duhet ta lerë mënjanë dhe të përmbahet tërësisht nga diskutimi i tij, duke e lënë atë në errësirë në vend që të bëjë një shfaqje të retorikës përçmuese.

Halil Rama mund ta ketë lexuar por mund edhe të mos ketë dëgjuar për teorinë protoniste. Atë e çon te praktikimi i saj pozitivizmi i tij si njeri dhe si intelektual, dhuntia e tij për të parë të bukurën dhe të mirën në veprat për të cilat shkruan, për t'i dashur e promovuar më gjithë shpirt ato.

Kjo dhunti e karakterit do të ishte krejt e pamjaftueshme pa një set cilësish të tjera, ku spikat profesionalizmi, njohja e termave dhe nocioneve bazë të kritikës letrare, aftësia për të përkufizuar me fjalë të kursyera subjektin e veprës, ndërtimi i një parashtrese jo skematike mbi tekstin që përcjell e analizon, duke ndërthurur referimet nga të tjerët me pohimet e veta autentike.

Romani "*Dëmtuar gjatë rrugës*" i Besnik Mustafajt është për Halil Ramën zbërthimi i "*lëmshit torturues të lotëve që ia kishin zënë lëfytin e hollë të grykës një nëne*". Në fakt unë nuk kisha lexuar për këtë vepër një frazë kaq lakonike që në pikpamjen strukturore shëmbëllen kolonën vertebrale të subjektit dhe e paralajmëron lexuesin në formën e joshjes se do të lexojë "anantominë" e një lëmshi lotësh.

Reçensa për ish - Presidentin Ronald Regan vjen si një koleksion sentencash që japin saktë identikitin e një personazhi të jashtëzakonshëm, që erdhi në skenën e madhe nga "*ëndrra amerikane e lirisë dhe mundësive të pashterrshme*". Reçensuesi fokosuhet jo pa qëllim te prejardhja e Reganit nga një familje e thjeshtë amerikane. Ai kërkon të nënvizojë faktin se konservatorizmi politik nuk derivon vetëm nga pasuria apo dinastitë, por vjen gjithashtu nga një traditë e ngulitur vlerash të familjes, besimit, lidhjes me vendin apo oikos-in.

Përmeda këtu vetëm dy shëmbuj që ilustrojnë pohimin se aftesia për të shkuar në thelbin e veprave që merr për të analizuar është një karakteristikë e shkrimeve të Halil Ramës.

Thuhet me të drejtë se është shija që përzgjedh çfarë të lexojë e promovojë dhe janë citimet ato që pasqyrojnë shijet**. "***Po zemra e kërkon nudon e bukur, / e të jetë ajo si mbretëreshë, /që nëpër gjoksin e saj malli i shkurtër /si tajfun Floride të përqeshë...*"**.** Këto vargje të Shefki Karadakut janë cituar nga Rama në shkrimin për profilin letrar të një shkrimtari dhe poeti që ndoshta nuk i ka marrë vlerësimet e merituara. Janë vargje shumë të bukura që e shtyjnë lexuesin drejt krijimtarisë së autorit.

"*Magjia e fjalës*", përveçse një adresar titujsh për t'u lexuar dhe një koleksion citimesh që në lidhjen e tyre krijojnë një buqetë perlash për njohjen dhe kujtesën, është një shërbesë e madhe letrare dhe intelektuale në këto kohë të vështira për artin dhe kulturën. Nëse do të përfytyronim një "Urdhër" për mbrojtjen dhe promovimin e kulturës si pasuri e shoqërisë dhe njerëzimit, Halil Rama është aty në shërbim të librit në gjuhën shqipe.

Autorët Bujar Muça dhe Burbuqe Agolli sjellin monografinë "Gjurmë në kohë", kushtuar poetit ILMI DERVISHI me rastin e ditëlindjes.



ILMI DERVISHI, letrari modest

Nga **RAMADAN TOPUZI**

I kudondodhur, në takime letrare, ceremoni, organizime kulturore; Ilmi Dervishi bie në sy me thjeshtësinë e tij. Me sjelljen e tij dashamirëse plot respekt për të gjithë, duke prezantuar të gjithë të njohurit e tij të tjerëve, me dashuri të madhe, pa intriga, pa ego, por me dëshirën e mirë të njohjes, të promovimit të vlerave. Dashuria për librin e ka ushqyer që në rini, kur nisi me shkrime të ndryshme; kronika e artikuj problemorë. Më pas ka vijuar me poezinë, me të cilën fle e zgjohet, me rrethet letrare, me poetë nga të gjitha trojet ku flitet shqip. Për këtë flasin dhjetëra botime me poezi të tij, plot shpirt e muzë. Promotor i lëvizjes së organizimeve poetike, plot ide e pasion me të vetmin qëllim - poezinë.

Prej vitesh ia ka dalë të organizojë rreth vetes me qindra poetë: me origjina, besime, profesione e kultura ndryshe por që i bashkon poezia. Kjo duhet të ketë qenë edhe motoja e "Na bashkoi poezia" edhe pse nuk e kam pyetur ndonjëherë, por kjo ndjehet, kuptohet. Antologjia e njohur me të cilën ia doli t'i grupojë e sistemojë në dhjetëra vëllime poetike, ashtu thjeshtë, pa bujë, pa përtesë e me plot shpirt artistik, diversitetet poetike.

Vijon të krijojë: pafundësisht, poezi; nga ato më të ndjeshmet, për jetën, padrejtësitë e saj, brengat, për fatin e poetit e ndoshta ato për të cilat shquhet janë ato romantiket, ku derdh shpirtin e tij rinor, të çiltër, të guximshëm, rrezatues.

Nuk dua të zgjatem, vetëm desha t'i them dhe unë dy fjalë për poetin rinor, për letrarin me sjellje modeste - Ilmi Dervishi. Diku jam shprehur: "shkrimtari njeri" për shkrimtarin Zija Çela; Ilmiu është pikërisht njeriu poet.

I uroj jetë të gjatë sa Korabi e vëllime të pafundme si uji i Drinit, me këtë freski e shpirt rinor që ka!

libër i ri

Me librin "Krojet e këtyre viseve thonë", vjen për lexuesin si model i poetit të epikës dhe lirikës dibrane

Kur **Hysni Bruçi** botonte në "Zëri i Rinisë" para 49 vitesh poemën **"Është ligji ynë"**

***Nga* Halil RAMA**

Libri "*Krojet e këtyre viseve thonë*", me tetë cikle me poezi, i poetit Hysni Bruçi, është një prurje krejtësisht e veçantë dhe mjaft cilësore në botimet me poezi të tri dekadave të fundit. Si njohës i thellë i historisë, kulturës dhe traditës dibrane, vlerat madhore të tyre i reflekton në poezinë e tij, të shkruar jo në një ditë, një vit apo një dekadë, por që në rininë e tij të herëshme të viteve '60-'70-të të shekullit të kaluar.

Vetë titulli i librit "*Krojet e këtyre viseve thonë*" botim i "M&B" është intrigues dhe të josh për ta lexuar. Po ashtu edhe titujt e cikleve: "*Si sylynjare*", "*Fshati rrëzë malit me pisha*", "*Ankohen varret*", "*Lisnaja përcjell mesazhe*", "*Lulezojat e lirishtave të Runjës*", "*Nëpër tërmete*", "*Vite lufte*" e "*Dhe thonë rapsoditë*". Një lëndë aq e pasur dhe e larmishme si dhe vetë poezia e këtij liriku, që pas akumulimit të tij në pesë dekada sjell për lexuesin poezi që u shkrumbëzuan dhe u hirnosën, ndoshta të kyçura në sirtaret e tavolinave të tij të punës si mësues, redaktor letrar në "Ushtima e Maleve" e inspektor i kulturës në ish-Komitetin Ekzekutiv të Dibrës...apo në sepetet e shtëpive të tij në Lukan, Muhurr e Peshkopi, dhe që dalin në dritë me një shkëlqim të rrallë.

Mjaftojnë qoftë dhe pak vargje nga poezia me titull "*Bora e gjakut*": "*Ra bora e gjakut/ Dhe vatrën e prindërve/ E rralloi,/ Blerimin e vëllazërisë/ E përcolli/ E mpiksi/ Gjakun e probatinëve/ Duarshtërngimin/ E ngriu dhe krisi...*" për të konkluduar se si drithëron pena e këtij poeti, teksa percepton dhe fshikullon zakonin shfarosës.

Po ashtu tek cikli "*Fshati rrëzë malit me pisha*", dallojmë poezinë lirike, si pjesë e rëndësishme e komunikimit dhe shprehje e botës së brendshme të autorit drejt lexuesit. Më e dukshme kjo tek poezia "*Ngjyra, rreze, zëra*": "*Në livadhe kanë dalë luledelet/ Ka filluar cijatja në zabele/ Në shtrunga sa s'derdhet kulloshtra/ Gjallojnë vathët prej shqerrave.../….Në dyqan të fshatit/ mbesën e vogël çova/ Fletorkë të re të më blejë/ Për vjersha...*".

Në tërësinë e këtij libri me 86 vjersha e dy poema, Hysni Bruçi shfaqet si njohës perfekt i poezisë dhe veprave letrare në tërësi të Fishtës, Mjedës, Koliqit, Migjenit, Kutelit, Spasses, Kokonës, Dritëroit, Moikom Zeqos, Preç Zogajt, Shefki Karadakut, e tjerë, teksa na jep në këtë libër nuanca të dallueshme kulturore, në përputhje harmonike me zellin e tij studjues e krijues, me frymëzim nga "lulezojet e lirishtave të Runjës" apo dhe nga rapsoditë, që evokojnë dhe përcjellin ndër brza qëndresën e dibranëve në luftrat shekullore për liri e pavarësi kombëtare.

E pra, ndonëse shumë poezi i shkroi në vitet e sistemit të kaluar, Hysni Bruçi ka ditur t'i shmanget ndikimit të realizmit socialist, duke krijuar poezi me lëng e klorofilë, plot dritë e perspektivë në horizont.

Le të ndalemi për ta konkretizuar këtë tek poezia "*ATDHE*" e ciklit "*Lisnaja përcjell mesazhe*":

"*Ushqyer këtë fjalë fëmijës/ Me ninullat e qumështin e gjirit;/Është zemra tek fjala Atdheu/ Fluturimi i dallëndyshes/ E foleja e skifterit..../ Është shamia e zezë e nënës/ E rrukullima e lotit të jetimit,/ Është çfarë ka sofra/ E të zotit të konakut,/ Është edhe/ Pena e Dritëroit/ E huta e Dedë Gjo Lulit...*".

Nga tërësia e lëndës voluminoze, por edhe mjaftë cilësore e këtij libri, mund të konkludojmë pa asnjë mëdyshje se Hysni Bruçi është model i poetit kombëtar, ndaj



Libri "Krojet e këtyre viseve thonë", me tetë cikle me poezi, i poetit Hysni Bruçi, është një prurje krejtësisht e veçantë dhe mjaft cilësore në botimet me poezi të tri dekadave të fundit.

duhet marrë si shembull që duhet ndjekur nga të rinjtë. Poezia e tij është e mbështetur në tabanin kombëtar dhe qëndron larg të ashtuquajturave skema të realizmit socialist.

Me këtë libër ai vjen si një xhevahir i ri, i rrallë, në gjerdanin e poezisë shqipe, të krijuar nga mijëra poetë shqiptarë ndër vite e shekuj.

PO KUSH ËSHTË HYSNI BRUÇI
(për ata që nuk e njohin nga afër) ?

Në vitet '60-'70-të të shekullit të kaluar, në faqet e gazetave e revistave, të përditshme, javore e të përmuajshme periodike që botoheshin në Tiranë, do të tërhiqte vëmendjen firma e mësuesit Hysni Bruçi nga Muhurri i Dibrës. Publicistika e tij po zinte vend të rëndësishëm në gazetat "Zëri i Popullit", "Mësuesi", "Bashkimi" etj. Po ashtu në rubrikat letrare-artistike të gazetave "Drita", "Zëri i Rinisë" e "Puna" si dhe të revistave "Nëntori" e "Ylli" ai do të shfaqej, jo vetëm me reportazhe e skica letrare, por edhe me vjersha e poema.

Mësuesi i lëndëve gjuhë shqipe – historia në shkollën 8-vjeçare "Nexhat Agolli" Muhurr, në vitet 1960-1961, që kishte shërbyer edhe në shkollat e zonave Luzni e Kastriot si dhe me klasë kolektive në Rreth-Kale e Shqath (që kishte mbaruar me rezultate të shkëlqyera Shkollën e Mesme Pedagogjike "Ndrec Ndue Gjoka" në Tiranë e më pas edhe Shkollën e Lartë dy vjeçare pa shkëputje nga puna), do të shpërthente si një talent i rrallë në krijimtarinë poetike të asaj kohe. Kështu që në maj 1969 H.Bruçi do të botonte në "*Zëri i Rinisë*" poemën "*Është ligji ynë*" (*Vite lufte*), *kur lexuesve të atyre viteve do t'u mbeteshin në mendje vargjet e asaj poeme*: "*Njerëz fytyrëmvrejtur/Kasolle perdhecke/ Rrugica të ngushta ku sundon uria.../Nën këto çatira të kalbura prej kohës/ Nën këto trarë të nxirë prej blozës/ Flen urrejtje e madhe.../Këtë urrejtje të grumbulluar prej vitesh/ Kush mund ta zbonte/ Veç ëndërrës për liri?/ Kështu u bë flamur/ Luftëtari i parë i lagjes sonë/ Dhe për liri/ Grykën e pushkës quante diplomaci....*"

Ndërkohë, qe nga të parët që u angazhua me Lëvizjen Amatore në fshat. Ai kishte lindur në Lukan, por u rrit e u mirëformua në Muhurr, që ishte vendlindja e nënës së tij. Këtu mori arsimin fillestar dhe po nga Muhurri nisi rrugëtimin e tij të gjatë në fushën e mësuesisë, letërsisë, artit e kulturës. Pasi kishte spikatur për talentin e tij si poet me vjershat e poemat e botuara në shtypin qëndror, Hysni Bruçi mori pjesë edhe në përgaditjen e Almanakëve të parë letrarë "Dibra".

Që me fillimin e botimit të gazetës lokale "Ushtima e Maleve" nisi të punojë aty, një vit si korrektor letrar e pastaj për disa vite si redaktor për kulturën e punën me talentet e reja letrare. Në gjysmën e dytë të viteve ''70-të, në Dibër po bëhej një hop përpara për gjallërimin e jetës artistike dhe kulturore dhe gazeta "Ushtima e Maleve", sektorin e kulturës të së cilës e drejtonte Hysni Bruçi pati ndikim të dukshëm në nxitjen e promovimin e talenteve të reja. Madje, që këtu u evidentuan dhe u tërhoqën në institucione njerëz të pasionuar e të përkushtuar.

Në mars të vitit 1978 fillon punën në sektorin e kulturës të Komitetit Ekzekutiv, ku dha një kontribut të çmuar për organizimin dhe masivizimin e artit e kulturës në rrethin e Dibrës. Ishte koha kur u arrit që Estrada e Peshkopisë të klasifikohej "profesioniste" dhe të krahasohej me të Korçës, Sarandës dhe të Fierit. Ajo arriti të realizonte katër premiera në vit dhe të përfaqësohej denjësisht edhe në eventet kombëtare. Pasurimi i orkestrës së saj me instrumentistë të shkolluar të oboes, flautit, trombës, violinçelit etj, është padyshim edhe meritë e Hysni Bruçit që drejtonte sektorin e kulturës në Komitetin Ekzekutiv të rrethit. Ai inkurajoi dhe mbështeti muzikantë të talentuar që të krijonin e drejtonin grupe të ndryshme artistike. Në Lëvizjen Artistike u përfshinë këngëtarë që bënë emër brenda e jashtë vendit. U rrit profesionalizmi në trupën e aktorëve e të regjive të shfaqjeve; u rrit niveli artistik edhe me skenografinë e shfaqjeve. Gjatë kohës që Hysni Bruçi drejtonte Sektorin e Kulturës në Komitetin Ekzekutiv të rrethit u krijua edhe Trupa e Teatrit Dramatik Amator që realizonte dy deri në tri premiera në vit. Vatër e argëtimit të fëmijëve u bë Teatri i Kukullave. Orkestra Frymore e qytetit të Peshkopisë arriti të marrë çmimin e dytë në takimin kombëtar të Korçës. Shtëpia e Pionierit po bëhej shkollë për përgatitjen e talenteve të reja. Dega e Librit, me çeljen e 16 librarive në fshat e në qytetet Peshkopi e Bulqizë përmirësoi dukshëm punën me librin. U krijua edhe Dega e Monumenteve të Kulturës. U ngrit edhe Ansambli Artistik "DIBRA" (që fatmirësisht e ruan edhe sot këtë emër), i cili arriti të japë shfaqje të suksesshme edhe jashtë vendit, si në Turqi, Prishtinë, Shkup etj. Hysni Bruçi pati rol parësor edhe në formimin e Shoqatës së Historianëve si dhe të Bërthamës Arkeologjike të rrethit të Dibrës. Puna studimore solli edhe riorganizimin e Muzeut Historik dhe ngritjen për herë të parë të Muzeut Etnografik të rrethit. Sipas një programi të posaçëm pune të Sektorit të Kulturës në Komitetin Ekzekutiv që drejtohej nga Hysni Bruçi, u ngritën MuzeTematikë në Dovalan, Sinjë, Okshtun, Bulqizë, Ostren, Lurë, Zerqan, Zogje e Kastriot. Po bëhej praktikë pune që çdo vit të organizoheshin sesione shkencore në zona.

Në tetor 1978, u zhvillua Konferenca e Parë Shkencore e rrethit për çështje të historisë e kulturës të Dibrës. Për herë të parë aty u paraqit projekt-ideja për Rrugën e Arbërit, që po bëhet realitet në vitet e demokracisë, falë edhe rolit determinant të gazetës me të njejtin emër "Rruga e Arbërit" dhe Lidhjes së Intelektualëve Dibranë.

Në ato vite, Rrethi Letrar i Dibrës fitoi statusin e Degës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të rrethit. Dhjetëra krijues dibranë që tanimë kanë botuar edhe librat e parë me poezi e tregime, debutimin e parë e patën në gazetën lokale "Ushtima e Maleve", në kohën kur sektorin e artit, kulturës e letërsisë e drejtonte redaktori i talentuar Hysni Bruçi.

Për piktorët e skulptorët u dhanë 9 studio. Sektori i Artit Figurativ arriti që çdo vit të çelë ekspozitë. Punët e disa piktorëve dibranë zinin vend në ekspozitat vjetore kombëtare. Masivizimi solli që disa qendra pune e shkollat të ngrenë grupet artistike.

Të 26 shtëpitë e kulturës në zona arritën të ngrenë grupet foklorike me 50-60 pjesëmarrës. Në orkestrat e tyre hynë edhe instrumente të rrallë muzikorë si: gajdja e Klenjës, kavalli i Kastriotit, fyjet e Selishtës, lauria e Murrës, culet e Venishtit e Palamanit, sharkia e Çidhnës, pipzat e Lurës etj. Hysni Bruçi tregon se orkestra e grupit folklorik të Çidhnës kishte rreth 30 instrumentistë.

Po ashtu ai vlerëson krijimin dhe interpretimin e valleve si: vallja e brezave, vallet lirike të Grykës së Vogël e të Kalasë së Dodës, vallja e Xhafer Kabës, vallet dyshe të burrave të Zall Dardhës, Muhurrit e Maqellarës, vallja këmbë mbas këmbe e Katër Grykëve, Vallja "Hore" e Sllovës, vallja humoristike e Pollazhanit, etj.

Shpërthyen këngë brilante si: "Na knojnë pushkët nëpër kulla", "Shtatë liqejt e Lurës", "300 duvakët", "Këngë për Mahmut Dacin", këngët epike për Kosovën ("O prite Azem Galicën", "Këngë për Jakup Ferrin") etj. Emra këngëtarësh të tjerë dibranë u bënë të njohur e të dashur për artdashësit brenda dhe jashtë vendit Vlerësimi i mëtejshëm i punës me folklorin, për të cilin H.Bruçi tregoi përkushtim të rrallë, bëri që Dibra të marrë vendin e parë në Festivalin Folklorik kombëtar të vitit 1978.

Hysni Bruçi ka realizuar edhe kumtesa e studime për çështje të historisë e kulturës së kësaj treve. Ato janë referuar në Sesione Shkencore e disa janë botuar në revista e organe shtypi. Të tilla kanë qenë: "Tema e Qëndresës në krijimtarinë e popullit", botuar në "Dibra e dibranët", "Vlera pedagogjike në Abetaren e Kolë Gjumarit", botuar në gazetën "Mësuesi", "Disa të dhëna historike për lidhjet e Dibrës me Qeverinë e Vlorës të 1912-tës", mbajtur në Konferencën Shkencore të Kulturës të rrethit (1978); "Mbi disa shkaqe e koncepte të mënyrës së jetesës" si dhe "Shkaqe e pasoja të thashethemeve", botuar në "Zëri i Popullit". Gjithashtu Hysni Bruçi ka realizuar trajtesa me vlerë, si: "Ornamenistika në kostumet e shtatë zonave etnografike të Dibrës", "Instrumentistë në kohë që bënë emër dhe Orkestra Folklorike e Dibrës", "Figura mëmëdhetare të Dibrës dhe çështje të simboleve përkujtimore", "Zall Dardha – një nga djepet e folklorit të Dibrës", "Rapsodia Dibrane dhe profile rapsodësh" etj. Do të mjaftonte qoftë dhe botimi në një libër i këtyre kumtesave, studimeve e trajtesave, të realizuara, të mbajtura në sesione shkencore e të botuara me firmën e Hysni Bruçit, për të kuptuar kontributin e tij të veçantë për zhvillimin e letërsisë, artit e kulturës në Dibër.

Rruga e Arbërit nr. 188

tregim



Mirëkuptimi për guximin klinik të justifikuar

Tregim nga Ahmet Kamberi

Doktor Agimin e shqetësonte shumë mjekimi i të sëmurëve me prishje kronike të punimit të zemrës – një gjendje e rëndë paaftësuese që vjen kryesisht për shkak të dëmtimit të muskulit të zemrës nga shkaqe të ndryshme. Të sëmurët shtroheshin në spital, mjekoheshin me injeksione brendavenore të një bari që quhej strofantinë dhe ujëzbrazës me bazë zhive. Ato bëheshin mirë por ktheheshin përsëri në spital, kush pas dy, kush pas tri a katër javësh e kush hiç..., pasi mjekimi me injeksione ditëpërditë, nuk ishte aspak praktik. Kishte barna të tjera, me prejardhje nga bima e digitalit, të cilat i prodhonte Profarma në Tiranë, si digitalina dhe lanatozidi C, të cilat mund të përdoreshin për mjekim kronik. Por ato kishin një të metë të rëndësishme. Në gjendjet e rënda kur mëlçia ishte e mbushur me ujë, ato nuk mund të përdoreshin, sepse nuk përthitheshin mirë në zorrë. Përdorimi me pluhura ose pika e bënte të vështirë dozimin e tyre, dhe shpesh, të sëmurët pësonin helmime. Nga fundi i viteve 1960, Depoja e barnave në Tiranë, kishte filluar të importonte një preparat shumë të pastër të digitalit: Digitoksinën. Kjo përthithej shumë mirë në zorrë edhe kur prishja e punimit të zemrës ishte shumë e rëndë e me enjtje të skajshme të mëlçisë. Në Spitalin klinik të Tiranës, ku doktor Agimi bënte specializimin për sëmundje të brendshme, digitoksina - nga frika e helmimit prej saj- përdorej rrallë dhe me doza të vogla e të papërshtatshme, për analogji të përvojës negative me preparatet e vjetra. Doktor Agimi kishte kohë që punonte me literaturë mjekësore amerikane dhe angleze. Që në vitin 1962 ai ishte i abonuar në revistën e Shoqatës Mjekësore Britanike: Revista Mjekësore Britanike (*British Medical Journal)* dhe kishte në bibliotekën e tij librat bazë më të mira bashkëkohore amerikane të mjekësisë së brendshme. Ato ai i porosiste nëpërmjet librarisë së qytetit në Peshkopi, e cila ia përcillte Ndërmarrjes së librit ndërkombëtar në Tiranë. Gjatë kohës së specializimit në Tiranë, ai shfrytzonte revistat amerikane mjekësore me emër si Revista Mjekësore e Anglisë së Re (*New England Journal of Medicine*) dhe Revista Mjekësore e Shoqatës Amerikane të Mjekësisë (*JAMA*), që gjindeshin në bibliotekën e spitalit. Këto, i kishin mundësuar atij të kuptonte se mjekimi i të sëmurëve me prishje kronike të punimit të zemrës, mund të përmirësohej shumë përmes digitalizimit të shpejtë (ngopjes së shpejtë të trupit me barna që nxirren nga bima e digitalit). Para se të kthehej përsëri në Peshkopi, në shtator të vitit 1969, ai vajti në Depon e barnave dhe porositi një sasi të mirë digitoksine për spitalin e atjeshëm.

Me t'u kthyer në Peshkopi, puna e parë që bëri, ishte instruktimi i infermiereve për mënyrën e digitalizimit të shpejtë. Mënyrën sesi ato duhet të vrojtonin të sëmurin para se t'i jepnin atij dozën e radhës, dhe se çfarë duhej të bënin nëse vinin re shenja të dyshimta. Digitalizimi i shpejtë dukej i frikshëm, pasi i sëmuri duhej të mirrte ditën e parë gjithë sasinë e tabletave të digitoksinës që duhej për të ngopur organizmin. Me metodat e vjetra të mjekimit duheshin dy javë për arritur digitalizimin e plotë (ngopjen me digital). Me metodën e re, pas 24 orësh kalohej menjëherë në dozën mbajtëse, e cila duhej individualizuar për secilin të sëmurë, por që gjithsesi ishte një doze shumë e vogël. Doktor Agimi e kishte menduar thellë përdorimin e kësaj metode, e cila do t'i ndihmonte të sëmurët në kapërcimin e shpejtë të vuajtjes së tyre, shkurtimin e qëndrimit në spital, përmirësimin e cilësisë së jetesës e ruajtjen për kohë të gjatë të saj, si edhe shmangien e shtrimeve të shpeshta, të përsëritura në spital. Ai besonte se zbatimi i një metode mjekimi që përdorej gjerësisht në Amerikë dhe Kanada, nuk do të thoshte medoemos se ajo po vihej në përdorim për herë të parë. Kjo e ndihmoi atë të mos trembej. Megjithatë, kjo nuk mund të merrej me aq lehtësi. I sëmuri me sëmundje të rëndë të zemrës, është gjithnjë pranë rrezikut për jetën. Mjekimi mund të mos jetë kurdoherë i suksesshëm. Por, kur përdoret një metodë e re mjekimi, dhe i sëmuri mund të vdesë, dyshimi i parë që ngrihet e lidh atë me mjekimin e ri të përdorur. Në kohën e socializmit, një dyshim i tillë donte të thoshte shumë. Megjithatë, doktor Agimi e kishte mbledhur mendjen tashmë. Në mendësinë e tij, përparim në mjekësi do të thoshte të shpëtoje sa më shumë jetë njerëzish, të lehtësoje vuajtjet e të sëmurëve, t'u riktheje atyre aftësitë e humbura deri në maksimumin e mundshëm, si edhe t'u zgjasje jetën me një cilësi të mirë. Kjo e bënte atë të mendonte se guximi klinik i justifikuar ishte i nevojshëm. Nga ana tjetër ai besonte se edhe urdhëri më dobiprurës e i shqiptuar qartë mund të jetë i padobishëm, e madje i rrezikshëm kur zbatohet nga njerëz të pastërvitur, të painstruktuar, ose të painstruktuar si duhet. Prandaj ai e kishte bërë zakon që kur kishte filluar punën në atë pavijon që një orë në javë, t'ia kushtonte edukimit profesional të pandërprerë të infermiereve të tij, me një program tematik të përcaktuar. Kishte vënë gjithashtu, kryeinfermierin ta bënte këtë gjë edhe me sanitaret e pavionit. Kjo kishte dhënë rezultate të shkëlqyera dhe i kishte mundësuar atij që vetëm në katër orë, të përballonte për shumë vite drejtimin e mjekimit të pesëdhjetë e pesë të sëmurëve që kishte pavioni i tij, pasi katër orët tjera të orarit zyrtar duhej ti kalonte në poliklinikën e qytetit.

Kështu, kur ai u bind se e kishte përgatitur mjaftueshëm personelin e tij edhe për problemet që lidheshin me digitalizimin e shpejtë, nisi ta zbatojë atë në rastin më të parë që iu paraqit. Mori zemër nga rezultati pozitiv befasues dhe pastaj vazhdoi pa u ndalur. Ndjekja e vëmendshme e të sëmurëve dhe kujdesi i veçantë i infermiereve, i mundësoi atij të shmangte çdo ndërlikim të parandalueshëm. Brenda një muaji, pa bujë, kjo punë ishte kthyer në rutinë.

Mirëpo, një ditë aty nga fundi i nëntorit, shtrohet në pavijon një e sëmurë nga Sopoti me një prishje të rendë të punimit të zemrës, e enjtur kokë e këmbë nga mbushja me ujë dhe e pazonja të lëvizte. Në mënyrë të natyrshme, ajo iu nënshtrua mjekimit të ri.

Por doktor Agimi kishte bërë gabimin e zakonshëm të kërkuesve dhe zbatuesve të heshtur, të cilët përqendrohen pa zhurmë në punën e tyre, me besim të plotë në dijet e veta të përftuara nga studimi intensiv dhe të vetëdijshëm për atë që bëjnë, por pa u kujdesur të parambrohej nga mjedisi i kolegëve të painformuar. Kështu, të nesërmen e shtrimit të kësaj zonje, doktor Agimi do të përballej me një situatë vërtetë të vështirë. Në mbledhjen e mëngjesit, mjeku i rojës, specialist radiolog dhe që pati drejtuar repartin e patologjisë para se t'ia dorëzonte atë doktor Agimit, para se të fillonte raportimin për shërbimin e tij, iu drejtua drejtorit me ton kritik:

-Shoku drejtor, ky është i çmendur, - duke rrëfyer me gisht doktor Agimin.

-E, pse? – ia ktheu i habitur drejtori.

-I ka dhënë një gruaje të sëmurë me prishje të rëndë të punimit të zemrës, me enjtje të krejt trupit, 18 tableta digitoksinë.

-Po ti, e pyete Agimin pse e kishte bërë këtë?

-Jo. Kur e pashë unë në mbrëmje, Agimi sapo kishte ikur dhe e sëmura e kishte përfunduar marrjen e të gjitha tabletave. Por ishte shumë rëndë. Nuk ishte në gjendje të bisedohej me të. Ajo do të jetë helmuar keqas.

-Po më pas e pe të sëmurën?

-Jo. Infermierja nuk më thirri gjatë natës. Sot në mëngjes nuk kalova nga pavijoni, se m'u desh të merresha me një urgjencë.

-Po ti, doktor Agimi, ç'dreqin ke bërë kështu, – shpërtheu i zemëruar drejtori - si mund t'i japësh një të sëmure të tillë kaq shumë tableta digitali!

-Shoku drejtor, kjo është mënyra e zakonshme e mjekimit të këtyre të sëmurëve, - i habitur nga mënyra se si e paraqiti rastin kolegu i tij më i vjetër në profesion.

-Si more, na qenka "mënyrë e zakonshme mjekimi", kur as kemi parë e as kemi lexuar për një gjë të tillë, - ia ktheu drejtori – me një ton më të lartë.

-Kështu mjekohen të sëmurët me këtë lloj prishjeje të punimit të zemrës në Amerikë, shoku drejtor, -u përgjigj me qetësi doktor Agimi.

-Lëre mor Amerikën, ç'punë kemi ne se ç'bën Amerika. Por, po e pat gjetur gjë të sëmurën, ti e din se ç'përgjegjësi mban, apo jo?

-E di shoku drejtor, si nuk e di, po kjo është mënyra më e mirë e mjekimit sot për prishjen e rëndë të punimit të zemrës. Nuk jam unë që e kam shpikur atë. Pastaj, kjo nuk është hera e parë që unë po e përdor atë. Të sëmurët e tjerë te të cilët e kam përdorur kanë pasur përmirësim të jashtëzakonshëm dhe kanë shkuar shumë mirë. Ata kanë dalë nga spitali brenda 10 ditësh, kur ne i kemi mbajtur më parë një deri dy muaj në spital.

Ndërkohë ai po mendonte vetëmevete, po sikur t'i ketë ndodhur gjë me të vërtetë të sëmurës? Se një përfundim fatal nuk ishte i pazakonshëm në një të sëmurë të tillë, pavarësisht nga çfarëdo mjekimi bashkëkohor që mund të merrte. Kjo do t'ishte katastrofë e vërtetë. Për një çast, një drithmë i përshkoi, gjithë trupin. Vdekja e çdo të sëmuri në spital, i nënshtrohej një analize të veçantë mjekësore, shumë të përgjegjshme, e cila i vlente edhe kualifikimit profesional, sidomos kur ajo bazohej edhe në të dhënat e autopsisë. N'atë kohë, pothuajse të gjithë të vdekurit në spital i nënshtroheshin autopsisë. Por një rast si ky, kur mund të ngriheshin dyshime, se vdekja mund të ketë ndodhur nga mjekimi i gabuar, bëhej menjëherë problem mjekoligjor, pas të cilit vinte hetuesia. Dhe hetuesia nuk ishte aspak e urtë. Megjithatë, ai e mblodhi veten shpejt dhe i tha drejtorit:

-Shoku drejtor, sa rrimë e debatojmë këtu, pse nuk shkojmë ta shohim të sëmurën dhe pastaj kthehemi e vazhdojmë diskutimin?

-Mirë, - ia ktheu menjëherë drejtori i mërzitur, ashtu po bëjmë.

Drejtorit i vinte keq, që mjeku të cilin e kishte shok, kishte besim të plotë dhe e vlerësonte shumë, të bënte një marrëzi të tillë. Mendonte edhe për pasojat e rënda. U ngritën të gjithë dhe pa bëza fare, iu drejtuan pavijonit. Pacientja ishte në dhomën Nr 1 në shtratin Nr 6, menjëherë pas derës, në krahun e djathtë. I pari hyri drejtori e pas tij të tjerët. Doktor Agimit, i cili hyri menjëherë pas drejtorit, i shkriu gjaku, kur e pa të sëmurën.

-Cila është e sëmura, -iu kthye atij drejtori.

-Ja kjo këtu, - iu përgjigj ai buzagaz, - duke i treguar me gisht të sëmurën, e cila ishte ulur këmbëkryq mbi shtrat dhe po hante qetësisht një tas përshesh me kos.

-Oo! - tha drejtori, - unë e njoh këtë, se e kam parë edhe herë të tjera në spital. Po kjo qenka për bukuri, si nuse me tel!

-Po mor po, meir jam sot, meir, po ta dish tei or doktorr se ç'i ka hjek bitha gjithë natën kësaj nane! atëherë kishnje për ta marrë vesht me tamam, - ia ktheu vetë e sëmura.

-E ç'ke hequr? – e pyeti drejtori, gjithë kurreshtje.

-Po, mener jush, meta gjith natën me uturak nër bithë, or doktorr. Po shiqir, teshtei (tashti) afër mjesit shkova vetë në nevojtore. Po u lodha e u këputa tu shku e ardhë. E ç'them ne unë shkreta! Po dje mu më kanë pru me vig or doktorr, s'kishnje fuqi as me fol e jo ma me lëviz. Po, juu, Zoti u faltë! se me thanë të drejtën, kësaj here s'ma meirrte (mirrte) menja se do ngreihesha (ngrihesha) ene (edhe) nji herë në kamë.

-A po të shijon përsheshi, e pyeti drejtori, të cilit i erdhi humori, kur pas atij diskutimi që ishte bërë para pak minutash në drejtori, pa atë skenë që iu duk për të qeshur.

-Me thanë të drejtën, m'i çeli sëtë (sytë), -ia priti ajo - *kishnje (kisha) trei (tri) ditë pa fut gja në giojë (gojë).*

-E po! Të bëftë mirë! - i tha asaj drejtori, - gjithë duke buzëqeshur. Ne kaluam, të të shohim, pasi mjeku i rojës na raportoi se dje ti kishe qenë shumë keq.

-Keq, theee?! Ishnje (isha) tu dhanë shpirt, mor lum nana. Po sa erdha këtu, më pa qiki (qe ky) doktorri, - duke treguar me gisht doktor Agimin. Mastaj (pastaj) infermieret më dhanë një grusht barna, më dhanë prapë ma vonë ene një grusht tjetër me barna, deri në mramje më dhanë prap si ato kokrrat, por vetëm ka nja a dii. Më banë ene nji gjilpanë në tule. E, kur të më plasi muu!... ku je - ku je! Shurra krue! m'u desh të mos e daja uturakun prej bithe. Po shiqir Zotit, sot më duket sikur s'jam unë ajo e gjeshmja (e djeshmja). M' ka hik krejt e emja (enjtja). Ashtë tue më hik menja prej kreje. Jam a sjam unë, ajo si (që) ishnje gjie. Zot shiqir, ja rabi!

- Shumë mirë, ia ktheu asaj drejtori, buzagazas. Kemi infermiere të kujdeshme, apo jo?

-Të kujdesshme theee?! - ia ktheu ajo me habi, *-më kanë shërbie si t'i kishnje pas cucat e meia* (mia)*, që unë e shkreta kam vetëm një gjalë (djalë). Zoti i lashtë ato!*

Drejtori u kthye nga të sëmurat tjera, i pyeti edhe ato si ndjeheshin, u uroi atyre shërim të shpejtë dhe doli nga dhoma. Në korridor, ai u ndalua dhe u tha mjekëve:

-Shkojmë në zyrë.

Si zunë vend të gjithë, drejtori iu drejtua Agimit:

-Që kur ke filluar ta përdorësh këtë mënyrë mjekimi ti Agim?

-Që në fillim të shtatorit, - u përgjigj ai, - pasi u ktheva nga Tirana.

-Atje e mësove këtë?

-Jo – u përgjigj doktor Agimi - këtë e kam mësuar nga librat dhe revistat e mia.

-Ç'do me thënë kjo, të përdorësh doza të tilla të mëdha barnash, pa e diskutuar më parë? –pyeti ai, i nervozuar.

- Shoku drejtor, unë nuk e kam quajtur të nevojshme të diskutojmë për metoda standarde mjekimi. Unë jam këtu i vetmi patolog i specializuar. Asnjëri prej jush nuk është i detyruar të njohë hollësitë e mjekimit me digital. Unë, nuk po bëj një veprim që bëhet për herë të parë. Kjo është një mënyrë standarde mjekimi për të sëmurët me prishje të punimit të zemrës në Amerikë. Edhe në letër-udhëzimin e prodhuesit, kështu përshkruhet. Kështu që...

Por drejtori e ndërpreu atë me zemërim:

-Po lëre more Amerikën! – ta thashë edhe një herë, - vazhdoi ai. –Si nuk na qenka për herë të parë! Ti vetë po thua që kjo mënyrë nuk përdoret as në Tiranë.

-Kjo nuk do të thotë që të mos e përdorim edhe ne këtu në Peshkopi. Ju vetë e paskeni parë disa herë në spital këtë të sëmurë. Të vazhdojmë atëherë ta mjekojmë me injeksione strofantine, e të na kthehet prapë pas dy javësh në spital, ose të mos arrijë të kthehet fare?... Kjo kategori të sëmurësh, nuk mund të jetojë pa mjekim të rregullt kronik. Dhe, mjekimi kronik me injeksione përditë, merret me mend, që është i pamundur. As mjekim me digitalinë e lanatosid C me pika, nuk mund të përdorim për të sëmurët nga fshati, të cilët mund të vijnë në spital vetëm kur bëhen për vig. Kemi parë plot helmime me këto barna.

-Po t'i japësh të sëmurit 18 tableta digitoksinë në ditë, qenka më pak toksike?! – ia preu drejtori.

-Jo! Nuk është aspak kështu. Së pari, kjo është vetëm doza e digitalizimit të plotë, të shpejtë që merret brenda ditës. Pastaj, të nesërmen kalohet menjëherë në dozën mbajtëse, e cila individualizohet për çdo të sëmurë, sipas tolerancës përkatëse. Së dyti, unë i kam stërvitur infermieret që para se t'i japin të sëmurit dozën e radhës, të hetojnë për shenja helmimi. Dhe në dyshimin më të vogël, ta pezullojnë atë deri sa të shkoj vetë për ta parë të sëmurin. Ato e bëjnë kaq mirë këtë, sa deri më sot nuk kemi pasur asnjë helmim të përfillshëm. Ja, ku është dhe kolegu im më i ri – duke kthyer kokën nga kolegu i tij, i cili e kishte zëvendësuar gjatë kohës që ai vetë ishte për specializim në Tiranë. Ky mund t'ju thotë nëse është ndryshe. Të sëmurët që i kemi mjekuar kështu, nuk na kthehen si më parë, brenda dy tri javësh. Unë i udhëzoj ata të vijnë pas një muaji në poliklinikë për konsultim. Kam krijuar dhe një regjistër të posaçëm për ndjekjen e tyre. Kështu, ne mund të bëjmë korrigjime të dozimit të barit kur është e nevojshme dhe u mundësojmë që të mos mbeten në derë të spitalit, por të jetojnë jetën e tyre pa shumë kufizime e vuajtje.

Në zyrën e drejtorit kishte rënë një heshtje e thellë. Drejtori dhe kolegët e dëgjuan atë me vëmendje, por nuk po e hapte kush gojën. Tashti që u pa se e sëmura ishte mirë dhe nuk e kishte gjetur gjë, doktor Agimi nuk ndjehej më i trembur. Ai e kuptonte se në një mjedis ku gjerat nuk diheshin, ose nuk diheshin mirë nga të gjithë ata që duhej të përziheshin në një punë që nuk ishte fusha e tyre, duhej gjetur një zgjidhje tjetër. Për shkak të numrit të vogël të mjekëve, ata duhej të bënin shërbim roje për gjithë spitalin. Kështu që, secilit prej tyre i binte të merrej me të sëmurë që i përkisnin kirurgjisë, patologjisë, pediatrisë, infektivit a dispanserisë antituberkulare. Natyrisht, dijet e marra në shkollë, nuk ishin të mjaftueshme për ta bërë këtë njësoj si specialisti i fushës, të cilin megjithatë, ata mund ta thërrisnin kur nuk ia delnin dot vetë. Kështu, pas disa çastesh heshtjeje, doktor Agimi vazhdoi:

-Shoku drejtor, meqenëse na lindi ky problem, unë mund të jepja një informacion shkencor të përditësuar, që edhe kolegët të mos ndjehen të befasuar, kur t'u qëllojë të ndeshen me mjekime të tilla gjatë shërbimit të rojës.

-Nuk e ke keq, - ia ktheu drejtori mendueshëm. Mirë! më mirë kështu. Atëherë, sot është e mërkurë, të shtunën, pas mbledhje së mëngjesit, ke një gjysmë ore kohë në dispozicion, të na japësh një informacion shkencor të përditësuar, për përdorimin e digitalit, - dhe u ngrit nga vendi për të dhënë të kuptohej se mbledhja kishte mbaruar.


Të shtunën, doktor Agimi, ashtu si ç'ishin marrë vesh, i informoi kolegët e tij për mënyrën e digitalizimit të shpejtë, një metodë mjekimi që në Shqipëri nuk përdorej tjetërkund. Ai u tregua bindës. Në raftin prapa shpinës së drejtorit, përveç revistave mjekësore sovjetike, binte në sy revista e Shoqatës Amerikane të Mjekësisë (JAMA), që spitali e kishte abonuar me kërkesën e doktor Agimit. Ishte aty edhe revista italiane Minerva Medica e porositur me kërkesën e kolegut radiolog, i cili lexonte në italisht. Ai u tregoi, gjithashtu, referencat ku ai ishte mbështetur. Të gjitha në librat mjekësore më autoritare bashkëkohore amerikane, të cilat gjindeshin në bibliotekën e tij personale. Ai, i blinte ato në librarinë e qytetit, përmes së cilës i porosiste. Drejtori i atëhershëm i librarisë Peshkopisë, Abdulla Hoxha, ishte një njeri shumë dashamirës për ata që blenin libra. Ai bënte kujdes të jashtëzakonshëm për ndjekjen e porosive që bëheshin për libra perëndimore. Nuk kishte ndodhur asnjëherë që porositë të refuzoheshin. Në vitet 60 dhe në fillim të viteve 70, blerja e librave perëndimore nga mjekët nuk ishte e vështirë, se numri i atyre që lexonin në gjuhë të huaja ende nuk ishte i madh. Më pas ajo do të bëhej më e shtrënguar, kryesisht për shkak të kursimit të valutës së huaj. Por për bibliotekat e spitaleve kufizimi nuk ishte aq i shtrënguar sa për individët.

Në përfundim të informacionit përditësues, doktor Agimi propozoi të organizohej një sesion shkencor. Fillimisht, ky propozim u prit me hezitim nga kolegët. Por pas një diskutimi më të thelluar secili erdhi në përfundimin se mund të kishte diçka për të kumtuar. Të gjithë, më së fundi, hoqën dorë nga droja dhe propozimi për sesionin shkencor u miratua. Kështu, në *Sesionin I shkencor të Shoqatës së mjekëve të Dibrës,* mjekët e spitalit dhe maternitetit të Peshkopisë, midis të cilëve edhe doktor Agimi, paraqitën punimet e tyre. Brenda shtatë-tetë vjetësh niveli i kujdesit mjekësor e shëndetësor në rrethin e Dibrës ishte ngritur dukshëm. Në spitalin e Peshkopisë kujdesi mjekësor ishte vënë mbi baza të shëndosha të mjekësisë moderne. Nga ana tjetër në të gjitha zonat kryesore: Shupenzë, Klenjë, Ostren, Lurë, Sllovë, Selishtë e Zallë-Dardhë ishin ndërtuar spitale rurale dhe pajisur me mjekë e personelin e nevojshëm. Kujdesi mjekësor u ishte afruar pranë banorëve të këtyre zonave dhe ata mund ta përfitonin atë me më shumë lehtësi.

Pas transferimit të doktor Agimit në Tiranë, mjekimi me mënyrën e digitalizimi i shpejtë mund të ketë vazhduar të përdorej edhe për njëfarë kohe në spitalin e Peshkopisë, por ajo nuk u përdor tjetërkund në Shqipëri. Ajo kërkonte një bashkëpunim shumë të ngushtë të mjekëve me infermieret, gjë që nuk ishte e realizueshme kudo. Në kohën e sotme, për shkak të futjes në përdorim të një numri barnash shumë të efektshme për mjekimin e prishjes kronike të punimit të zemrës, përdorimi i digitalizimit të shpejtë është kufizuar. Sot ai përdoret vetëm kur kjo sëmundje e zemrës shoqërohet me një aritmi të shpejtë me çrregullsi të plotë, ose kur kjo aritmi shfaqet edhe në mungesë të një dëmtimi serioz të zemrës. Por mjekimi me digital, sukseset dhe dështimet e tij, u bënë shkak për studime e kërkime të panumërta shkencore, që së bashku me përparimin teknologjik, çuan në gjetjen e mënyrave më të efektshme të mjekimit të prishjes së punimit të zemrës prej dëmtimit të muskulit të saj nga shkaqe të ndryshme.

Gjithkush beson se në qendrat e mëdha bëhet mjekësi klinike e mirë, dhe ashtu është. Por mjekësi e mirë klinike mund të bëhet gjithashtu kudo ku mjeku, si njeridashës i madh, kërkon të bëjë më të mirën e mundshme për të sëmurët që ka në ngarkim. Kjo, natyrisht, kërkon që ai ta mbajë veten të përditësuar me zhvillimet e vrullshme të shkencës, teknologjisë dhe praktikës më të mirë klinike. Por, ajo kërkon gjithashtu, guxim klinik të justifikuar, siç kërkon edhe që ky guxim të mirëkuptohet. Kështu është shtyrë dhe do të vazhdojë të shtyhet përpara mjekësia klinike.

"Fshati në këmbët e Temlës"
- një testament që i lihet fshatit



Nga ESMERALDA BICA

Sa herë lexojmë një libër të shkruar për vendlindjen, gëzohemi pa masë. Dhe kemi të drejtë, pasi brenda tij fshihen ndodhitë e hershme të fshatit, të cilët duke i lexuar mësuar apo kujtuar, çmallemi, mallëngjehemi dhe shpesh herë pyesim veten dhe themi: Heu bre, si nuk i paskemi ditur gjithë këto ngjarje? Dhe në të njëjtën kohë ndjehemi krenar për vendlindjen tonë. Të gjitha këto do ti mësojmë duke lexuar librin e ri "Fshati në këmbët e Temlës", me autor Destan Ramën. Autori në këtë libër ka sjellë në vëmendjen e lexuesve vlerat shpirtërore, patriotike, atdhetare, arsimore, kulturore, të fshatit Peladhi, ku i ka rrënjët, ku për herë të parë ka parë dritën e diellit dhe ku mësoi ABC-në. Nëpërmjet librit njihemi me vendndodhjen e fshatit, një pozicion ky, i vendosur bri një qyteti të hershëm i quajtur "Qyteti i Valikardhës", i ndërtuar në perëndim të tij dhe që mbyll krahinën e Grykës së Madhe.

Me punën e tij hulumtuese autori ka zbuluar origjinën e emrit të fshatit. Një emër ky, që vjen nga legjenda. Ka të bëjë me betejat dhe luftën e Skënderbeut kundër turqve. Pela e ushqyer me grurë dhe e hedhur nga shkëmbi e copëtuar aq shumë sa që nuk kuptohej nëse është pelë apo dhi, mbyll debatin e ushtarëve turq (Peladhi).

Me mjaft interes dhe kureshtje lexohet puna e bërë nga autori për gjetjen e origjinës së fiseve të fshatit. Për këtë i erdhën në ndihmë fletorja nr.1 e Sami Kamberit, një ish kuadër me vlera të çmuara në fshat, si edhe vjelja e tregimeve apo e kujtimeve nga tregimtarë popullorë, dokumentet dhe fotot që ata kanë ruajtur. Po edhe ata të mbledhura në Desovë, Manastir, fshatrat Duf dhe Rekë në Dibrën e Madhe (Maqedonia e Veriut). Ndjen një kënaqësi dhe mallëngjehesh kur lexon mënyrën e festimit të festave tradicionale dhe zyrtare në fshat. Nëpërmjet tyre jepen mesazhe të rëndësishme mësimi dhe edukimi. Skeci "Lufense" që luhej nga djemtë dhe vajzat e fshatit ishte mjaft domethënës. Lufencja nga një grua dembele me ndihmën e dy motrave të saj, bëhet një grua e mençur e pastër, e dashur për fëmijët e burrin e saj. Nëpërmjet këtij skeçi zbulohet mesazhi; se edhe në varfëri, jetesa mund të bëhet e pranueshme, po të mos biesh në dëshpërim, dhe po t'i vësh në përdorim të gjitha mundësitë që ke. Zhvillimi i bujqësisë dhe i blegtorisë, zë një vend të rëndësishëm në libër, si dy tregues kryesorë për të mbajtur gjallë jetën në familjet e fshatit.

Në libër autori na bën një retrospektivë të rëndësishme për ish kooperativën bujqësore me të mirat dhe të këqijat e saj. Zhvillimi i zejtarisë në fshat shihet si dritëdhënës për të. Pa zejtarinë nuk kishte se si të arrihej zhvillimi i fshatit. Dhe se kjo nuk i ka munguar kurrë atij. Një vend të rëndësishëm, dhe që lexohet me kureshtje zë kapitulli: kultura familjare, shoqërore materiale në fshat. Këtu vihet në dukje se këta nuk i kanë munguar kurrë fshatit. Mjaft bukur përshkruhen këtu peripecitë nëpër të cilat ka kaluar jeta e banorëve; nga kasollet të mbuluara me kashtë, në shtëpi e vila të bukura banimi, nga veshje tradicionale në atë të kohës, nga sofra, koshtenja në kondrabufe e dhoma gjumi moderne. Të tërheq vëmendjen, veçanërisht mënyra e organizimit të fshatit, ku bazë ishte itifaku dhe zbatimin me korrektësi normave zakonore, i gjyqit me të cilët zgjidheshin problemet jetikë të fshatit.

Me kërshëri dhe kënaqësi lexohet kapitulli për atë më kryesorin; zhvillimin e arsimit në fshat pasi aty e ka bazën dituria, ku tek odat e tij të verbrit i erdhën sytë. Zhvillimi i veprimtarive kulturoro-artistike dhe fizkultiroro-sportive në libër trajtohet në mënyrë të hollësishme. Në fshat kishte grup artistik, kishte skuadër futbolli dhe zhvilloheshin veprimtari nga më të ndryshmet për argëtimin e banorëve. Mjaft interesante është përshkrimi i organizimit dhe i zhvillimit të dasmës dhe të mortës në fshat. Banorët kanë ditur të zhvillojnë dasma sipas stilit të tyre, që në kohët e hershme, kanë ditur të shijojnë gëzimin e saj,ashtu siç kanë ditur të përballojnë me hidhërim, por me solidaritet e respekt mortën. Në libër përshkruhet me mjaft kujdes edhe zhvillimi i shëndetësisë në fshat, nisur me metodat më primitive deri te ato shkencore për shpëtimin e jetës të banorëve. Një vend të rëndësishëm në libër zë përshkrimi i portretit të disa personaliteteve që kontribuan dhe vazhdojnë të kontribuojnë për fshatin e tyre. Të gëzon fakti se në rrugëtimin e tyre po ecën edhe gjenerata e re.

Për mua ky libër është një testament që i lihet fshatit, për të mësuar ç'ka ndodhur në fshatin e tyre dhe që u lihet trashëgimi gjeneratave të ardhshme. Suksese autorit.

PËRKUJTOHET 100-VJETORI I VRASJES SË RAMIZ DACIT

RAMIZ DACI "Qytetar Nderi"



Gjatë muajve mars-prill në Bashkinë e Bulqizës u organizuan disa veprimtari në kujtim të dëshmorit patriot Ramiz Daci. Sipas një programi të hartuar nga Drejtoria e Arsim Kulturës Rinisë dhe Sporteve u zhvilluan aktivitetet që synonin njohjen e jetës dhe veprës së patriotëve atdhetarë, sensibilizimin e opinionit nëpërmjet shtypit, medias, fletëpalosjeve, takimeve me veteranë, me familjet e dëshmorëve,të rinjve etj.

Me 10 prill në një cermoni përkujtimore u mbyllën këto veprimtari me një takim mbresëlënës ku morën pjesë:qytetarë të Bulqizës,të afërm të familjes së Ramiz Dacit nga Dibra e Madhe,Kryetarët e Shoqatave të Grykës Vogël dhe të Grykës Madhe Gollobordës,veteranë të punës, të luftës Nacionalçlirimtare etj.

Ishin të pranishëm: Prefekti i Qarkut Dibër Nexhbedin Shehu, Kryetarja e Këshillit të Qarkut Valentina Haliti, Kryetari i Bashkisë Bulqizë Lefter Alla, Zv/Kryetari i Shoqatës Lidhja e Intelektualëve Dibranë z. Musa Riçku, Kryetari i Komitetit të Veteranëve të luftës Nacionalçlirimtare Bulqizë Xhevat Jella e të ftuar të tjerë.

Pas ekzekutimit të himnit kombëtar të pranishmit ndoqën një dokumentar kushtuar jetës dhe veprimtarisë së deputetit Ramiz Daci. Dokumentari tregonte ;origjinën e familjes së Ramizit nga Zogjet, arsimimin e tij, kontributin e dhënë në përkrahje të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të Lidhjes Pejës dhe të gjitha Lëvizjeve për pavarësi e shkollë shqipe në Dibër të Madhe.

Ramizi delegat në Kongresin e Manastirit, të Dibrës,bashkëpunimi me Gjergj Fishtën, Ndre Mjedën, Kristo Floqin, Luigj Gurakuqin, Mihal Gramenon, Çerçiz e Bajo Topullin etj.Takimet dhe bisedat me ta lanë gjurmë të thella në ndërgjegjen e patriotit të ardhshëm i cili u rradhit në krye të kryengritjeve të mëdha të viteve 1911-1912,luftën kundër serbëve e bullgarëve për të mbrojtur pavarësinë etj.

Fjalën e rastit e mbajti Lefter Alla, kryetari i Bashkisë Bulqizë.

Ai u ndal në rolin e Ramiz Dacit si drejtues i kryengritjes antiserbe më 1913,komandant i kavalerisë në ushtrinë Shqiptare më 1914,deputet i Drinit në Kuvendin e dalë pas Kongresit të Lushnjës 1920. Ramizi përfaqësoi krahun patriot e demokratik në Asamblenë Kushtetuese.

Referuesi, Ramizin e cilësoi si njohës të mirë të interesave të fshatarësisë patriote e të vegjëlisë dibrane. Ai u rreshtua përkrah Elez Ysufit, Vehbi Dibrës, Mersim Demës, Bajram Currit, Hasan Prishtinës etj. U zgjodh një ndër drejtuesit kryesorë të qeverisë së Arrasit dhe Lëvizjes së marsit 1922. Mbajti lidhje të vazhdueshme me patriotët e Grykës Madhe e Bulqizës si: Destan Pucën, Hajredin Shehun, Mehmet Duriçin, Ramiz Alliun etj.

Me 9 prill të vitit 1922 Ramizi arrestohet prej Fiqiri Dines në Peshkopi.

Me 10 prill e nisin nga Homeshi nëpër Zerqan për në Tiranë.

Te ura e Xhitetit e merr në dorëzim Shefqet Korça, i cili me njerëzit e tij të xhandarmërisë shqiptare e qëllojnë pas shpine, duke e vrarë pabesisht patriotin atdhetar Ramiz Daci.

Ramizi punoi e luftoi për çështjen kombëtare, prandaj do nderohet e respektohet brez pas brezi.





RAMIZ DACI "QYTETAR NDERI"

Një qytetar nderi i ri për Bulqizën u bë Ramiz Daci. Kjo u vendos unanimisht nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Bulqizë me propozim të Lidhjes së Intelektualëve të Dibrës, me Vendimin nr.315 datë 23.03.2022.

Z.Gëzim Xhafa, Kryetar i atij Këshilli duke i dorëzuar përfaqësuesit të familjes dekoratën u shpreh: "Jam shumë i privilegjuar që sot po deklaroj para jush Vendimin e Këshillit Bashkiak Bulqizë për shpalljen "Qytetar Nderi", atdhetarin e njohur, luftëtarin e lirisë e të demokracisë Ramiz Dacin (pas vdekjes). Jeta dhe vepra e tij do të rrojë në shekuj në mendjen dhe zemrat e popullit dibran".

Në emër të familjes foli Namik Daci: "Falenderoj Këshillin Bashkiak, Bashkinë Bulqizë, organizatorët për nderimin që i bëtë njeriut tonë, Ramiz Dacit. Sot ndjehem më shumë krenarë.Na krijuat emocione, për pritjen, fjalët e ngrohta dhe të sinqerta që na përcollët për të parët e familjes sonë dhe për Ramizin.

Mirënjohje dhe respekt për të gjithë Ju, popullin e Bulqizës, Grykës Madhe e gjithë Dibrës".


Pjesmarrësit i përshëndetën: z. Nexhbedin Shehu, Valentina Haliti, Xhevat Jella, të cilët vlerësuan rolin e Ramiz Dacit si: ushtarak, politikan,deputet dhe luftëtar i paepur kundër pushtuesve, në mbrojtje të pavarësisë e tërësisë territoriale të shtetit shqiptar, në kufijtë e përcaktuara në vitin 1913. Ata vunë në dukje punën e lëvdueshme që bën vazhdimisht Bashkia Bulqizë, Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Sporteve që drejtohet nga znj. Lediana Gjoka, në përkujtimin e ngjarjeve historike, patriotëve, dëshmorëve, vlerësimin e njerëzve të shkencës, punëtorëve e qytetarëve model në jetën e përditshme të qytetit të minatorëve.

Në kudër të këtij jubileu Botimet "M&B" përgatitën dhe nxorën në qarkullim monografinë "Ramiz Daci" me autor z. Zabit Lleshi.

Prof. dr. Adem Bunguri, si recensues i monografisë, tha se kjo monografi plotëson një boshllëk të ndjeshëm për njohjen e plotë të figurës patriotike të Ramiz Dacit, këtij vigani liberator. Kjo monografi është e lexueshme lehtësisht nga një audiencë e gjerë qe kalon shumë përtej studiuesve të interesuar për historinë e Dibrës dhe atë të Shqipërisë në gjysmën e parë të shekullit XX.

Profesor Ademi solli në vëmendje përvojën e mirë të Bashkisë Bulqizë në tërheqjen e mendimit të historianëve, specialistëve të ndryshëm e kompetent që japin mundësi që të merren vendime unanime për të rezistuar në kohë. Kështu vendimet nuk kontestohen

Një qytetar nderi i ri për Bulqizën u bë Ramiz Daci. Kjo u vendos unanimisht nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Bulqizë me propozim të Lidhjes së Intelektualëve të Dibrës, me Vendimin nr.315, datë 23.03.2022.



e bëhen më jetëgjatë. Bashkëpunimi me Shoqatat, grupet e interesit, Lidhjen e Intelektualëve Dibranë përbëjnë një shembull që duhet ndjekur nga Bashkitë dhe Njësitë Administrative të Qarkut të Dibrës e më gjerë.

Nxënësit e shkollës "Xhevdet Doda" recituan pjesë nga folklori dibran për familjen Daci.

Këngëtari amator Hajri Alimani u përcoll me duartrokitje me këngën për Lam Dacin.

NJE LAPIDAR I RI

Në vendin e vrasjes së dëshmorit patriot Ramiz Daci te ura e Xhitetit, tashmë është ngritur një lapidar i Ri, kontribut i Bashkisë Bulqizë në kujtim të atdhetarit, fatosit të demokracisë, Ramiz Dacit.



Ai do të nderohet e kujtohet brez pas brezi.

Prania e mjaft të rinjve me flamuj kombëtar e rriti ndjeshëm solemnitetin e veprimtarisë e na mbushi me emocione të forta. Vizita te lapidari dhe vendosja e kurorave në emër të: Prefekturës, Këshillit të Qarkut, Bashkisë Bulqizë, Lidhjes së Intelektualëve Dibranë dhe familjes, mbylli nderimet në kujtim të 100 vjetorit të vrasjes së Ramiz Dacit.

U larguam nga Bulqiza duke marrë me vete kujtimet e një dite të paharruar për Ramiz Dacin, të bindur se aktivitete të tilla do të zhvillohen edhe në të ardhmen me moton: "Pa njohur të kaluarën nuk mund të ndërtojmë të ardhmen"

Faleminderit Bulqizë. Ju urojmë më të mirat dhe suksese.

Morena Ruçi,
drejtore e Muzeut Historik të Dibrës

histori

Me rastin e 100 vjetorit të vrasjes botohet libri bografik me autor Zabit Lleshi. Ramiz Daci në parlamentin shqiptar ishte shumë aktiv, merrte pjesë në diskutime, jepte mendime për legjislacionin, programet e zhvillimit që hartonte qeveria me instrumentet e saj për arsimin, politikën e brendshme dhe të jashtme, Asamblenë Kushtetuese etj.

Ramiz Daci, dëshmor i luftës për liri e pavarësi

Ramiz Selim Daci me origjinë nga Zogjet, pinjoll i një familje të njohur patriotike u lind në Dibër të Madhe më 1883. Gjyshi i tij Said Daci veprimtar e pjesëmarrës aktiv në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, dha një ndihmesë të çmuar bashkë me familjen e tij të madhe në luftën për realizimin e detyrave të asaj Lidhje për Dibrën. Shtëpia e Dacit kishte përcjellë shumë ngjarje dhe lëvizje patriotike në gjirin e saj, kishin dalë jo vetëm luftëtarë, por edhe prijës të luftëtarëve dibranë si Mustafa, Cen, Lam, Said, Shaqir, Ibrahim, Qamil Daci etj.

Kullat e Daceve ishin vatra të vullkanit e zemërimit popullor në Grykë të Vogël e Dibër të Madhe, një shembull i trimërisë dhe mençurisë dibrane. Me këtë frymë u rritën brezi më i ri si Rushiti, Maliqi, Skënderi, Fatoni etj.

Mësimet e para i mori në Dibër të Madhe, fshehurazi e me vështirësi mjaft të madhe, në kushtet e ndalimit të shkollës dhe arsimit shqip nga ana e sundimit otoman.

Kështilli administrativ i prefekturës së Dibrës zgjodhi dy të rinj: Ramiz Dacin e Aqif Rusin, duke u akorduar të drejtën e studimit në shkollën ushtarake "Ashiret Mektebi" në Stamboll. Kreu me sukses studimet në shkollën ushtarake dhe fitoi gradën nëntoger.

Gjatë studimeve u njoh me shumë bashkëkombës, student në shkollat e larta, por edhe me patriotë të Rilindjes si Ismail Qemmali, Hasan Prishtina, Riza Tefiku, Maliq Tanushi, Dervish Hima, Hamdi Ohri, Ibrahim Tema, Haxhi Vildani etj.


Ramizi mori një kulturë orientale, studioi e zgjeroi njohuritë e tij politike e shoqërore. Njohu nga afër qëndrimet dhe politikën e Perandorisë Osmane ndaj Ballkanit e në veçanti ndaj Shqipërisë. Kulturën ushtarake, që fitoi gjatë studimeve i shërbeu për drejtimin e veprimeve luftarake kundër serbëve, bullgarëve, çetave epirote në Korçë etj.

Në vitin 1906 filloi punë në Rekë të Dibrës si nëntoger në administratën e xhandarmërisë turke. krijoi njohje për fshatrat e patriotët e Rekës si Josif Bageri, Anastas Allbaski, Hafëz Tanusha, Iljaz Hoxha etj.

Reka pararojë e luftës për hapjen e shkollave shqipe u ndesh vazhdimisht me pushtuesit osman, serb e bullgar kundër hapjes shkollave turke, serbe e bullgare në fshatrat e saj. Në Rekë Ramiz Daci forcoi më shumë lidhjet me Dibrën e Madhe, duke shpejtuar procesin e shthurjes së Perandorisë Osmane. Organizoi dhe nxiti fshatarët patriotë të Rekës, që mos të dërgonin ushtarë (nizamë), të mos paguanin taksat dhe të kundërshtonin çdo iniciativë të Turqve të Rinj pas viteve 1908. Refuzoi punën në administratën e re xhonturke, u largua në mënyrë demonstrative dhe iu kushtua çështjes kombëtare. Kundër reformave të xhonturqve, patriotët shqiptarë ngritën pranë qyteteve shqiptare Klubet Kombëtare, nën shembullin e udhëheqjen e klubit "Bashkimi" të Manastirit. Klubet ngritën me të shpejtë shkollat shqipe, shpërndanë pa pagesë literaturë shqipe në organet periodike, Brenda e jashtë vendit, madje në Korçë, Shkodër, Manastir filloi botimi i gazetave shqiptare1.

Ramiz Daci u aktivizua si antar i Klubit "Bashkimi" të Dibrës së Madhe, themeluar në dhjetor 1908 me kryetar Hafëz Sherif Lëngu. Me anë të artikujve të shumtë Ramiz Daci, në shtypin e kohës demaskoi propagandën e xhonturqve. Ai i bëri një shërbim të madh çështjes kombëtare si publicist, herë me emrin e vet, herë me pseudonimin në faqet e gazetave"Dituria", "Shqypja e Shqypnisë", "Drita", "Shkumbini" etj. Për kontributin në fushën e publicistikës ai pa frikë vjen pas Said Najdenit, Josif Bagerit, Dervish Himës, Hasan Ballancës, Haki Stërmillit, Hasan Moglicës etj.

Për këto merita Ramiz Daci u zgjodh si përfaqësues i Dibrës në Kongresin e Manastirit, që u mbajt më 14-21 nëntor 1908. Ishte një besim e vlerësim i madh nga patriotët e Dibrës së Madhe për Ramiz Dacin, sepse në kongresin e Manastirit merrnin pjesë elita e intelektualeve të letrave shqipe si: shkrimtar, publicistik të njohur, lëvrues të gjuhës shqipe, veprimtar të lëvizjes kombëtare dhe të klubeve shqiptare2. Krahas forcimit të miqësive të vjetra, Ramiz Daci, krijoi miqësi të reja me Bajo e Çerçiz Topullin, Mihal Gramenon, Shahin Kolonjën, Nikollë Kaçorrin, Hilë Mosin, Mati Logarecin, Lef Nosin, Simon Shuteriqin, Refik Toptanin etj. Vendimet, përvoja dhe eksperienca që këmbyen klubet shqiptare në ditët e Kongresit e armatosën Ramiz Dacin dhe e mbushën me një optimizëm. Veprimtaria në shërbim të çështjes kombëtare e



Botimet M&B
ISBN: 978-9928-353-71-9
Formati: 15x22.5 cm
Faqe: 296
Çmimi: 1000 lekë
Viti i botimit: 04/2022

Ramiz Dacit vjen në rritje e pasurohet më shumë për angazhimin e shumë pjesëtarëve të familjes Daci në Kongresin e Dibrës më 23 korrik 1909 në Dibër të Madhe. Ai u organizua nga xhonturqit, por siç shkruan Josif Bageri "terezia rëndoi më shumë në anën e shqiptarëve, cilët ma kujtojnë dhe vendin e tyre e jo për botën3.

Një mbështetës i politikës xhonturke Ejup Sabriu e quajti Kongresin e Dibrës, "Guri themeltar i vetqeverimit të Shqipërisë"4.

Kongresi i Dibrës u kthye në një shkollë të madhe për delegatët, për njerëzit e thjeshtë e qytetarët patriotë të malësisë e fushës së Dibrës në prag të pavarësisë. Kryengritjet e viteve 1910, 1911, 1912, Ramiz Dacin e gjetën në Rekë, Grykë të Vogël, Grykë të Madhe, Bulqizë. Ai u bë një protagonist për vëllazërimin e popullit, bashkimin e tij për çështjen kombëtare. Komunikonte me krerët e Maleve, i nxiste ato në revolta e për kryengritje. Perandoria osmane e kishte mbaruar misionin e saj. Kishte ardhur koha e vetëvendosjes së popujve. Për popullin tonë kishte trokitur ora e pavarësisë.

Kryengritja e përgjithshme e vitit 1912 ishte një kurorëzim i luftërave të gjata të popullit tonë për liri e pavarësi. Ramiz Daci ishte pjesë e shtabit drejtues të patriotëve dibranë me Elez Isufin, Mersim Demën, Vehbi Dibrën, Dan Camin, Jakup Canin, Qamil Dacin, Sheh Sulën, Zenel Hoxhën etj.

Vehbi Dibra u zgjodh delegat i Dibrës për në Vlorë. Si antar të delegacionit të Dibrës shkuan edhe Ramiz Daci e Hasan Dollmeni.

Për Ramiz Dacin ishte fat i madh të merrte pjesë në Kuvendin e Vlorës, jo me mandatin e delegatit. Si një patriot pati mundësi të krijonte njohje e miqësi të reja krahas figurave atdhetare, që kishte njohur në Kongresin e Manastirit e të Dibrës. Ndërkohë ndihmoi e dha propozime mbi funksionimin e xhandarmërisë e ushtrisë shqiptare që u formua pa humbur kohë nga qeveria e re e sapokrijuar. Shquhej për një kulturë të gjerë në fushën ushtarake falë studimit individual me pasion të eksperiencës ballkanike e botërore në fushën ushtarake.

Kthimi i delegacionit të Dibrës nga Vlora ishte i vështirë. Ushtria serbe kishte pushtuar Dibrën. Në këto kushte duhej organizuar rezistenca, protesta pranë Fuqive të Mëdha. Ramiz Daci me familjarët e tij u vu përsëri në krye të luftës kundër pushtuesve serb duke bashkërenduar veprimet luftarake me Mersim Demën, Dan Camin, Halit Lleshin, Destan Pucën, Mehmet Duriçin, Elez Isufin, Jakup Canin, Tush Shehun, Hoxhë Moglicën të malësisë së Dibrës me Shaqir Jegenin, Dervish Himën, Sefedin Pustinën, Sedulla Strazimiri, Riza Beu, Qamil Dacin të Dibrës së madhe.

Pushtimi serb i Dibrës u shoqërua me masakra të mëdha, që detyruan popullsinë dibrane të migronte

> **Ramiz Daci:** "Kanë luftuar të parët tanë e ne na i kanë lënë ti gëzojmë këto troje. Sot që na i ka pushtuar serbi, do të luftojmë ne, që ti gëzojnë fëmijët tanë. Do të luftojmë or burra se na ka ardhë radha".

në Tiranë e Elbasan. Erdhën dhjetë mijë muhaxhirë ku u pritën me një humanizëm e solidaritet.

Ramiz Daci për shkallën e njohjes, që kishte me shumë patriot të Tiranës e Elbasanit u interesua për sistemimin e strehimin e familjeve dibrane në Tiranë.

Është e njohur ndihma e Ibrahim Dalliut me të cilin Ramiz Daci njihej që në shkollë në Stamboll kur ishte student, në Kongresin e Manastirit dhe tashmë në përballimin e situatës pas pushtimit serb. Në fund të vitit 1913 Ramiz Daci shkon në Korçë përkrah Themistokli Gërmenjit e Mihal Gramenos dhe luftoi pranë tyre kundër shovinistëve grekë dhe pretendimeve të tyre për Vorio Epirin5.

Pas ardhjes së Vidit në mars, qeverinë e formoi Turhan Pasha. Ramiz Daci u thirr si ushtarak dhe u emërua komandant i kavalerisë shqiptare. Bashkëpunoi me kolonelin holandez Tomson duke mësuar nga përvoja dhe eksperienca e tij në përgatitjen ushtarake të kavalerisë.

Më 1 janar 1916 ushtria bullgare hyri në Peshkopi, pushtoi edhe Gollobordën, vrau patriotët Elez Koçin, Qazim Dukën, bashkë me 60 burra, gra e fëmijë në Sebisht. Ramiz Daci mbështeti luftën e fshatrave të Gollobordës dhe mbarë Dibrës për ruajtjen e shkollave shqipe, organizoi rezistencën kundër shkollave bullgare, por edhe veprimeve barbare të pushtuesve bullgarë ndaj popullsisë fshatare e qytetare të Dibrës.

Për të ndihmuar Dibrën dhe popullsinë e saj Ramiz Daci u punësua në administratën austriake, në prefekturën e Peshkopisë. Insistoi për hapjen e disa shkollave shqipe në Godvi dhe rihapjen në Zerqan, Homesh, Trebisht, në saj të njohjes që kishte me Luigj Gurakuqin si drejtor i arsimit në Shkodër.

Gjatë luftës së parë botërore, territori i Shqipërisë dhe i Dibrës u kthyen në një shesh lufte. Në fillim të vitit 1918 Dibra u pushtua përsëri nga ushtritë serbe të cilat më 10 tetor hynë në Tiranë. Italia nga ana tjetër sulmoi veriun për të zëvendësuar pushtimin austro-hungarez. Serbia bëri përpjekje për ta paraqitur Italinë para Konferencës së paqes si shkaktare të tensionit në Shqipëri. Ramiz Daci u vu në krye të luftës kundër fushatës së presioneve e kërcënimeve ndaj popullit në zonat e pushtuara, "që të shprehnin vullnetarisht" bashkimin me Serbinë (mbretërinë serbo-kroate-sllovene)6.

Pavarësia u vu në rrezik, patriotët i vunë gjoksin për të shpëtuar Shqipërinë nga humbja e tërësisë territoriale, e gjuhës, nderit, zakoneve e traditave të kombit. Aqif Pasha, Hasan Prishtina, Bajram Curri, Mihal Grameno, Iljaz Vrioni, Abdi Toptani, Hoxhë Kadria, Elez Isufi, Ramiz Daci etj, thirrën një kuvend të ri për të diskutuar gjendjen e Shqipërisë të krijuar pas luftës parë botërore që quhet në histori, Kongresi i Lushnjës.

Dibra në Kongres u përfaqësua nga patriotët Ramiz Daci, Dine Dema e Dine Maqellara (Nasufi) nga paria nacionaliste. Tre delegatë dibranë miratuan vendimin historik për të kundërshtuar çdo cënim tokësor të Atdheut dhe çdo mandat të huaj për Shqipërinë.

Delegatët dibranë u kooptuan si anëtar të Këshillit Kombëtar (deputet në parlamentin shqiptar). "Më aktiv, në saj të kulturës politike dhe ndërgjegjen patriotike ishte Ramiz Daci7.

Kongresi i Lushnjës zgjodhi një qeveri të kryesuar nga Sulejman Delvina dhe kryeqytet Tiranën. Në kuadrin e krijimit të administratës së re si rezultat i presionit të deputetëve dibranë e veçanërisht të Ramiz Dacit e popullit të Dibrës, qeveria e Sulejman Delvinës emëroi Ramiz Dibrën prefekt të Dibrës(Prefektura e Drinit).

Prefekti Ramiz Dibra kishte marrë porosi nga qeveria, që prefektura e Drinit të ushtronte autoritetin e vet deri në kufijtë e 1913. Administrata e prefekturës Ramiz Daci, Jashar Erebara, Osman Lita, Dine Maqellara, Dine Dema, Dulejman Çela, etj, erdhën në Arras, një fshat me të kaluar patriotike, përballë të cilit kishte një përqendrim të madh të trupave serbe(në krahun e djathtë të rrjedhës së Drinit).

Për të festuar fitoren e luftës së Vlorës më 7 gusht 1920, në Arras u mblodhën 3000 dibranë. Entuziazëm e gëzim i papërshkruar shihej në fytyrat e malësorëve të gatshëm për t'u hedhur në luftë kundër ushtrisë serbe, që kishin okupuar Dibrën për 8 vjet nga shpallja e pavarësisë Shqipërisë. Midis shumë personaliteteve dhe patriotëve e prijësve dibranë foli Ramiz Daci, deputet i prefekturës së Drinit, pjesëmarrës në disa ngjarje të rëndësishme të historisë së kombit. Ai evokoi luftërat e të parëve tanë gjatë historisë ku midis të tjerash tha:"Kanë luftuar të parët tanë e ne na i kanë lënë ti gëzojmë këto troje. Sot që na i ka pushtuar serbi, do të luftojmë ne, që ti gëzojnë fëmijët tanë. Do të luftojmë or burra se na ka ardhë radha".

Më 13 gusht kuvendi i Arrasit zgjodhi Komitetin e mbrojtjes së Dibrës me anëtar: Ramiz Bej Dibra, Ramiz Daci, Dine Maqellara, Jashar Erebara, Isuf Xhelili, Ismail Strazimiri, Riza Lusha, Destan Puca, Dulejman Çela, Rushit Sina, Shaqir Dema, Dan Cami, Osman Lita, Llan Destani. Komandant i komitetit luftarak për drejtimin e kryengritjes u zgjodh Elez Isufi.

Planin e mësymjes për kryengritjen e Dibrës kundër serbëve e hartuan Ramiz Daci, Ramiz Dibra e Dulejman Çela si ushtarak që ishin. Bashkë me Elez Isufin caktuan kohën dhe fillimin e kryengritjes8. Kryengritja e Arrasit, organizimi i vullnetarëve dibranë nga Reçi në Gollobordë, zemërimi popullor kundër agresorëve, që masakruan fshatrat e popullsinë e Dibrës, i detyruan ushtritë serbe të tërhiqeshin nëpërmjet Radikës deri në Gostivar. Pas ripushtimit serb të Dibrës, në shtator 1920 Ramiz Daci erdhi në ndihmë të muhaxhirëve në Tiranë. Kujdes të veçantë ai tregoi për strehimin, ku familjet tiranase hapën dyert, ndanë kafshatën e gojës, siguruan ndihmat humanitare etj.

Kontribut të veçantë dha Ramiz Daci për regjistrimin në shkollat e Tiranës të fëmijëve dibranë, të etur për dije e kulturë.

Me atdhetarët Hasan Prishtina, Hoxhë Kadria, Bajram Curri, Elez Isufi, bëri përpjekje të mëdha si me komitetin e mbrojtjes Kosovës, delegacionin shqiptar në Konferencën e Paqes për sensibilizimin e opinionit kombëtar e ndër kombëtar, që emigrantët ti fitojnë të drejtat e tyre për t'u kthyer në trojet e veta.


Ramiz Daci në parlamentin shqiptar ishte shumë aktiv, merrte pjesë në diskutime, jepte mendime për legjislacionin, programet e zhvillimit që hartonte qeveria me instrumentet e saj për arsimin, politikën e brendshme dhe të jashtme, Asamblenë Kushtetuese etj. Ai ishte bashkëpunëtor i shumë organeve të shtypit si:"Shqypnia e Shqypnisë", "E vërteta", "Shkumbini", "Gjergj Kastrioti" etj.

Ramiz Daci është protagonist i "Lëvizjes së marsit 1922" së bashku me demokratët Elez Isufi, Bajram Curri, Halit Lleshi, Dan Cami, Bajram Xhani, luftuan për të reformuan Qeverinë shqiptare që mbronte feudalët dhe çifligarët (konservatorët), për të hapur rrugë zhvillimeve të reja demokratike në vend, zëvendësimin e marrëdhënieve feudale me atë kapitaliste. Pavarësisht dështimit ajo e tronditi nga themelet pushtetin e klasës konservatore dhe qeverinë shqiptare. Këtë luftë e këto sakrifica do ti paguante me jetën e tij atdhetari Ramiz Daci bashkë me shumë patriotë e demokratë të tjerë.

Me porosi të Ahmet Zogut, ministër i brendshëm, disa ditë pas Lëvizjes së marsit, togeri Fiqiri Dine arrestoi në Peshkopi Ramiz Dacin dhe e përcolli për në Homesh. Të nesërmen, gjatë rrugës për në Tiranë nga Zerqani në Valikardhë e merr në dorëzim Shefqet Korça, i cili me bashkëpunëtorët në tradhti, mbas shpine e vranë Ramiz Dacin më 10 prill 1922, në vendin e quajtur "Ura e xhitetit". E vranë forcat regresive e konservatore që luftonin për pushtet, për të forcuar shtypjen dhe shfrytëzimin e popullit, mbështetur tek pushtuesit e armiqtë e deklaruar të Shqipërisë gjatë gjithë historisë.

Komiteti Ekzekutiv, i Këshillit Popullor të rrethit të Dibrës, me vendim Nr 72, datë 25/05/1978 e ka shpallur Ramiz Dacin "Dëshmor të Atdheut".

1 Frashëri 2008, 55.
2 HHSTA.PA, A, Informacion i konsullit austriak, Postal, nr 71, Manastir 23 nëntor 1908.
3 Shqypja e Shqypnisë, nr 6, datë 1 gusht 1909.
4 Stërmilli 1940, 53.
5 Hamit Daci, "Kujtime në dorëshkrim" në muzeun historik të Dibrës.
6 Historia e Shqipërisë, V.III, Tiranë 1984, f, 203.
7 Frashëri 2012, 368.
8 Strazimiri 2010, 110.







Monument i madh i popullit dibran

(Vijon nga faqja 8)

hidrocentrale të tjerë të vegjël që do të sigurojnë rreth 35-40 milionë kilovatorë energji elektrike. Vlerat e kësaj energjie rriten për faktin se ajo merret në përgjithësi pa cënuar ujitjen e tokave, merret gjatë verës kur prodhimi nga hidrocentralet bie për shkak të thatësirës.

Veçori e burimeve ujore në Dibër e rrjetit të kanaleve ujitëse është se ata japin bukë dhe dritë, dy gjera për të cilat populli ka aspiruar në shekuj, gjëra të cilat koha i nxori nga kufiri i legjendave për ti vendos në çdo vatër.

Burimet ujore që përshkruam janë shekullorë. Edhe Drini, edhe degët e tij, edhe liqenet e Lurës e të Tërnovës kanë rrjedhë e rrjedhin vazhdimisht drejt detit. Vargjeve të Niolit: *"Pranë detit i palarë/ Pranë dritës i paparë/ Pranë sofrës i pangrënë/ Pranë dijes i pan nxënë" ... /*

ka vend për ti shtuar edhe: *"Pranë ujit, buzëçarë / Pranë lumit, tokë tharë"*.

Populli nuk i mungoi imagjinata, as dëshira e guximi për të çarë malet e për të sjellë ujin në arat e thara, ku siç shpreheshin në Çidhën misrin me rrënjë një laraskë me sqep e ngrinte.

Kërkesë së Çidhnakëve për të marrë ujin e Setës, një inxhinier i një vendi që më vonë do të aspironte për tu bërë perandor do ti përgjigjen se "kjo është një ëndërr e marrë" dhe se "edhe sikur Zogu ti kishte sarajet këtu dhe të derdhte gjithë floririn e tij, kjo gjë nuk mund të bëhej".

Letrave të pleqnisë së Radoveshit që kërkonin "50 kuintal çimento" për të bërë "një shtresë me çimento në vendet ku rrjedh ujët e vijës", gjë e cila "kishte me i sigurue gjithë katundit bukën e nevojshme", letrës së kryepleqësisë së katundeve Homesh, Boçevë e Shupenzë të cilët kërkonin "një sasi qyngjesh hekuri ose çimentoje" për të rregulluar "200 metra gjatësi" të një vije që ishte "këputun nga shinat e tepërta që kanë ra", regjimi anadollak i Zogut do ti përgjigjej me heshtje...

Xha Ganiu, Gani Tuçepi (Koçi), inxhinieri i talentuar popullor i ndërtimit të veprave ujore, njeriu që për tetëdhjetë e ca vjet nuk iu nda ujit dhe ujitjes në Dibër e në rreth të tjerë, tregonte shumë raste kur paria dhe aparati feudo borgjez në fuqi, me forcën e armëve dhe të intrigës i la shumë kanale në piket. Ai ruante si shumë të çmuar takimin e parë me shokun Enver Hoxha në vitet e para pas Çlirimit dhe porosinë inkurajuese të tij se "edhe sikur kanali ujitës të kalojë mes fabrikës- të bëhet".

U krijua trualli i shëndetshëm ku veprat ujore mbinë dhe u rritën si gruri, u ngjitën, çanë malet atje ku s'ta pret mendja.

Ndërtimet ujore në Dibër janë vepra arti. Ato janë pjesë e pandarë e kulturës së bujkut dibran, e punës së tij me tokën dhe bimën. Është e njohur kultura e bujkut dibran për brezarimin e tokave, për punimin rrafsh të tyre, për ujitjen në tokat e rrafshëta dhe në ato me pjerrësi të madhe, për drenimin me mjete rrethanore etj.

Pranë çdo çezme, sadopak ujë të kishte, bujku hapte një hurdhë me të cilën ujiste disa dhjetëra e qindra metra katrore, e në raste të veçanta disa dynymë. Përpjekjet individuale për ujitjen e tokës bashkoheshin herë-herë në përpjekje në shkallë lagjeje e fshati dhe në raste të veçanta edhe disa fshatra së bashku. Toka, më parë se të thithte ujin kishte thithur djersën e dibranit, edhe gjakun e tij. Janë të shumta rastet kur vëllavrasjet apo vrasjet nga paria kishin si burim ujin dhe ujitjen e tokave.

Ndërtimi i veprave ujore në Dibër është bërë me shpërthim, me hop, me aksion masiv të njerëzve në të gjitha fshatrat e zonës, në shkallë fshati, të disa fshatrave bashkë, në shkallë zone e rrethi. Kur është hedhë fjala për ujin dhe ujitjen në Dibër është ngritë në këmbë i madh e i vogël. Është ky një element i psikologjisë shoqërore për ndihmë njeri tjetrit që nga viti në vit është rritur duke u ngjitur në shkallët më të larta.

Vitet e para pas Çlirimit të vendit, janë viteve të ndërtimit të veprave ujore masive në numër, janë vite të një pranvere luleshumë. Gazetat e kohës e në veçanti gazeta "Bashkimi" në vitet 1945-1946 flet për "iniciativën e aksioneve popullore" në ndërtimin jo vetëm të kanaleve të vegjël si ai i Zerqanit, Rreth-Kales etj. që ujitnin nga 5 deri 10 hektarë tokë por edhe për kanale të tillë të mëdhenj si Shulla – Zall - Kalis 17 kilometra i gjatë që vinte nën ujë 500 hektarë tokë, Radomirë Kalis 20 kilometra i gjatë që ujiste 200 hektarë tokë etj. Vitet 1949-1951, janë vite të një guximi popullor për ndërtimin e veprave ujore të gjata, vepra ujore që vadisin zona të tëra. Njeriu si një qenie shoqërore, i ndërgjegjshëm për atë që bën, me organizim e disiplinë, me talentin e vet që buronte nga përvoja e popullit, me forcën e krahut dhe të mendjes arrin të bëjë vepra që kur i mat sot me mundësitë e kohës çuditesh. Zgjidhja që iu bë veprës ujore Korab-Sllatinë duke prerë pishat, duke u gërryer atyre zemrën me sqepar e sëpatë e duke sajuar pastaj me to njërin sifon pas tjetrit, në kilometra të tëra, përbën një vepër arti që nuk ia gjen shoqen. Në ato vite kur Shqipëria hidhte hapat e parë duke i ngjitur ngadalë por me themel shkallët e jetës ishte e pamundur të gjeje tuba çeliku për sifone, çimento për betonime e pllaka betoni, rrugë për ti ngjitur ato në Korab. Vjeshta e viti 1952 dhe pastaj viti 1953 janë momente të një entuziazmi të madh për ndërtimin e veprave ujore. Futen nën ujë 1318 hektarë tokë, pak më shumë se sa ishin futur gjatë pesë vjetëve të fundit. Hapet njeri ndër kanalet më të gjatë, kanali Çaj-Vilë-Draj Reç 65 kilometër i gjatë, kanal i cili ujiti për herë të parë 400 hektarë tokë në rrethet Kukës-Dibër. Kanali Tërnovë-Strikçan 35 kilometër i gjatë, kanalet Çernjevë-Sllovë e Vleshë-Shumbat, përkatësisht 17 dhe 14 kilometër të gjatë që ujitnin përkatësisht 152, 300 dhe 150 hektarë shprehje e dashurisë së popullit të Dibrës për të ecur me hap të shpejtë përpara, për të bërë punë të mëdha.

Më 31 maj dhe 1 e 2 qershor të vitit 1960 Enver Hoxha ishte përsëri midis dibranëve. Pemët e mbjella në blloqe atë vit kishin çelë lulet e para, kishin lidhë frutat e para, kishin zgjuar gjelbërimin në kodrat e Zdojanit, Kubenit, Kastriotit. Enveri midis filizave të rinj të mollëve të Zdojanit e Kastriotit, në bisedat e paharrueshme në Brezhdan-Zdojan, Peshkopi, Dovolan, Zerqan etj. jep porosinë "Mos lini kodër pa mbjellë me pemë frutore...Brenda 4-5 vjetësh të gjitha kodrat e bukura të rrethit tuaj ti mbushni me pemë frutore"

Blloqet e bukur frutorë, plantacionet e mëdhenj me mollë, kumbulla, qershi, vishnje etj., etj. në Dibër përbëjnë një monument tjetër madhështorë të dorës punëtore të dibranit. Për këtë moment ka vend për të folur gjatë, për të sotmen dhe perspektivën...

Në përmasat e zhvillimit të pemëtarisë në Dibër po mjaftohemi këtë radhë me një kuriozitet: Sikur pemët frutore të mbjella në blloqe në Dibër ti vinim në radhë në distancat e mbjella në fakt, me to do të formohej gjatë tërë perimetrit të Shqipërisë një kurorë me lule në pranverë, me gjelbërim e fruta në verë e vjeshtë prej 8-9 radhësh...

Vitet '60-të janë vite të një pune sulmuese në të dy monumentet, në të dy veprat e artit, në atë për ujitjen e Dibrës dhe për shndërrimin e kodrave në blloqe të bukur me pemë frutore. Aksioni njeh ngjitjen në lartësi. Kanali i Setës, çarja e Gjallicës së famshme të Lurës, përbën një kthesë në ndërtim. Bëhet realitet një ëndërr e madhe: ujërat e Setës i ngjiten Çidhnës, rrjedhin drejt Dardhës e Reçit, zbresin e ngjiten drejt Sinës, zbresin e me sifon ngjiten në anën tjetër të Drinit; në Fushë-Çidhën, Kastriot e Vakuf...

Edhe sot po të shkosh anës kanalit të Setës, rrugicës si fije peri që varet pas shkëmbinjve pyet plot habi: "Çfarë njerëzish kanë qenë ata që u varën në këto hone të thella, që çanë malin dhe krijuan këtë vepër ujore, këtë vepër arti në përmasa marramendëse?"

Në gazetën "Bashkimi" të 30 gushtit 1967 shkruhej: "Më 1 mars filloi puna. Uji në bazë të planit duhej ti jepej fshatarëve në vitin 1969, kurse ai filloi të rrjedhë 6 muaj pas fillimit të punimeve, pra dy vjet para afatit"

Komentet janë të tepërta. Megjithatë disa të dhëna të karakterit organizativ e vlen ti themi.

Ishte planifikuar të punohej gjatë tre vjetëve, të hapeshin tre tunele, të punohej në 6 fronte pune. U punua 6 muaj, u hapën 13 tunele, u punua në 26 fronte pune njeri më i vështirë se tjetri...

Në këtë vepër përvoja për ndërtimet e vështira arrin pjekurinë më të lartë. Nxitet dëshira dhe guximi për të ndërmarrë punë të tjera të mëdha. Bën rrugë një formë e re organizimi, aksioni me përqendrim forcash, lind e merr rrugë ajo që dy vjet më vonë do të jepte frytet në shndërrimin e "hapit në kilometër e të orës në minutë".

Aksioni i 14 dhjetorit 1969, aksion i lidhur me ardhjen e Enver Hoxhës më 14 dhjetor 1967 në dimrin e ashpër dhe në tërmetin shkatërrues të 30 nëntorit 1967, aksion në të cilin morën pjesë 12.000 vetë dhe brenda 8 orëve hapën 17 kilometra kanal, nga Fushë Çidhna në Vakuf, formon bazën e aksioneve me goditje të përqendruar. Porosia : "Aksioni i madh i kohëve të fundit i realizuar me sukses nga populli dibran duhet të bëhet shembull për të gjithë vendin..."

Dibra në ndërtimin e veprave ujore nuk njeh periudhë qetësie. Brezit të vjetër të ndërtuesve të veprave ujore me në krye Gani Tuçepin, inxhinier popullor, Heroi i Punës Socialiste, njeriu që jetoi mbi një shekull dhe punoi në ndërtimin e veprave ujore mbi 80 vjet i shtohet një brez tjetër, një inxhinier tjetër popullor, Beqir Kalia, lauruar me Çmimin e Republikës të shkallës së parë për ndërtimin në mënyrë krijuese të kanalit të Setës. Gani Tuçepi dhe Beqir Kalia nuk mbaruan ndonjë shkollë të lartë. Ata përvetësuan përvojën e shkollës së madhe popullore për ndërtimin duke e ngjitur atë në nivelin e arritjeve bashkëkohore. Veglat e piketimit të Gani Tuçepit ishin të thjeshta – pe plumbçi i muratorit, nivela e ujit, zhalonët dhe pushka. Kanalin e Setës, piketën mbi një shkëmb të paarritshëm Gani Tuçepi e ka hedhë me plumb. Niveloi mirë thepin, shënjestrën dhe nivelën e ujit tek burimi i Setës, qëllo me pushkë dhe aty ku ra plumbi u vendos piketa dhe kaloi kanali ujitës.

Brezit të ndërtuesve popullorë të veprave ujore i është shtuar sot një brez i përgatitur mirë, i shkolluar dhe i pajisur me mjetet bashkëkohore të ndërtimit të veprave ujore. Në Dibër janë ngritur dy ndërmarrje, Drejtoria e Ujërave dhe Sistemimeve dhe ndërmarrja e Bonifikimit të cilat duke ngritur në një shkallë më të lartë traditën po punojnë për ndërtimin e veprave të reja në të gjithë rrethin.

Vitet '70-të janë vite të ndërtimit të shumë ujëmbledhësve, të vegjël e të mëdhenj, vite të instalimit të stacioneve të pompimit me bazë ujërat e Drinit dhe burimeve të tjerë. Nga viti 1976 deri në vitin 1980 u ndërtuan 7 stacione pompimi të cilët rritën sipërfaqen nën ujë edhe me 470 hektarë dhe e përmirësuan atë në 170 hektarë. Sipas studimit, deri në vitin 1990 do të ndërtohen 27 stacione pompimi me një vlerë në ndërtim prej 5.670.000 lekësh dhe me një shtesë në sipërfaqe prej 1610 hektarësh.

Në vitet '80-të krahas ndërtimit të kanaleve të rinj të mëdhenj ujitës si ai "Ura e Qytetit- Boçevë, "Kovashicë-Maqellarë" etj. nisi aksioni për ndërtimin e veprave ujore me bazë liqenet tektonikë akullnajorë.

Së pari u guxua në shfrytëzimin e liqeneve të Kacnisë, liqene tektonikë akullnajorë që shtrihen në 1600-1800 metra mbi nivelin e detit, liqene po aq të bukur sa edhe liqenet e famshme të Lurës. Me disa punime, kryesisht çarje e ngritje dige, liqenet u kthyen në ujëmbledhës të komanduar, në burime me vlerë për ujitjen e tokave të Selishtës, Zogjejt dhe Luznisë, të tokave në lartësi të këtyre kooperativave. Kanali që lidhet me këto liqene, kanal i veshur i tëri me pllaka betoni, do të kryejë dy funksione, do të ujisë 400 hektarë të këtyre kooperativave gjatë verës dhe do të ushqejë ujëmbledhësin e Bllacës gjatë tre stinëve të tjera.. Gjatë rrugës kanali ka disa rënie të forta që do të shfrytëzohen për ndërtimin e hidrocentraleve të shfrytëzueshëm gjatë gjithë vitit. Vepra ujore e Liqeneve të Kacnisë përbën një kompleks hidroenergjetik. Fillon me liqenet e Kacnisë, krijon gjatë rrugës mundësi për të dhënë dritë dhe bukë, depoziton ujëra në ujëmbledhësin e madh të Bllacës, ujëmbledhës i cili me një sistem kanalesh e sifonesh kalon në anën tjetër të Drinit ku shfrytëzohet për ujitjen e tokave të Dovolanit e Maqellarës me rrjedhje të lirë dhe të bllokut frutor të Qenokut të Ndërmarrjes Bujqësore me ngritje mekanike. Kjo është një ndër veprat që e përshkon rrethin nga kufiri me Matin në kufirin shtetëror.

Liqeni i Zi i Valikardhës është si edhe liqenet e tjerë të Dibrës një liqen me origjinë tektonike-akullnajore. Është liqeni më i madh dhe më i thellë në rrethin e Dibrës. Ka një sipërfaqe 22 hektarë dhe një thellësi 60 metra. Grumbullon në vetvete 6 milionë metra kub ujë. Për ujitjen e tokave të zonës Zerqan, Strikçan, Ostren etj. do të shfrytëzohen mbi 3 milionë metra kub ujë.

Për ndërtimin e veprës ujore me bazë liqenet e Tërnovës janë bërë mbi 10 milionë lekë investime. Gjatësia e rrjetit kryesor ujitës është 18 kilometra. Kanali është i veshur i tëri me pllaka betoni. Ujiten mbi 600 hektarë. Në këtë vepër është montuar edhe një sifon i madh me gjatësi 3400 metra dhe që duron presione mbi 60 atmosferë.

Fjala "Gollobordë" do të thotë "tokë e thatë", "tokë e zhveshur". Me kompleksin e gjerë të veprave ujore, me kanalet dhe ujëmbledhësit, me stacionet e pompimit dhe kompleksit për ujitjen në formë shiu të fushës së Klenjës ku kultivohet patatja dhe është ngritur një stacion me rëndësi për studimin dhe prodhimin e farërave të patates me gjeneracion të lartë, Golloborda e zhveshur dhe e thatë është kthyer në një zonë të veshur dhe të begatë. Ajo kërkesa e radoveshasëve për 50 kuintal çimento është në kufirin e legjendës...

Tani e kanë radhën liqenet e Lurës. Uji i tyre që për shekuj ka kapërcyer pasqyrën ujore ku aq bukur pasqyrohet gjelbërimi i pishave dhe bardhësia e dëborës, ka rrjedhur tatëpjetë malit për të mbushur Setën dhe Mallën, dy degë të Drinit të Zi, tashmë do të marrë tjetër drejtim. Do të rrjedhë nëpër 35 kilometra kanale kryesore për të ujitur mbi 500 hektarë toka të lartësive të mëdha të zonës së Lurës, Reçit, Dardhës e Çidhnës. Liqenet do ta ruajnë të plotë bukurinë natyrore. Në funksion të ndërtimit të veprës do të ngrihen brenda Parkut Kombëtar edhe liqene të rinj që do të jenë të bukur si edhe liqenet natyrorë. Liqenet e Lurës do tu ofrojnë njerëzve edhe bukurinë edhe begatinë e tyre.

Hapat për ndërtimin e veprave ujore vazhdojnë ngjitjen. Në vitin e ardhshëm ata do të ngjiten në Gramë, në ballë të Korabit ku ujëmbledhësit ekzistues parashikohet ti rritet diga, të ndërtohen edhe ujëmbledhës të rinj uji i të cilëve do të kapërcejë male dhe do të ujisë tokat e Zimurit, Shimçanit, Cerjanit, Bellovës, Zagradit, Rabdishtit etj., toka që aktualisht janë prodhuese patatesh dhe në të ardhmen do të shndërrohen në hambarë, në toka të rendimenteve të larta në këtë kulturë. Rruga drejt veprave të reja ngjitet edhe në liqeneve të Bulqizës për ta shndërruar bukurinë e tyre në pjellori për këtë zonë.

Rruga zbret edhe poshtë, në burimet e reja, zbret edhe në ujërat e Drinit, në stacionet e rinj të pompimit. Kalon mes blloqeve të sotëm dhe mes blloqeve të ardhshëm frutorë.

Dy monumentet e mëdhenj, Veprat Ujore dhe Blloqet e Mëdhenj Frutorë, Gjigandi i Gjelbërt siç quhet, janë vepra të shquara arti popullore. Popullit të Dibrës i ka takuar dhe i takon të derdhë në këto vepra artin e vet, shpirtin prej artisti, dashurinë për punën.

Abdurahim Ashiku
Peshkopi 3 dhjetor 1987

histori

Ramadan Islami nuk doli nga legjenda, por doli nga populli trim dhe liridashës i Dardhës e me gjashtë plagë në trup ngrihet si shqiponjë e qëllon mbi oficerin serb.

"Gjergj Elez Alia i Dardhës"

Nga **Shaqir SKARRA**

Në Dibër dhe jashtë sinorit të saj, besoj se nuk ka mbetur njeri pa dëgjuar e lexuar për Kodrën e Shkekës në Shumbat ose siç njihet ndryshe në popull si Kodra e Istikameve. E tashmë Kodra e Shkekës ka filluar të flasë...

Ajo kodër që mbart dhe fsheh historinë jo vetëm të Shumbatit, por të gjithë Dibrës, e sot këtu na ka mbetur thjeshtë një toponim "Kalaja e Bukadollit" por pa e ditur as vetë se çfarë fsheh e ruan poshtë nëntoka e saj.

Kodra e Shkekës është një kodër mjaft dominuese për të gjithë Shumbatin, ku nga të gjitha anët e ke si në pëllëmbë të dorës Çidhnën matanë Drinit, Korabin, zonën e Dardhës e Reçit e deri në Lurën me bukuritë e saj.

Kjo kodër ka parë shumë e ende mbetet një muze i atyre kohrave të shkuara, por që gjurmët e historisë tonë komnbëtare kanë mbetur ende në kujtesën e të gjithëve.

Sot jo vetëm armë, predha e gjyle topi por po të gërmosh gjen varre, varre të shumta që armiku la kokën në këtë kodër të bukur të Shumbatit. E, nëse historia ka qëndruar më së shumti memece, është vetë kjo kodër që vitet e fundit ka filluar të flasë e të tregojë çka parë ato vite të zjarrta lufte ku gjaku skuqi edhe gjelbërimin e saj.Ishte pikërisht ky shekull, ky njëqind vjetor i luftës së përgjakshme dibrane kundër hordhive të shumta serbe ku Kodra e Shkekës nisi të flasë e të thotë të vërtetën midis fakteve. Në këtë kodër janë ndeshur romakët me ilirët,më vonë osmanët me shqiptarët. Për luftën e gjatë anti serbe kjo kodër është dëshmitare e vetme, që nëpërmjet fakteve, të dhënave, folklorit, historisë por edhe gjetjeve tregon shumë, e nëse historia ka qëndruar deri diku memece , tashmë kodra e Shkekës ka filluar të tregojë vetë për ato dtë të vështira e lufte të përgjakshme ku forcat e shumta mirë organizuara serbe u ndeshën me forcat vullnetare dibrane.

...Ishte 15 gusht e vitit 1920. Në Shumbat lufta ishte ndezur e ashpër. Korabi vështronte fushë betejën, por madhështia e tij nuk mund ta pengonte, ta ndërpriste dhe ta ndalonte luftën...

Pas një beteje të gjatë dhe të përgjakshme, pamvarsisht numrit të madh të ushtarëve serbë dhe armatimit të bollshëm të tyre, ushtria serbe u thye, u shpartallua.

Në fushë betejë, ushtarë dhe oficerë serbë të vrarë, armatim dhe municion i hedhur dhe braktisur, ushtarë pa komandantë dhe kuaj pa kalorës... Sigurisht, edhe disa luftëtarë dibranë derdhën gjak. Ranë në fushën e betejës për të mbetur përjetësisht dëshmorë të atdheut, të lirisë.

Ramadan Islami nga Lashkiza e Dardhës plagoset rëndë, jo njëherë por gjashtë herë, gjashtë plagë dhe si zgalem qëndronte në llogore me armë në dorë. I thoshte shpesh herë Isuf Xhelili:"Kujdes o djali i Lashkizës se plumbi të kap shpejt ty se je dy pëllëmbë më i gjatë se sa unë".

Ushtarët serbë, ato që kishin mbetur gjallë, të ç'orientuar tashmë e pa komandantë iknin nga sytë këmbët, kërkonin të shpëtonin kohën.

Disa u ngjitën Grykës së Gramës e disa pasi kaluan Shumbatin të trembur u ngjitën në Venisht e Sllatinë për tu bashkuar me shokët e tyre dhe kaluar matanë kufirin. Të çakorduar të gjithë për atë që panë me sy dhe përjetuan vetë duke lënë shokët por dhe komandantët e tyre të vrarë në Kodrën e Shkekës..

Ishte pasdite vonë, dielli ishte në zenit dhe luftës po i vinte fundi. Një oficer madhor edhe sipër kalit tek po largohej pas ushtarëve në panik qëllonte, qëllonte vazhdimisht në drejtim të forcave vullnetare.

Ramadan Islami kishte një fizik të veçantë në të gjithë krahinën e Dardhës. Ishte i gjatë në trup, zeshkan në fytyrë, me mustaqe të zeza që me shikimin e parë të krijonte pamjen e një burri të guximshëm dhe trimi të rrallë. Karakteristike kishte një dorë të fuqishme me gishta të gjatë. I veshur me kostum kombëtar të gjalishnajkut, dhe një qystek sahati sermi me tre levar.

Ramadan Islami (Çerpja) nga Lashkiza e Dardhës e pikasi se nga vërshëllonin këto plumba dhe pse vetë kishte marrë gjashtë plagë, e plagët i kullonin gjak mori nishan dhe për herë të parë qëllon drejt mbi oficerin serb. Ra në tokë sa gjërë e gjatë duke bërtitur në gjuhën e tij. Fjalët e fundit i shpërndau lugina tej e tej. I dëgjuan të gjithë. I dëgjuan edhe ushtarët e tij që vraponin Grykës së Gramës por nuk ktheu kush pas me i dhënë ndihmë komandantit, sejcili kërkonte të shpëtonte kokën .

Luftës i kishte ardhur fundi, fitorja u qeshi forcave vullnetare dibrane. Ishte vonë pasdite e Kodra e Shkekës u brakis nga të gjithë.

Gjakun e malsorëve dibranë e thithi toka e zhuritur e Shumbatit, toka jonë e etur për liri, e zhuritur nga zjarri dhe flakët e luftës, ndërsa gjakun e pushtuesve serbë , toka jonë nuk e thithte, sepse nuk e prananonte gjakun e huaj, gjak pushtuesi por e mblidhnin dhe e tërhiqnin përrenjtë, që së bashku me llumrat e tyre ti çonin larg, shumë larg, sa më larg, ti përmbyllte si histori të trishtë Drini i Zi dhe ta mbyllte epokën e tyre në det.

Kali i oficerit serb të vrarë nga Ramadan Islami (Çerpja) vraponte dhe hingëllinte në fushën e betejës. Ndoshta kërkonte kalorsin, të zotin e vet apo bënte dhe apelin e ushtarëve dhe oficerëve të vrarë të cilët kishin mbetur përrenjëve, shkurreve, gjerdheve e porenëve me ferra, arave djerrë të kthyera në livadhe.

Kali hingëllinte por askush nuk i përgjigjej sepse ushtria ishte shpartalluar. Me plagët që i kullonin gjak Ramadan Islami tamam si Gjergj Elez Alia i legjendës që me plagë në trup u ngrit nga shtrati që lëngonte dhe fitoi luftën me bajlozin e detit, u hodh mbi kalin e oficerit serb që vrau vetë.

Dhe pasi i hodhi një vështrim përmallues fushës së Shumbatit mori rrugën për në Dardhë. Plagët i kullonin gjak dhe gjaku i tij njomëte, lagte dhe skuqte kalin, rrugën nga po ecte. Pasi kaluan Drinin, Ramadan Islami me gjashtë plagë mbi kalë dhe burrat që e shoqëronin vazhduan rrugën lart për në Lashkizë. Të tjera beteja e prisnin trimin e Lashkizës.

Jo pak por iu deshën shtatë-tetë muaj ti mbylleshin plagët e shumta, të përgaditej për të tjera beteja.Ushtria serbe e mirë organizuar vazhdonte mësymje kundër trojeve tona Mesymjet serbe vazhdonin .... djegja e shtëpive në pranverën e 1921e dëmtoi shumë zonën. Shtëpitë dhe kullat ishin djegë dhe braktisur.

Mësymja serbe ishte shumë e egër. Beteja e Qafë-Gëlqeres është një tjetër betejë e ashpër e forcave vullnetare kundër ushtrisë serbe.

Marka Gjoni bëri një marrëveshje të fshehtë me klikën e Beogradit, marrëveshje në dëm të trojeve shqiptare.

Qeveria e drejtuar nga Iljaz Pashë Vrioni dhe ministër i mbrojtjes Salahudin Shkoza urdhëruan një mesymje kundër kësaj marreveshje të fshehtë e në kurriz të popullit shqiptar, ku do të sulmonin forcat e Mirditës që ishin pro Jugosllavisë.

Nga krahina e Dibres u caktuan tre krahina që do të merrnin pjesë në këtë mësymje.

- Forcat e Lurës të komanduara nga bajraktari Muharrem Mena .

- Forcat e Dardhës dhe Reçit nën komandën e Ramadan Islamit me Halim Shehun.

Ishte fundi i Qershorit 1921. Forcat e Dardhës e Reçit u bashkuan në Lurë me Muharrem Menën dhe forcat vullnetare të Lurës. Natën e kaluan të ndarë në grupe nëpër familjet e Krej- Lurës dhe Mërkurthit të Mirditës. Ramadani me disa trima kaloi natën tek një kullë e njohur në Mërkurth ku aty zot shtëpie ishte një plakë e moshuar por shumë burrëreshë e quajtur Dava e Ndue Markut.

Gjithë natën e kaluan me muhabet. Plaka mirditore burrneshë shpërndante duhan dhe mbante oxhakun e ndezur mirë që mysafirët e lirisë të mos kishin të ftoftë.

Të nesërmen në Orosh të Mirditës. Shkallgjani ishte stacioni i fundit i jetës për Ramadanin. Istikame nën tokë kishin ba ata. Filloi lufta dhe mësymja.... mbi dy orë luftime...humbje të mëdha pësuan pro serbët.... Në këtë mësymje u vra një nga djemtë e Lurës. U plagos rëndë edhe Halim Shehu. Në krah të Ramadanit ishin Rrahman Rasha, Imer Topuzi e Xhemal Mera.

Pas përleshjeve dhe thirrjes "a besa besë", Ramadani është hedhur mbi istikamet e armikut gati në përleshje trup me trup deri sa një plumb i zi e merr në ballë...

Vendosi dorën e majtë në ballë dhe e hoqi kur e pa se dora iu lag nga gjaku që vazhdonte të dilte pa pushim . Lëshoi një piskamë të fuqishme ... " mos e kurseni jetën për lirinë" dhe u rrezua si një lis .Ramadan Islami e mbylli jetën e tij në mënyrë heroike duke lënë pas një djalë të vogël vetëm tetë vjeç. "Ra heroikisht si në luftrat e mitologjisë Homeriane- do ta cilësonte historiani Bajram Xhafa në sesionin shkencor me rastin e 100 vjetorit të luftës së dibranëve anti serbe që u mbajt në Akademinë e Shkencave më datë 20/12/2021, në Tiranë.

Po kush është Ramadan Islami (Çerpja), ky hero i asaj lufte të gjatë, të madhe disa vjeçare që edhe pse pas kaq vitesh tek ne vjen si nëpërmjet legjendës?

Ramadan Islami nuk doli nga legjenda por doli nga populli trim dhe liridashës i Dardhës e me gjashtë plagë në trup ngrihet si shqiponjë e qëllon mbi oficerin serb.

Historia nuk e tha tamam të vërtetën, heshti për kaq vite, por plagët e marra në këtë betejë, të rënët, gjaku i derdhur, kjo kodër që u fut në histori si kodra e istikameve nuk heshtin, tregojnë të vërtetën se çfarë ndodhi në atë ditë gushti të vitit 1920.

Lindi në Lashkizë në vitin 1880. Ishte i biri i Islam Adullahut dhe Kade Xhedikes (nip i Isuf Xhedikut). Që në moshë të re mori drejtimin e familjes pas vdekjes së

Ramadan Islami nga Lashkiza e Dardhës plagoset rëndë, jo njëherë por gjashtë herë, gjashtë plagë dhe si zgalem qëndronte në llogore me armë në dorë. I thoshte shpesh herë Isuf Xhelili:"Kujdes o djali i Lashkizës se plumbi të kap shpejt ty se je dy pëllëmbë më i gjatë se sa unë". Ushtarët serbë, ata që kishin mbetur gjallë, të çorientuar tashmë e pa komandantë iknin nga sytë këmbët..

vëllait të parë ushtar në Turqi Man Islamit. Ai kishte dhe tre vëllezër më të vegjël dhe dy prindërit në moshë të thyer. Sipas thënjeve dhe përshkrimit të bashkëmoshatarit (Imer Topuzi)... Ramadani kishte një fizik të veçantë në të gjithë krahinën e Dardhës. Ishte i gjatë në trup, zeshkan në fytyrë, me mustaqe të zeza që me shikimin e parë të krijonte pamjen e një burri të guximshëm dhe trimi të rrallë. Karakteristike kishte një dorë të fuqishme me gishta të gjatë. I veshur me kostum kombëtar të gjalishnajkut, dhe një qystek sahati sermi me tre levar. Në vitin 1900 u ngjit nga Lashkiza në Zhugjërr, pikërisht aty tek kalaja mesjetare, ku ndërtoj kullën e parë dy kateshe me sharishane...dhe brenda dy vitesh kullat u shtuan nga kusherinjt e vet duke krijuar kështu lagjen Zhugjerr. Për trimin, heroin Ramadan Islami, edhe pse historia nuk na tregoi tamam heroizmin e tij, poeti Naim Plaku na e solli në vargje:

1

"O moj Dardha maj mbi shkrepa,
Në troje t'veta rritet Çerpja.
Ku je kulla me nishana?
Le e rrit ke tre "Osmana"
Le e rrit ke tre Osmana"
Vjen haberi e ndez konakun,
A po e njeh moj kullë oxhakun
Brez pas brezi o ka rrit trima
O jep e merr selam gjithë Dibra.
Po i çon Shkodra selam Dardhës
Më ka ardh hasmi n' prag të Rozafës,
Më ka shkel hasmi në konak
Sot po më lypset nji grusht gjak.
Çerpja i Dardhës o në tabe të parë,
Luftë me krajla e pashallarë,
Mbaje lart burrnin e fisit
O e ke varrin në fushë te Nishit.
Në kodër të Shkekës pa zbardh drita,
Luftë të madhe ka nis Dibra
Kush është ai bajrak i gjallë
O me gjashtë plagë qëndron në kamë.
Nga Korabi n' Orosh të Mirditës
Heu të lumt pushka o trimi i Dibrës,
Hej n' t' katër anët o ka shku zani,
O jo nuk vdes Ramadan Islami.
Besa besë për troje t' veta
Pushka top Ramadan Çerpja
Unë jam Çerpja i Lashkizës
Nuk ja heq mejdanin Dibrës.

REFERENCA:

"Lufta e Dibrës 1920" Bajram Xhafa.
"Borxhin ta ktheva vendlindje" Shaqir Skarra.
"Xhelal Çerpja, diamant i kulturës dibrane" Shaqir Çerpja.
Të dhëna gojore nga Kujtim Çerpja.

Me datë 15 prill 2022 iu dha lamtumira e fundit në parajsën e merituar shokut e mikut tonë Lutfiut Hanku!

Lamtumirë miku e shoku ynë **Lutfi Hanku!**

Nga **Bashkim LAMI**

Lamtumirë miku e shoku ynë Lutfi Hanku! Do të kujtojmë me shumë respekt e dashuri, ashtu siç ishe i mençur e i dashur.

Me datë 15 prill 2022 iu dha lamtumira e fundit për rrugëtimin e shpirtit të tij në parajsën e merituar shokut e mikut tonë Lutfiut, i cili kohët e fundit u mundua nga sëmundja deri sa ndaloi rrahjet zemra e tij, duke na hidhëruar, por jeta e tij ishte e mbushur me dashuri e aktivitete si rrallëkush për të mos u harruar.


Lutfi Hanku lindi në Zerqan të Dibrës më 1933 nga një familje e mesme, patriotike me besim bektashian. Babai i tij Sabriu dhe e ëma vdiqën të rinj dhe Lutfiu u rrit jetim në gjirin e familjes patriotike "Hanku". Mësimet e para i mbaroi në vendlindje. U aktivizua si pionier në luftën kundër pushtuesit italo -gjerman. Mbas çlirimit të atdheut vazhdoi studimet në Normale të Elbasanit dhe Uniken në Peshkopi. Më 1948-1952 ndoqi shkollën pedagogjike në Peshkopi bashkë me 16 moshatarë të tij dhe vitin e fundit të pedagogjikes e mbaroi në Shkodër.

E filloi punën me përkushtim si mësues në shkollën 7-vjeçare të sapokrijuar për punëtorët në Bulqizë, më pas vazhdoi në Kastriot, në Zerqan dhe në pak kohë si inspektor arsimi. Më 1956-1960 mbaroi Universitetin Shtetëror të Tiranës, fakultetin Histori-Filologji. Nga viti 1960-1992, mësues i gjuhës shqipe në shkollat e mesme të qytetit të Peshkopisë, ku nuk u shkëput për asnjë çast nga detyra e nderuar e mësuesit. Ai ka punuar shumë vite në Shkollën e mesme Pedagogjike dhe të mesmen bujqësore, më pas në Gjimnazin e Peshkopisë deri sa doli në pension.

Lutfiu ndjente kënaqësi kur në rrugë e ndalonin mjaft njerëz dhe e përshëndesnin duke i thënë me shumë dashuri e respekt: "Profesor, kemi qenë nxënësit e tu. Kështu i ka ndodhur dhe me emra të njohur si Shaban Sinani, Lirie Rasha, Naim Çorja, Lavdrim Shehu e Gjelosh Gjoni, etj. Ai i kujtonte me shumë dashuri e respekt të gjithë shokët e kolegët e tij në vite dhe në biseda tregonte episode të bukura të bashkëpunimit ku shpaloste me shumë dashuri vlerat më pozitive të tyre, si pjesë e pandarë e jetës së tij.

Lutfi Hanku ishte dhe mbeti deri në fund të jetës praktikant e besimtar i devotshëm dhe përhapës i besimit të paqtë bektashian. Në veprat e tij letrare e publicistike, si "Drita e shpirtit" "Marsi i vrare", "Erdhi Caushi", "Loti rebel", bektashizmi, zë një vend të rëndësishëm.

Lutfiu ishte mësues i talentuar në klasë dhe ka drejtuar rrethet letrare të shkollave, bib-





Lutfi Hanku me krijimtarinë e tij botoi më 1974 "Nëpër gjurmët e heroit" dhe më 1980 e ribotoi me titullin "Nazmi Rushiti". Në vitin 2000 botoi librin "Kaçaku", më 2003 "Drita e shpirtit". Më 2006 romanin "Erdhi Caushi", më 2009 "Marsi i vrarë" (vepër historiko-letrare). Është gjithashtu redaktor në shumë libra të krijuesve dibranë dhe i artikujve të shumtë në gazeta e revista si tek "Rruga e Arbërit", "Gazeta Bulqiza", "Drita", "Nëntori", "Ushtima e Maleve", "Gazeta Dibra", etj.

Lutfi Hanku ka qenë qysh më 1975 anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Ai është dekoruar dy herë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, vlerësuar tri herë me dëshminë "Mirënjohja e kombit", vlerësuar nga Këshilli Bashkisë Bulqizë "Qytetar Nderi".

liotekat dhe aktivitetet shkencore, kulturore e artistike. Është vlerësuar në konkurrimet kombëtare për drama, ansamble artistike dhe estrada me medalje nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës.

Botimet e para nisin qysh në vitin 1953, atëherë sapo kishte dalë nga bangat e shkollës pedagogjike. Gjatë viteve ka botuar në shtypin monist përshkrime, skica letrare, tregime, monografi të shkurtra historiko -letrare dhe në përmbledhje me shumë autorë, në gazeta e revista të sistemit monist dhe pluralist. Ka drejtuar ca kohë gazetën "Dibra" ku ka bashkëpunuar me gazetarët Velo Cfarku, Fatos Daci, Kamber Farruku, Garip Troci, etj. Në TVSH janë shfaqur tre telefilma për heronjtë e Dibrës ku autor skenari ka qenë Lutfi Hanku.

Lutfi Hanku nuk mund të qëndronte vetëm brenda për brenda kornizave të klasave, aty ku jepte mësim. Shpirti i tij prej krijuesi premtonte për më shumë. Lutfiun e ndiqte nga pas kudo një "hije" që i pati lënduar shpirtin, por ai kurrë nuk u dorëzua. Punoi fort në rrugën e krijimtarisë dhe i ka dhënë lexuesve libra me vlera, ku del në pah stili i tij i veçantë me përshkrime brilante të personazheve realë të historisë e të jetës plot brenga e sakrifica. Forca krijuese, gjuha mjaft e pasur që përdor, faktet, kronikat dhe legjendat e bëjnë prozën e Lutfi Hankut më të pranueshme për lexuesin e gjerë shqiptar.

Lutfi Hanku me krijimtarinë e tij botoi më 1974 "Nëpër gjurmët e heroit" dhe më 1980 e ribotoi me titullin "Nazmi Rushiti". Në vitin 2000 botoi librin "Kaçaku", më 2003 "Drita e shpirtit". Më 2006 romanin "Erdhi Caushi", më 2009 "Marsi i vrarë" (vepër historiko-letrare). Është gjithashtu redaktor në shumë libra të krijuesve dibranë dhe i artikujve të shumtë në gazeta e revista si tek "Rruga e Arbërit", "Gazeta Bulqiza", "Drita", "Nëntori", "Ushtima e Maleve", "Gazeta Dibra",etj.

Lutfi Hanku ka qenë qysh më 1975 anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Ai është dekoruar dy herë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, vlerësuar tri herë me dëshminë "Mirënjohja e kombit", vlerësuar nga Këshilli Bashkisë Bulqizë "Qytetar Nderi".

Në vitin 1991 Lutfiu mbështeti pa rezerva ndryshimet demokratike ne qytetin e Peshkopisë ku jetonte dhe dha kontributin e tij ne bashkëpunim me koleget Safet Zhulali, Spartak Topollaj, Mirush Mati, Bexhet Shehu, Gjyzel Hasani, Kamber Farruku, etj. Me krijimin në vitin 2015 të "Shoqatës Bulqiza" Lutfi Hanku u zgjodh President i kësaj shoqate ku për kontributin e tij të çmuar për aktivitetet e shoqatës dhe për ecurinë e botimit të gazetës "Bulqiza" profesor Lutfi Hanku është nderuar me titullin "Nderi i Shoqatës Bulqiza". Lutfi Hanku kudo punoj e jetoj me urtësi e dashuri, që do të mbahet mend në shumë breza.

Lutfiu ishte krenar për familjen e tij, për dy vajzat mësuese Kozeta dhe Amarda, për nipërit e mbesat, që i qëndruan pranë dhe e mbështetën me shumë dashuri në jetën e tij modeste në Peshkopi dhe në Tiranë. Sëmundja dhe problemet e moshës e munduan Lutfiun, që na mungoi në tavolina e aktivitete këto dy vitet e fundit, por urtësinë e mençurinë e tij i kemi në mendjet e miqve të tij të shumtë.

Ndarja e tij nga jeta është një humbje e madhe për familjen, të afërmit e shokët e tij. Kryesia e "Shoqatës Bulqiza" shpreh ngushëllime familjes, të afërmve dhe shokëve të Lutfiut. Shpirti i tij u prehtë i qetë në parajsën e merituar! Puna dhe vepra e tij mbeten të paharruara në mendjet dhe zemrat e të gjithë atyre që e njohën e punuan me këtë njeri që do të na mungojë por që do ta kujtojmë me shumë dashuri e respekt për veprat e kujtimet e bukura që ka lënë.

Lamtumirë miku e shoku ynë Lutfi Hanku! Do të kujtojmë me shumë respekt e dashuri ashtu siç ishe i mençur e i dashur. Kozeta dhe Amarda e ju nipërit e mbesat që e deshët aq shumë, Zoti ju dhëntë durim të tejkaloni dhimbjen!

Shpirti i tij u prehtë i qetë në parajsë dhe i qoftë dheu i lehtë! Të rrojnë e ta kujtojnë familja, të afërmit dhe të gjithë miqtë e tij.

15.4.2022

Homazh për mësuesin Kujtesë
HAJRI ILMI BARUTI



Me datën 18 prill 2022 pas një sëmundje të rëndë e të pashërueshme ndërroi jetë kolegu dhe miku ynë, mësuesi Hajri Ilmi Baruti.

Hajriu lindi në Grevë në vitin 1946 në një familje patriotike. Arsimin fillor dhe shtatëvjeçar e mbaroi në fshatin e lindjes. Arsimimin e vazhdoi më tej duke mbaruar shkollën e mesme pedagogjike në Shkodër

Punën si mësues e filloi në vitin 1964 në shkollën Bahute ku punoi për 3 vjet.Pasi kryen shërbimin ushtarak në vitet 1967-1969, rifillon mësimdhënien në fshatin Trepç për shtatë vjet (1970-1977).Në vitin 1977-1980, Hajriun e transferojnë si mësues në Tuçep. Nga viti 1980-2011 e gjejmë si mësues dhe përgjegjës i ciklit ulët në fshatin Erebarë.

Mësues Hajriu punoi dhe kotribuoi në fushën e arsimit të fëmijëve plot 45 vjet. U pensioua në vitin 2011. Në vitin 1994,për punë të mirë e përkushtim në fushën e arsimit, për rezultate shumë të mira në proçesin mësimor- edukativ, Hajriu është dekoruar me medaljen "Naim Frashëri".

Mësues Hajriu është dalluar si një mësimdhënës korrekt,punëtor, dashamirës dhe i afërt me nxënësit.Gjithmonë dallohej për marrëdhënie të mira e korrekte që mbante me prindërit e nxënësve dhe komunitetin.

Jeta e tij u shua. Ai u nis drejt amshimit, duke lënë në hidhërim të thellë familjen, kolegët, miqtë dhe nxënësit e tij të shumtë. Gjithsesi, humbja e njeriut të afërt e të dashur le një boshllëk të madh në komunitet, në shoqëri e sidomos në familje. Iku duke lënë në pikëllim bashkëshorten Shpëtimen,vajzat:Valin dhe Lubin, djemtë: Hynorin,Nardin, Fasliun, nipërit dhe mbesat.

Hajriu gjithmonë të përshëndeste i pari dhe të përcillte me buzëqeshje. Ishte i afrueshëm, i dashur, gjithmonë i gatshëm për të bërë gjithçka për të të ndihmuar. Kontributi i Hajriut për arsimimin e fëmijëve dhe përkushtimi i tij në punë ishte shembullore dhe si i tillë gjithmonë do të mbahet në mend.

Mësues Hajriu do t'i mungojë jo vetëm familjes, por edhe ne ish kolegëve e shokëve e në veçanti nxënësve të shumtë të cilët i mësoi dhe i edukoi ndër vite.

Hajriu ndërroi jetë, por Ai do të jetojë përherë në zemrat e të gjithë atyre që e njohën dhe që ju shërbeu.

Familja dhe miqtë janë krenarë për jetën dhe punën e përkushtuar të mësuesit të palodhur, për kontributin dhe ndihmesën që ka dhënë ndër vite në fushën e arsimit.

Sa shumë njerëz e deshën dhe e respektuan. Këtë e tregoi pjesëmarrja e shumtë në ngushëllime dhe në ceremoninë e varrimit. Nderimin dhe respektin ia bënë jo vetëm të afërmit, miqtë, kolegët, por edhe shumë ish nxënësit e tij të ardhur nga e gjithë Dibra e Tirana.

Ngushëllimet tona më të thella shkojnë për familjen dhe miqtë. Të pastë dritë shpirti miku dhe bashkëfshatari ynë Hajri!

Respekt jetës, përkushtimit, punës dhe veprës! Qofsh i xhenetit!

I paharruar kujtimi për Ju!

Kolegët, miqtë:

Avni Fida, Esat Bunguri, Maksim Baruti, Etem Fida, Adem Bunguri, Nehat Daci, Behar Hoxha, Lazim Fida, Premtim Kryemadhi, Edmond Keta, Ylber Balliu, Isuf Bunguri, Kadri Bunguri, Elham Baruti, Laugjen Bunguri, Veli Spahiu, Hamza Daci, Ismail Tifeku, Nimet Fida. Kapllan Fida, Lulzim Fida.

Mentor Muça, *një shembull frymëzimi për brezat*

Më 28 janar 2022, ndahet nga jeta Mentor Muça, një nga burrat më të nderuar të krahinës së Gollobordës të plejadës së shekullit XX-të, dibrani i shquar e fisnik që ka mbajtur postet më të larta në organet drejtuese nga viti 1971-1989, si sekretar i Parë i Partisë si edhe kryetar i Komitetit Ekzekutiv në Lezhë. Mentori u nda nga jeta natyralisht në moshën 91-vjeçare, nën kujdesin e ngrohtë të vajzës së tij.

Largimi i tij nga kjo botë pikëlloi në rradhë të parë vajzën e të afërmit e tij, që aq shumë e deshën. La pa fjalë miqtë dhe shokët e shumtë, bashkëfshatarët e tij, dibranët, lezhianët dhe tiranasait që e kanë njohur atë në punë e në jetë, që e njohën si burrë me cilësi të mrekullueshme njerëzore, i dijes e kulturës, i punës e i kuvendit, i fjalës dhe i besës, i drejtë dhe i arsyeshëm, por edhe drejtues i spikatur dhe vendimmarrës dinjitoz, model i thjeshtësisë, dashurisë, mikut, shokut.

Mentori u martua me Vera Nurën, një intelektuale shembullore dibrane dhe bashkëshorte e denjë, që bashkë ia kushtuan jetën vendit e popullit.


Jeta e Mentor Muçës është një histori më vete. Ai u lind në Ostren të Madh, në vitin 1929, në një familje atdhetare shqiptare, me zë ndër miq kudo në zonën e Gollobordës, por edhe në zonat e tjera si në Martanesh, Çermenikë, Zerqan. Në vitet pas luftës së Parë Botërore, kur ende luftohej për kufijtë politik të Shqipërisë, xhaxhai i tij, Ademi, i cili shquhej për patriotizëm, një krye të përfaqësisë së Ostrenit të Madh, që shkuan në Trebisht, me mendimin për të hapur një shkollë shqipe, sikurse përfaqësuesit e fshatrave të tjerë, kurrsesi nuk pranoi kërkesën serbe për të hapur shkollë në gjuhën serbe, veçse në gjuhën shqipe.

Mentori ishte më i vogli nga tre djemtë e Hasan Ahmetit (se kështu vendoseshin mbiemrat atëherë me emrin e të atit) me bashkëshorten nga fisi Duka, Ibrahimi dhe Tufiku. Nëna e la të vogël, vetëm 4 vjeç. Nga babai kishte edhe dy vëllezër të tjerë, Aliun e Fisnikun, dhe një motër, Nafijen. Fëmijërinë e kaloi vendlindje, në Ostren të Madh, ku mori mësimet e para të dijes.

Çlirimi i Dibrës e gjeti në Peshkopi, ndërsa çlirimi i vendit në nënprefekturën e Zerqanit. Vazhdoi veprimtarinë me rininë antifashiste shqiptare në Dibër. Si delegat i Kongresit 1-rë të Bashkimit të Rinisë Antifashiste Shqiptare (BRASH) dhe instruktor i komitetit të rinisë së Nënprefekturës Zerqan, veproi në gjithë krahinën e Gollobordës, por edhe në zona të tjera, për të organizuar rininë për Kongresin e 2-të të BRASH-it, ku morri pjesë edhe vetë në të, në mars 1945.

Në kohën e rindërtimit të vendit, pas Luftës Nacionalçlirimtare, Mentori mblodhi mbi 100 të rinj nga krahina e Gollobordës dhe sëbashku shkonin në mëngjes në Zerqan dhe ktheheshin në darkë në shtëpi në këmbë, rrugë e pa rrugë. Kontribuonin vullnetarisht për rindërtimin, pastrimin e rrugëve dhe fshatrave nga bora etj.

Në vitin 1946 filloi punë në komitetin e partisë dhe më pas u emërua sekretar i dytë i Komitetit të Rinisë së Rrethit. Në 1948 u caktua në komitetin e partisë në Peshkopi. Ishte koha kur Shqipëria u shkëput nga Jugosllavia dhe filloi lufta e hapur kundër titizmit. E kthye për tre muaj në Ostren të Madh për të sqaruar arsyet e ndarjes nga Jugosllavia. Ishte koha kur u punua për forcimin e shtetit. Punë e vështirë në atë kohë. Pas disa kohësh emërohet sekretar i rinisë i Qarkut, detyrë që e kreu deri në vitin 1960. Në periudhën 1961-1965, ka qenë në



funksionin sekretar i Komitetit të Partisë së Rrethit Peshkopi.

Mentori ishte një intelektual i spikatur. Në fillim të viteve 1950, ndjek shkollën e mesme pedagogjike natën në Peshkopi. Në korrik të 1955 shkon në Moskë për të ndjekur Shkollën e Komonuelthit, të cilën e përfundoi në shtator 1956. Kreu studimet në Shkollën e Lartë të Partisë, Tiranë, në vitet 1965-1968, gjatë së cilës u zgjodh sekretar të Komitetit të Partisë të Shkollës. Pas përfundimit të saj emërohet pedagog në atë shkollë.

Nga fundi i vitit 1969, ishte në funksionin sekretar i Komitetit të Partisë të Rrethit Dibër. Më 15 gusht 1971 u emërua sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Lezhës, funksion në cilin qëndroi deri në vitin 1985, kur u emërua kryetar i Komitetit Ekzekutiv të këtij rrethi. Në vitin 1987, përsëri u kthye në funksionin e mëparshëm. Në vitin 1989, shkon në Komitetin Qendror të Partisë, në Tiranë, si instruktor në sektorin e marrëdhënieve me jashtë, deri sa del në pension në vitin 1990.

* * *

Mes bashkëkrahinarëve tanë flitej e flitet për Mentor Muçën me nderim e respekt të lartë. Jo vetëm në krahinën tonë, por kudo që punoi e jetoi Mentor Muça, në Peshkopi, Lezhë apo Tiranë.

Mentori nuk ndjehej mirë të flaste për vete. Ai fliste me admirim për patriotë të vërtetë të përmasave kombëtare të krahinës së Gollobordës, si: Hazis Lila, Elez Koçi e Hoxhë Muglica, por edhe Hysen Matën, Sulejman Matën, Rifat Tolën, Rahman Kasa, Basri Halilin, Mersin Sahitaj, Nexhemedin Zajmi, Ismail Oshafi, Hysni Çelën, Ilmi Sadikaj etj., të cilët me cilësitë e veprimtarinë e tyre e nderojnë Gollobordën dhe mbarë Dibrën.

Mentor Muça ka bërë shumë për Gollobordën e popullsinë e saj, për shtetin shqiptar. Aktivitetin patriotik e ka filluar që në fëmijëri, në vitin 1943, në kuadrin e Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare, që kishte marrë përmasa në Shqipëri. Bashkë me të deleguarin e komitetit të partisë të Zerqanit, Adem Rada, punoi për të aktivizuar dhe krijuar bërthamat e rinisë antifashiste në zonën e Gollobordës. Si sekretar organizativ i komitetit të rinisë antifashiste të zonës, me ndihmën e komandës së vendit në Ostren të Madh, organizoi dhe drejtori lëvizjen antifashiste të rinisë në zonë, duke i shërbyer lirisë së vendit, por kemi mbajtur lartë frymën patriotike e nderin e krahinës.

MENTOR MUÇA: "Po e deshe vendin tënd, ke dashur Shqipërinë. Njeriu duhet ta dojë punën. Kanë filluar ta humbasin dashurinë për punën, por të punojnë këtu, për vendin e tyre. Të kthehen e të punojnë tokat e tyre bashkë me vëllezërit e tyre e të rrojnë së bashku. Ta duan jetën dhe vendin e tyre. Ta duan njëri-tjetrin dhe familjen mbi të gjitha."

Mentor Muça ishte shumë i ndershëm dhe mjaft human, me shpirt të pastër, i dashur dhe miqësor me njerëzit, i drejtë, me përkushtim të lartë për shërbimin ndaj vendit e popullit...

Për Gollobordën Mentori tejçonte te udhëheqja dhe organet drejtuese të kohës vlerat e Gollobordës dhe gollobordasve, si njerëz të mrekullueshëm, të jashtëzakonshëm, patriotë të flaktë, që ushqejnë dashurinë për gruan, familjen e njerëzit, për ndershmërinë, për punën dhe atdhedashurinë e gollobordasve, për shpirtmirësinë e tyre, për burrërinë e fisnikërinë, si zonën vërtet më besnike të Shqipërisë, zonë e pastër, ku nuk dëgjon njeri për hakmarrje.

Mentor Muça është një emër i mirënjohur për qytetarët e Lezhës, si drejtues kryesor i organeve organeve drejtuese të rrethit në periudhën 1971-1989. Në jetë i ka pas vënë vetës qëllim të punojë me drejtësinë më të madhe me popullin, të sillet me mirësi, me mirënjohje të jashtëzakonshme. I priste edhe në rrugë njerëzit, popullin. Padyshim që i priste edhe në zyrë. U zgjidhte problemet ose u thoshte se kjo punë nuk bëhet për arsyet ligjore. *"Më kuptonin e më falënderonin që nuk i sorollatja. Me hatër nuk kam vepruar. Ndaj kam respektin më të madh nga lezhjanët."* – do shprehej Mentori.

Mentori është ideatori dhe kontributori kryesor për miqësinë e madhe mes lezhjanëve dhe dibranëve. Në Lezhë thonë që duhet të pyesësh pesë dibranë të gjesh një lezhjan. Si drejtues në Lezhë tërhoqi shumë dibranë dhe padyshim shumë gollobordas për punë në Lezhë, ku edhe qëndruan familjarisht. Për lezhjanët ruante konsiderata të larta. *"Janë punëtorë të mëdhenj, - thoshte Mentori. Është e vërtetë ajo që thonë se kam përkrahur dibranët. Dua të them se Lezha kishte nevojë* për fuqi *punëtore. Krahas nevojës për ndërtime, nuk kishte punëtorë për tharjen e kënetave dhe shtimin e sipërfaqeve të tokës prodhuese. Lezha kishte 70 mijë banorë dhe kishte nevojë të madhe për punëtorë. Kështu më jepej mundësia të ftojë dibranët. Po dibranët e krijuan vetë personalitet dhe miqësi të jashtëzakonshme familjare me lezhjanët."*

Mentor Muça ishte patriot dhe atdhetar i madh. Me dashuri për atdheun e tij, krenar deklaronte të vërtetën historike të gollobordasve: *"Ne jemi me origjinë të pastër shqiptare. Unë nuk kam dëgjuar asnjëherë e nga askush se kemi origjinë tjetër, siç thonë nga Bullgaria. Në asnjë mënyrë. Kjo është sajesë, madje e kohëve të fundit. S'kemi asnjë lidhje gjaku me bullgarët."* Para disa vitesh, ai refuzoi ftesën e ambasadorit Bullgar për të marr pjesë në një piknikë në Dajt me përfaqësues me prejardhje bullgare. *"Kthejani këtë ftesë ambasadorit, i thash djalit që ma solli ftesën. Nuk kemi asnjë lidhje me bullgarët. Ne gollobordasit jemi shqiptarë. Hiqni dorë nga përpjekjet antikombëtare ndaj gollobodasve. Ua thash prerë."*, – tregonte Mentori. Kërkesës për ta përfshirë në listën e nënshkruesve të ankesës që Shoqata Atdhetare "Hazis Lila" i drejtoi Presidentit të Republikës, më datë 21 tetor 2017, kundër ligjit të minoriteteve, që diskriminon identitetin e vërtet shqiptar të Gollobordës, me shpirt atdhetar dhe me lotë në sy iu përgjigj: *"Po shyqyr që paska ende frymë të lartë patriotike. Më gëzuat shumë me këtë."* Dhe e nënshkroi ankesën pa hezitim, jo vetëm ai, por edhe e bija e tij.

Mesazhi i këtij burri të shquar, fisnik, të ditur e patriot për brezat e sotëm edhe brezat e ardhshëm është kuptimplotë gjithnjë: respekti për njerëzit dhe vendin tënd. *"Po e deshe vendin tënd, ke dashur Shqipërinë. Njeriu duhet ta dojë punën. Kanë filluar ta humbasin dashurinë për punën, por të punojnë këtu, për vendin e tyre. Të kthehen e të punojnë tokat e tyre bashkë me vëllezërit e tyre e të rrojnë së bashku. Ta duan jetën dhe vendin e tyre. Ta duan njëri-tjetrin dhe familjen mbi të gjitha."*

* * *

Mentor Muça ishte shumë i ndershëm dhe mjaft human, me shpirt të pastër, i dashur dhe miqësor me njerëzit, i drejtë, me përkushtim të lartë për shërbimin ndaj vendit e popullit, punëtor i palodhur për detyrën e shtetit. Motoja e jetës dhe e punës së tij ka qenë vetëm një: Shqipëria, atdheu. Për këtë punoi me gjithë energjitë dhe bëri çdo sakrificë. Edhe pushimet i bënte gjithmonë në dimër, se gjatë kohës tjetër kishte fushata të ndryshme të punëve dhe prodhimit. *"Duhet të ishim kudo, në krye të punëve, në çdo sektor ku dilnin probleme."*, – thoshte ai.

Me cilësitë e tij të larta njerëzore dhe aftësitë intelektuale e drejtuese, Mentor Muça mbetet një personalitet i ndritur i Dibrës dhe i gjithë Shqipërisë, një shembull frymëzimi për brezat. Ai i shërbeu dhe i qëndroni besnik idealeve të vendit të vetë.

Mentori do u mungojë të afërmve të tij, shokëve e miqve të tij të shumtë, që e prisnin për të pirë kafen te lokali pranë banesës së tij pranë Bërrylit, në Bulevardin "Zhan Dark", Tiranë, të cilët do e kenë gjatë në kujtesën e tyre.

Trupi i të ndjerit u përcoll me nderime nga shumë të afërm, miq, shokë e të njohur për në varrezat e Sharrës.

Për virtytet e larta njerëzore dhe përgjegjshmërinë për punën, Mentor Muça është shpallur qytetar nderi i dy bashkive ku ka punuar: i Bashkisë Lezhë dhe i Bashkisë Dibër.

Ramazan Hoxha, Arif Shutina,
Ferhat Gruja, Kadri Dauti

Na ndiqni:

RRUGA E ARBËRIT
https://www.facebook.com/gazeteerajonitteDibres

www.rrugaearberit.com

Bëj një abonim online ose në print...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...

email: rrugaearberit@gmail.com

BIGmarket

një epokë e re dashurie
ndaj jush po nis tani

HAP MARKETIN E RI NË PESHKOPI,
Rruga "Abdyl Frashëri", pranë kryqëzimit të policisë

Plot oferta dhe surpriza...

GJITHMONË KA OFERTA EDHE NË MARKETET E TJERA NË:
PESHKOPI MAQELLARË

Librat më poshtë dhe plot libra të tjerë i gjeni me 20% zbritje Gjatë gjithë muajit Prill 2022



700 lekë




1000 lekë




1000 lekë




1000 lekë



1500 lekë



800 lekë




1000 lekë



500 lekë



1000 lekë



800 lekë

cyan magenta yelloë black